



KONTROLLI LARTË I SHTETIT



R A P O R T

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN E MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, 2017



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për Auditimin e ushtruar në
Autoritetin e Mediave Audiovizive

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“MBI PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”

Tiranë, më shtator 2017

Përmbajtja

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
II.	HYRJA.....	12
a.	Objektivat dhe qëllimi.....	12
b.	Identifikimi i çështjes	12
c.	Kriteret e vlerësimit	13
d.	Standardet e auditimit	14
III.	PËRSHKRIMI AUDITIMIT	14
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	16
a.	Mbi zbatimin e ligjshmërisë në realizimin e misionit dhe funksioneve që kryen AMA	16
b.	Programimi dhe realizimi i planifikimit të shpenzimeve, Auditimi i llogarive	31
c.	Mjedisi i kontrollit dhe vlerësimi i MFK.....	67
d.	Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.....	67
V.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	83

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 305/1, datë 21.03.2017 i ndryshuar me shkresën nr. 305/4, datë 15.05.2017, i miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 10.05.2017 deri në datë 14.07.2017, në subjektin e Autoritetit të Mediave Audiovizive u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” për periudhën nga 01.01.2014 deri në 31.12.2016.

Gjatë misionit të auditimit rezultuan një sërë shkeljesh të përputhshmërisë ligjore të cilat kanë ndikuar negativisht jo vetëm në përdorimin e fondeve publike, por edhe në përmbushjen e misionit kryesor të këtij institucioni të rëndësishëm për sa kohë që vendimmarrjet bazohen në qëndrime me dy standarde në trajtimin e operatorëve të këtij tregu.

Gjetjet kryesore që rezultuan gjatë misionit të auditimit janë:

1. Nga ana e strukturave të AMA janë kryer kontrole/inspektime për zbatimin e ligjit nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të ligjit dhe janë vendosur sanksione për rastet e shkeljeve. Subjektet të cilat janë ndëshkuar për shkeljet e konstatuara nga grupet e inspektimit kanë ushtruar të drejtën e ankimimit për sanksionin e vendosur. Në përfundim të procesit të ankimimit AMA është shprehur për shfuqizimin e sanksionit me gjobë në masën 63.9% të numrit të përgjithshëm të sanksioneve të aplikuara dhe në masën 60.4% të vlerës totale të gjobave të vendosura.

Gjatë auditimi u vërejt gjithashtu se në rregulloren e AMA-s nuk kryetë cilat të përcaktonin mënyrën dhe arsyet e faljes së gjobave të vëna ndaj shkelësve të ligjit 97/2013.

AMA referuar germës “ç”, pika 2, neni 14 të ligjit 97/2013 “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” ka detyrim raportimin në Kuvendin e Shqipërisë të veprimtarisë së saj vjetore. Nga auditimi u vërejt se në asnjë prej viteve 2014, 2015 dhe 2016, AMA nuk ka përfshirë në raportin e veprimtarisë së saj, drejtuar Kuvendit, problematikën e faljes së gjobave ndaj subjekteve të cilët konsiderohen shkelës të ligjit në fushën e mediave audiovizive.

2. Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” me vendimin nr. 231, datë 03.11.2016 ka shpallur hapjen e garës për dhënien e 2 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik për rrjetet numerike të identifikuar me nr. 006 K dhe nr. 007 K. Konstatuam se pranë AMA-s janë depozituar 5 aplikime dhe konkretisht:

1. Shoqëria “Tring TV” sh.a. aplikimi nr. 3771 prot., datë 15.12.2016, për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.
2. Shoqëria “ABC News” sh.a., aplikimi nr. 3774, prot., datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.
3. Shoqëria «Media Vizion» sh.a., aplikimi nr. 3772 prot., datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.
4. Shoqëria “Ora” sh.a., aplikimi nr. 3775, datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare transmetimi audioviziv.
5. Shoqëria “ADTN” sh.a., aplikimi nr. 3773 prot., datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.

Komisionin e Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD) i ngritur me urdhrin nr. 172, datë 12.12.2016, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit të subjekteve të mësipërme dhe përgatitjes së relacioneve vlerësuese për përmbushjen e kriterëve ligjore, ekonomike, organizative, teknike e programore, të përcaktuara në Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” ka dalë në përfundimet e mëposhtme:

- Aplikimi i shoqërisë “Tring TV” sh.a. bie ndesh me dispozitat e nenit 62, pika 1 ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 9 të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”. Bazuar sa më sipër, AMA, me vendimin nr. 285, datë 29.12.2016, vendosi skualifikimin e shoqërisë “Tring TV” sh.a., dhe mosdhënien e licencës kombëtare private audiovizive.
- Aplikimi i shoqërisë “ABC News” sh.a., nuk ishte në përputhje me kërkesat e nenit 18, pika 1, nënpika 1.1., germa “c” të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”. Për këto arsye, AMA, me vendimin nr. 284, datë 29.12.2016, vendosi skualifikimin e shoqërisë “ABC News” sh.a., dhe mosdhënien e licencës kombëtare private audiovizive.
- Aplikimi i shoqërisë “Media Vizion” sh.a., ishte në përputhje me kriteret e ligjit nr. 97/2013 dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”, prandaj AMA me vendimin nr. 287, datë 29.12.2016, vendosi dhënien e licencës kombëtare private të transmetimit audioviziv shoqërisë “Media Vizion” sh.a.
- Aplikimi i shoqërisë “Ora” sh.a., nuk ishte në përputhje me kërkesat e nenit 18, pika 1, nënpika 1.4., germa “f” të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”. Për sa më sipër, AMA me vendimin nr. 283, datë 29.12.2016, vendosi skualifikimin e shoqërisë “ORA” sh.a.

Nga shqyrtimi i dosjes së paraqitur nga subjekti “ORA” sh.a., ankimuar edhe në KLSH me shkresën nr. 58. prot. datë 12.01.2017, rezultoi se vendimi i AMA për skualifikimin nga gara të subjektit “ORA” sh.a. është jo plotësisht i përligjur, pasi subjekti ka paraqitur në AMA një numër prej 8 (tetë) dokumentesh. Rregullorja e miratuar me Vendimin e AMA nr. 219, datë 12.10.2016, neni 18, pika 1.4, germa “f” shprehet: *“Depozitimi i kontratave ose marrëveshjeve paraprake me mbajtësit e të drejtave të përmbajtjes që do të transmetohen dhe ritransmetohen”* pra, nuk shprehet për një numër minimal kontratash. Ky fakt provon pretendimin e paraqitur nga ky subjekt në ankesën depozituar pranë KLSH.

- Aplikimi i shoqërisë “ADTN” sh.a., ishte në përputhje me kriteret e ligjit nr. 97/2013 dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”. Vendimi Nr. 286, datë 29.12.2016 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë ‘ADTN’ sh.a., për licencë kombëtare private transmetimi audioviziv” ka rezultuar me mosdhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv, shoqërisë “ADTN” sh.a., për shkak të mungesës të kuorumit të nevojshëm ligjor për lëshimin e licencës, germa “b”, pika 1, neni 19 i ligjit 97/2013. Nga shqyrtimi i dosjes së paraqitur nga subjekti aplikues rezultoi se vendimi për kualifikim të operatorit është marrë në kundërshtim me nenin 62/4 të ligjit 97/2013 i cili shprehet se: *“Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare*

transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale". Është në kundërshtim edhe me nenin 9/2,3,4, të rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv" ku shprehet se: " Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri janë nominativë. 3. Në kuptim të këtij neni aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë. Për sa më sipër nuk është zbatuar pika 9/9 e rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv" ku thuhet se: "Mos respektimi i kërkesave sipas këtij neni është kusht për skualifikim". KSHD duhet të kishte propozuar skualifikimin e subjektit "ADTN" sh.a.

Pas marrjes së njoftimit për vendimin nr. 286, datë 29.12.2016 të AMA, shoqëria "ADTN" sh.a. ka depozituar pranë AMA kërkesën me nr. 3922/1 prot., datë 06.01.2017 për revokim të vendimit nr. 286, datë 29.12.2016, me arsyetimin se: "Vendimi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin për mediat dhe procedurat ligjore të parashikuara në ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike". Në mbledhjen e datës 19.01.2017 AMA ka marrë në shqyrtim ankesën e subjektit të interesuar dhe pas anulimit të vendimit nr. 286, datë 29.12.2016 ka proceduar me zhvillimin e votimit të aplikimit të shoqërisë "ADTN" sh.a. bazuar në ligjin 97/2013 dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike". Në votimin e parë mbi shqyrtimin e aplikimit të kërkuarit shoqërisë "ADTN" sh.a., rezultati i votimit ishte 4 anëtarë pro dhënies së licencës subjektit dhe 3 anëtarë kundër këtij aplikimi, duke mos arritur kuorumin e shumicës së cilësuar për vendimmarrje. Në votimin e dytë lidhur me aplikimin e shoqërisë "ADTN" sh.a., u arrit i njëjti rezultat si në votimin e parë, 4 anëtarë votuan pro dhënies së licencës subjektit dhe 3 anëtarë votuan kundër këtij aplikimi, edhe në këtë votim nuk u arrit kuorumi i shumicës së cilësuar për vendimmarrje. Pas këtij rezultati vendimmarrja u shty për mbledhjen e radhës, atë të datës 27.01.2017. Në mbledhjen e zhvilluar në datën 27.01.2017 vijoi zhvillimi i procedurës vendimmarrëse lidhur me aplikimin e shoqërisë "ADTN" sh.a., gjatë të cilës rezultoi se 4 anëtarë ishin pro dhënies së licencës subjektit shoqërisë "ADTN" sh.a., dhe 3 anëtarë ishin kundër këtij aplikimi.

Në përfundim, në bazuar në: nenin 19, pika 16, nenin 13 pika 5 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; nenet 113, 114, 117 dhe 136 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", dhe nenit 14 paragrafi 2 i ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike" AMA vendosi: Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë "ADTN" sh.a., dhe anulimin e vendimit të AMA-s, nr. 286, datë 29.12.2016 "Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "ADTN" sh.a., për licencë kombëtare private transmetimi audioviziv", duke vendosur: Dhënie e licencës kombëtare private të transmetimit audioviziv, shoqërisë "ADTN" sh.a., për një periudhë prej 15 vjetësh...

Nga auditimi është arritur në konkluzionin se

- a. Komisionin e Shqyrtimit të Dokumentacionit ka përdorur dy standarde gjatë procedurës së vlerësimit të aplikimeve të bëra nga subjektet konkurruese për garën e dhënien së 2 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik.
- b. Procedura e votimit e ndjekur nga AMA në rastin e vendimit Nr. 5, datë 27.01.2017 "Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "ADTN" sh.a. për revokim të vendimit nr. 286, datë 29.12.2016 të AMA-s "Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "ADTN" sh.a., për licencë kombëtare transmetimi audioviziv", shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "ADTN" sh.a., për licencë kombëtare të transmetimit audioviziv për shoqërinë "ADTN" sh.a. dhe dhënien e licencës private kombëtare të transmetimit audioviziv shoqërisë "ADTN" sh.a.", është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore.
- c. AMA duke licencuar shoqërinë "ADTN" sh.a. nuk ka ushtruar një prej funksioneve bazë të saj, garantimin e konkurrencës së ndershme, në kundërshtim me nenin 62/4 të ligjit 97/2013 i cili shprehet se : *"4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale". Gjithashtu, në kundërshtim edhe me nenin 9/2,3,4, të rregullores "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv" ku shprehet se: "2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri janë nominativë. 3. Në kuptim të këtij neni aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë. 4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20% të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audioviziv. Për transmetimet analoge lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10% në një shoqëri të tretë kombëtare". Duke marrë në konsideratë pronësitë e ndërthurura (cross-ownership) të shoqërisë "Digit-Alb" sh.a., e cila është aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë "ADTN" sh.a., dhënia e licencës së tretë kombëtare e transmetimit audioviziv për këtë operator rrit përqendrimin në këtë treg.*

3. Nga auditimi i llogarive për periudhën objekt auditimi, për nxjerrjen e bilancit kontabël u konstatua se: Çelja e llogarive të vitit 2015 nuk është bërë e saktë për 12 zëra të bilancit pasi janë evidentuar mospërputhje me tepricën në fund të vitit 2014 të llogarive respektive konkretisht :

Në Aktivin e Bilancit nuk është bërë çelja e saktë për grupet, klasat dhe llogaritë :

- Aktive të Qëndrueshme : Çelja e vitit 2015 është bërë më pak se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 1,470,099 lekë. Kjo diferencë i përket llogarisë 232 Shpenzime në Proces për Transferime Kapitale për shumën 1,470,099 lekë.
- Aktive Qarkulluese : Çelja e vitit 2015 është bërë më pak se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 60,267,123 lekë.

Sipas llogarive rezultojnë :Llogaria 411-418 " Klientë e Llogari të Ngjashme "me diferencë më shumë për shumën 205,110,291 lekë;Llogaria 423-429"Personeli, Paradhënie,Deficite e Gjoha " me diferencë më pak për shumën 196,361,332 lekë;Llogaria 431" Të Drejta e Taksa për tu Derdhur në Shtet "me diferencë më pak për shumën 8,744,159 lekë;Llogaria 435"Sigurime Shoqërore"me diferencë më shumë për shumën 70,671 lekë;Llogaria 436 " Sigurime

Shëndetësore " me diferencë më shumë për shumën 3,532 lekë; Llogaria 437,438 " Organizma të tjera Shoqërore " me diferencë më shumë për shumën 123,686 lekë; Llogaria 468 " Debitorë të Ndryshëm " me diferencë më pak për shumën 60,469,812 lekë.

Në Pasivin e Bilancit nuk është bërë çelja e saktë për grupet, klasat dhe llogaritë :

- Fondet e Veta : Çelja e vitit 2015 është bërë më pak se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 195,262,136 lekë. Kjo diferencë i përket llogarisë 101 "Fondet Bazë " .
- Detyrime : Çelja e vitit 2015 është bërë më shumë se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 165,310,932 lekë.

Sipas llogarive rezultojnë : Llogaria 431 " Detyrime ndaj Shtetit për Tatim-Taksa " me diferencë më pak për shumën 1,792,900 lekë; Llogaria 4341 " Të tjera Operacione me Shtetin (kreditor) " me diferencë më shumë për shumën 167,103,832 lekë.

Rezultati i Ushtrimit (Saldo Kreditorë) : Çelja e vitit 2015 është bërë më pak se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 31,786,018 lekë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.468, datë 03.06.2015 ka kaluar në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive objektin me emërtimin Atelier për Dekorin e Radio Televizionit në zonën kadastrale 8160 me numër pasurie 2/94 me sipërfaqe totale 10177 m2 me sipërfaqe ndërtese 6202 m2. Në këtë vendim nuk është përcaktuar vlera e aseteve të transferuara. Nga ana e AMA-s janë kryer riparime dhe janë përfshirë në Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara të vitit 2016, vetëm vlera e situacioneve të likuiduara për shumën 34,899,242 lekë dhe nuk është përfshirë vlera tjetër e objektit sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave. Veprimi i mësipërm shtrembëron vlerën e aktiveve të Institucionit si edhe të shpenzimeve të amortizimit, që duhen llogaritur për këtë aktiv.

4. Nuk janë evidentuar si Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët (Llogaria 411 " Klientë) detyrimet e lindura, e të papaguara për 5 subjekte, të cilave nga AMA ju është hequr Licenca, për vitin 2015, në shumën 10,405,000 lekë. Për veprimet e mësipërme nuk u paraqitën dokumentacion justifikues, argumente e sqarime të detajuara për secilin ndryshim dhe as veprimet kontabile të kryera për këta ndryshime. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" me ndryshimet neni 6 dhe neni 10 Si dhe në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 " Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik " Dokumentimi i Lëvizjes së Aktiveve pika 34 dhe pika 36 .

Gjatë vitit 2016 janë ulur si Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët për 22 subjekte të cilëve ju janë hequr licencat apo autorizimet për shumën 37,766,545 lekë. Për këtë janë rënduar shpenzimet e vitit 2016 dhe kjo shumë është evidentuar në Aktivin e Bilancit me minus tek llogaria 49 " Shuma të parashikuara për zhvlerësim " duke ulur në këtë mënyrë për këtë shumë edhe Klasën 4 "Kërkesa Arkëtimi për Debitorët ". Për veprimet e mësipërme nuk u paraqitën dokumentacion justifikues , argumente ligjore e shënime shpjeguese të detajuara për secilin subjekt por vetëm pretendime se detyrimet e këtyre subjekteve janë të pamundura për tu arkëtuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 "Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare për institucionet qendrore organet e pushtetit vendor dhe njësi që varen prej tyre si dhe njësi të menaxhim/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj" i ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.

5. Nga auditimi është konstatuar se nëpërmjet arkës gjatë periudhës së audituar janë kryer arkëtime nga subjekte të ndryshme në shuma të konsiderueshme si dhe janë kryer pagesa të ndryshme për blerjeve të kryera me Procedurë Prokurimi me Vlera të Vogla, shërbime të ndryshme, shpenzime telefonike, shpenzime udhëtim e dieta, etj. Sigurimi fizik i arkës nuk i plotëson kushtet e nevojshme. Nëpërmjet arkës janë kryer këmbime monetare në vlera të konsiderueshme në euro, veprime që bien në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

6. Komisioni i përlllogaritjes së shpenzimeve të karburantit në AMA, për vitet 2014 dhe 2015, në kronometrimin e km të përshkruara dhe karburantin e harxhuar për to nuk ka bërë kronometrim për lëvizjet urbane, por është mjaftuar me kronometrimin vetëm për km e përshkruara për lëvizjet interurbane, gjë që ka sjellë llogaritje fiktive dhe jo korrekte të karburantit. Në disa raste daljet e karburantit nga magazina, nuk përputhen në datë me dokumentin “kërkesë për shërbim” dhe “urdhër dorëzimin” si dhe për asnjë rast nuk janë mbajtur akt rakordime ndërmjet magazinës dhe financës për harxhimin e karburantit. Nga drejtuesit e automjeteve në të gjitha rastet Fletë udhëtimet nuk ishin plotësuar në mënyrë korrekte për udhëtimet brenda qytetit por edhe për udhëtimet jashtë qytetit, ato plotësoheshin vetëm me firmën e shoferit, pa u vërtetuar me firmën e personit për të cilin është kryer shërbimi si dhe pa përcaktuar km e përshkruara, por mjaftoheshin duke përcaktuar vetëm vend nisjen dhe vend mbërritjen. Ky veprim le shteg për mos efikasitet në kontrollin e harxhimit të karburantit.

7. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga zj. Eriona Rusmali me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Erjona Fishta me detyrë jurist, z. Rais Petrela me detyrë arkitekt (i jashtëm) në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” ka kualifikuar/shpallur padrejtësisht fitues BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. me parregullsi në dokumentacionin ligjor kualifikues si më poshtë:

i. BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. nuk ka përcaktuar në ofertë pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në kundërshtim me nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2016 “Për rregullat e prokurimit publik” në të cilin është përcaktuar se ...Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të notëzuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. Në nenin 3 të kontratës së bashkëpunimit datë 10.2.2016 të notëzuar lidhur midis palëve është përcaktuar

shoqëria “AVE Consulting” sh.p.k. do të ketë 7 për qind të fitimit dhe të pjesëmarrjes, shoqëria “D & C partners” sh.p.k. do të ketë 30 për qind të fitimit dhe pjesëmarrjes. Nga sa më sipër konstatohet që në kontratën e bashkëpunimit palët (OE) nuk janë shprehur për pjesën e shërbimit, punës ... elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

ii. OE “D & C Partners” sh.p.k. nuk ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike për muajin janar, shkurt 2016, në kundërshtim me germën 2b të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në zbatim të VKM nr. 379, datë 11.6.2014 shtesa të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

iii. Kontratat e punës të lidhura midis OE “AVE Consulting” sh.p.k. dhe punonjësve që parashikohen të kryejnë punën objekt prokurimi, nuk kanë vlerë pasi nuk janë të noteruara dhe personat nuk janë të përshirë në listë pagesat e shoqërisë.

Sa më sipër në kundërshtim me pikën 4 të pikës 2 të “Kriteret e veçanta të Kualifikimit” të shtojcës 9 të DST në të cilën ndër të tjera është përcaktuar se ... OE duhet të ketë një numër mesatar punonjësish të siguruar prej minimum 10. Për të vërtetuar këtë OE duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave, Për periudhën janar – dhjetor 2015, ... i shoqëruar me listë pagesë... Gjithashtu të gjithë drejtuesit teknikë duhet të jenë përfshirë në këto lista. Në projektet e ndryshme të zbatimit si elektrik, hidraulik etj, gjenden e 12 personave që mbulojnë shërbimin me kategoritë e punimeve që kanë në licencë, por në asnjë rast nuk është firma e tyre për projektin përkatës, psh për projektin elektrik të jenë firmat e dy inxhinierëve elektrikë të OE, Hysen Gjoka (AVE Consulting sh.p.k.) dhe Majlinda Mema (D&C Partners sh.p.k.). Në projekt zbatimin të dorëzuar (arkitektura fleta A4-01, A3-04, A3-03, A3-02, A3-01 etj, ka firmosur zj. Anila Katundi, e cila nuk gjendet në stafin, listë pagesat apo personelin e afruar nga OE të BOE. Me parregullsitë e konstatuara, KVO duhet të skualifikonte BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. Me skualifikimin e tij, fitues rezulton “AA & E Engineering me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj ofertës ekonomike të BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners”, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik.

8. Lidhur me “Saktësinë e llogaritjes së fondit limit” në tenderin me objekt “Hartimi i projektpreventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”, me numër reference 22631, i zhvilluar në vitin 2016 me fond limit të llogaritur 49,999,949 lekë, i paraqitur/hartuar nga BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. me z. Arben Dervishi drejtues ligjor dhe teknik (AVE) dhe OE “D & C partners” me z. Edison Drishti drejtues ligjor/teknik dhe Vasillaq Shkurti drejtues teknik. Pasaktësi të konstatuara:

i. Në preventiv, në pjesën A-I me numër/emërtim “Punime prishje...”: A-1.1. është përfshirë dhe zëri i punimeve “Ngritje, mobilim, mirëmbajtje ...” me analizë An me vlerë 236,078 lekë (187,364 x 1,05 fondi rezervë x 1.2 TVSH). A-1.2. është përfshirë dhe zëri i punimeve “Rrethim I përkohshëm me rrjetë teli” me vlerë 270,270 lekë (214,500 x 1,05 fondi rezervë x 1.2 TVSH). Përfshirja si zëra punimi me vete në preventiv/situacion i sa më sipër është në kundërshtim me germën B/3 të “Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi” të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 në të cilën është përcaktuar se në shpenzimet e përgjithshme përfshihen Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, **skelat**, makineritë, tabelat sinjalizuese etj. Në zbatimin e punimeve të “Rikonstruksionit të godinës...” në preventivin fitues dhe në situacionin e punimeve për zërat e punimeve sipas A-1.1. dhe A-1.2 BOE “Mela” sh.p.k.

& “Curri sh.p.k. zbatuese e punimeve të tenderit, i janë likuiduar respektivisht **50,000 lekë** dhe **160,750 lekë**, ose 210,000 lekë gjithsej, të cilat nën arsyetimin e mësipërm janë përfituar padrejtësisht nga OE “Mela” sh.p.k. dhe përbëjnë **dëm ekonomik**.

ii. Pasaktësi e konstatuar: Në strukturën e kostos, në preventivin e hartuar/dorëzuar nga BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k., midis zërave të punimeve është përfshirë vlera e pajisjeve me TVSH përkatëse, në kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, e cila përcakton se në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat, si më poshtë: Në preventiv, në pjesën “Instalime hidro sanitare” zëri I punimeve me analizë 10, me emërtim “FV grup presioni I ujit të pijshëm ...” një copë me vlerë 314,000 lekë, e cila duhet të ishte vendosur/shtuar në fund të preventivit (pa u vlerësuar me TVSH). Në preventivin fitues të “Rikonstruksionit të godinës...” dhe në situacionin e punimeve të paraqitur nga BOE “Mela” sh.p.k. & “Curri sh.p.k. zbatuese e punimeve të tenderit, vlera e kësaj pajisje në preventivin fitues është 267,044 lekë, e cila është rritur me fondin rezervë prej 13,352 leke (I parashikuar në masën 5 për qind) dhe vlerën e TVSH prej 53,408 lekë, që përfaqëson pagesë/përfitim të padrejtë nga OE “Mela” sh.p.k., dhe nën këtë arsyetim është dëm ekonomik. I njëjti arsyetim për:- zërin e punimeve me numër rendor E2-4 “Analizë” “FV Detektor optik tymi me vetadresim të kompletuar me baza” të kapitullit E “Instalimi, sistemi I sinjalizimit kundra zjarrit” 46 copë me vlerë 257,600 lekë. Vlera e shtuar padrejtësisht është 66,896 lekë (nga e cila fondi rezervë 12,800 lekë dhe TVSH 54,096 lekë), e cila përbën dëm ekonomik.- zërin e punimeve me numër rendor Z-2.1 “Analizë” “FV Panel komandimi I impiantit të MKZ për një zonë detektimi dhe shuarje të zjarrit” të kapitullit Z-2 “Impianti I mbrojtjes nga zjarri – Arkiva” 1 copë me vlerë 85,000 lekë. Vlera e shtuar padrejtësisht është 22,100 lekë (nga e cila fondi rezervë 4,250 lekë dhe TVSH 17,850 lekë), e cila përbën dëm ekonomik. Gjithsej shuma dëm ekonomik (sipas pikës 2) është **366,504 lekë**.

9. Nga auditimi i fletë udhëtimeve që na u vunë në dispozicion dhe fletë daljeve të magazinës në disa muaj u konstatuan diferencë në karburant: Për vitin 2015 në sasi prej 935 litra karburant në vlerë 162,253 lekë, (dalje 6,458 dhe harxhuar sipas fletë udhëtimeve 5,523). Për vitin 2016 në sasi prej 460 litrash në vlerë 86,605 lekë (1,370 sipas fletë udhëtimeve dhe duke i krahasuar me daljet nga magazina për një sasi prej 1,830). Për dy vitet 2015,2016 diferencat në karburant prej 1,395 litra nga të cilat 945 lira benzinë dhe 450 litra naftë me vlerë prej 248,858 lekë.

10. AMA në të gjitha rastet e shfuqizimit të sanksioneve me gjobë, të vendosura nga grupet e inspektimit, ka marrë në konsideratë pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga ana e subjekteve ankimues dhe ka rrëzuar faktet e paraqitura nga grupet e inspektimit, të cilat kanë qenë të bazuara në kuadrin ligjor, rregullator të fushës, në fuqi. Pra, AMA ka favorizuar subjektet shkelës të ligjit të përfitojnë në mënyrë të padrejtë, duke i sjellë të ardhura të munguara buxhetit të shtetit **në vlerën 99,552,000lekë** (124,440,000 vlera totale e gjobave të shfuqizuara, **80% e vlerës së gjobës shkon në buxhetin e shteti dhe 20% e saj shkon në buxhetin e AMA**).

11. Nga auditimi i procedurave të prokurimeve me blerje të vogla, në institucionin e AMA-s, rezultoi se: Referuar regjistrin të parashikimit të viteve buxhetor 2015 dhe 2016, AMA ka kaluar fondin e parashikuar për tu realizuar në disa nga objektet e tenderimit në zërin (602), duke mos reflektuar ndryshimin në regjistrin e prokurimit në APP, pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit numër

3, datë 27.01.2015. Nga auditimi i ushtruar mbi realizimin e prokurimeve me vlerë të vogël në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) u konstatua se, në procedurat e prokurimit “Blerje me vlerë të vogël” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ka mangësi dhe parregullsi gjatë realizimit të këtyre procedurave të cilat binin ndesh me ligjin e prokurimit publik. Në shumë raste nuk bëhet përllogaritje e fondit limit nga komisioni i caktuar me urdhrin e titullarit, por fondi limit përcaktohet apriori ose duke marrë parasysh parashikimin e bërë në projekt buxhet, në kundërshtim bazën ligjore të Prokurimit Publik dhe të ligjit nr. 10296 “për menaxhimin e financiar dhe kontrollit”. Në 12 raste për prokurimet e blerjeve me vlera të vogla për vitin 2015 dhe 2016 nuk janë kryer procedurat online të prokurimit publik, por realizoheshin disa procedura në mënyrë shkresore, të pajustificuara, në kundërshtim me pikën 5 dhe 8 të Udhëzimit Nr. 3, datë, 27.01.2015 “Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël”. “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar, ku citohet “Kur vlera e përllogaritur për mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor, brenda vitit kalendarik nuk është më e madhe se 100.000 (njëqind mijë) lekë autoriteti kontraktor mund të kryejë prokurimin në rrugë shkresore sipas formularit Nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.”, pasi vlera për blerjen e këtij grup mallrash kalon vlerën e 100,000 lekë, për gjithë vitin. Nga Autoriteti kontraktor procedurat e nisura në mënyrë shkresore, bëheshin me urdhra të dala nga titullari sipas formularit 5 në kundërshtim me pikën të Udhëzimit Nr. 3, datë, 27.01.2015 “Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël”, pasi këto lloj procedurash një pjesë është realizuar në mënyrë shkresore me formularin 2 dhe më vonë me atë të formularit nr. 5. Në këto kushte, AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë, duke shkaktuar copëtim të fondit të parashikuar për prokurim publik dhe duke shmangur dhe anashkaluar procedurat online të Prokurimit Publik. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike sipas Udhëzimit Nr. 3, datë, 27.01.2015 “Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 2, për të cilin nuk është paraqitur asnjë observacion nga subjekti, e paraqitur në Raportin përfundimtar të auditimit.

12. Gjatë auditimit u konstatua mosrespektimi i kuadrit ligjor që rregullon përfshirjen e pronësive të ndërthurura (cross ownership) gjatë procedurës dhe vendimmarrjes së dhënies së një licence kombëtare të transmetimit audioviziv numerik.

13. Gjatë auditimit u konstatua se nuk ekziston dosja me dokumentacionin përkatës të Kryetarit të AMA si dhe nuk ka dokument të deklarimit të konfliktit të interesave në momentin e marrjes së detyrës nga ana e tij. Grupi i auditimit u vu në pamundësi të vlerësimit të përputhshmërisë me ligjin të zgjedhjes së Kryetarit të AMA.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 305/1, datë 21.03.2017 i ndryshuar me shkresën nr. 305/4, datë 15.05.2017 miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 10.05.2017 deri në datë 14.07.2017, në subjektin e Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën nga 01.01.2014 deri në 31.12.2016 u krye auditimi “Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë financiare” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- | | | |
|--------------|--------------|-------------------|
| 1. Artur | Hasanbelliu, | Përgjegjës Grupi; |
| 2. Valentina | Sulaj, | Audituese; |
| 3. Aqif | Klosi, | Auditues; |
| 4. Alkida | Llakaj, | Audituese; |
| 5. Fatmir | Zilja | Auditues. |

a. Objektivat dhe qëllimi

Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është zbatimi i ligjshmërisë në realizimin e misionit dhe funksioneve që kryen Autoriteti i Mediave Audiovizive si dhe dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që AMA u ka bërë fondeve, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij dhe planeve të miratuara.

Auditimi ka për qëllim promovimin e transparencës duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar dhe të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi; promovimin e përgjegjshmërisë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Gjithashtu auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë. (sipas ISSAI 400, p 18).

b. Identifikimi i çështjes

Në vitin 1998 me miratimin e ligjit nr. 8410 dt. 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, u krijua mundësia e lindjes së konkurrencës midis shoqërive publike e private në fushën e radios dhe televizionit. Në zbatim të po këtij ligji, në korrik të vitit 1999, Parlamenti shqiptar miratoi krijimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), i cili filloi veprimtarinë e tij si një organ i pavarur, misioni kryesor i të cilit ishte rregullimi, licencimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë radio e televizive në Republikën e Shqipërisë.

Zhvillimet e reja në shërbimet e ofruara nga media, zhvillimet teknologjike në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shoqërisë së informacionit si dhe për të përmbushur detyrimet që Republika e Shqipërisë kishte për të harmonizuar legjislacionin e saj të kësaj fushe me legjislacionin evropian dhe veçanërisht detyrimet që rridhnin nga MSA-ja, sollën nevojën për ndryshimin e legjislacionit në fushën e transmetimeve audiovizive. Në këtë kuadër Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ky ligj rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën

e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në nenin 6 të ligjit thuhet se AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

AMA, është organ kolegjal i përbërë nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë, kontrollon zbatimin e Ligjit për Mediat nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën audiovizive dhe në rast shkeljesh, vendos sanksione. Fuqia, kompetenca, pavarësia financiare dhe përshtatshmëria e burimeve përbëjnë garanci legislative për të siguruar pavarësinë e këtij autoriteti rregullator.

c. Kriteret e vlerësimit

Qasja e punës audituese në Autoritetin e Mediave Audiovizive, u orientua bazuar në:

Kushtetutën e Shqipërisë, Pjesa e Katërmëdhjetë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, nenet 162 deri 165. Ligjin 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 8410 dt. 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligjin nr. 160/2014, datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015”, i ndryshuar; Ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2016”, me ndryshime; Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me Ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006; Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar; Ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative”; Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”; Ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”; Ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”; Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”; VKM nr. 432, datë 28.06.2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”; VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, i ndryshuar; VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, me ndryshime; UMF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, si dhe udhëzimet vjetore të hartimit të buxhetit; UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde në zbatimin e buxhetit”, i ndryshuar, si dhe udhëzimet vjetore për zbatimin e buxhetit; UMF nr. 7, datë 11.02.2015 “Për procedurat standarde të përcaktimit dhe zbatimit të limiteve të angazhimit”; nr. 1, datë 04.06.2014, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, etj.; UMF nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, vendore dhe njësisve që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj, etj.”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 dhe nr. 10, datë 27.02.2008, etj.;

d. Standardet e auditimit

Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e auditimit.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të standardeve ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. KLSH, ka adoptuar Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si standard pune.

Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të SAI mbi auditimin e përputhshmërisë. ISSAI 100 “Auditimi i përputhshmërisë përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi.” ISSAI 100 (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik) përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

ISSAI 400 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) përcakton parimet themelore të ISSAI 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;

ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;

ISSAI 4100 “Udhëzimet për auditimin e përputhshmërisë për auditimet që kryhen veçmas nga auditimi i pasqyrave financiare

Sipas përkufizimeve të ISSAI 4100:

“Autoritetet” janë akte ose rezoluta të lëshuara nga pushteti legjislativ apo instrumente të tjera statusore, direktiva dhe udhëzime të lëshuara nga organe të sektorit publik, me kompetenca të përcaktuara në statut, me të cilat subjekti i audituar duhet të jetë në pajtim

“Audituesit e Sektorit Publik i planifikojnë dhe i kryejnë auditimet për të përcaktuar nëse informacioni mbi çështjen në të gjitha aspektet materiale, është në përputhje me kriteret e përcaktuara”.

“Për kryerjen e një auditimi që synon një nivel të arsyeshëm sigurie, audituesit e sektorit publik, mbledhin evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të mbështetur konkluzionet e tyre”

ISSAI 300 “Parimet Bazë të Auditimit në lidhje me përputhshmërinë”, pohojnë se auditimi duhet të japë siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimeve të paligjshme që mund të cenojnë ndjeshëm objektivat e auditimit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

Në vitin 1998 u miratua ligji nr. 8410 dt. 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i cili i hapi rrugën lindjes së konkurrencës midis shoqërive publike e private në fushën e radios dhe televizionit duke eliminuar në këtë mënyrë mundësinë e shtetit për të kontrolluar i vetëm veprimtarinë në këtë fushë. Harmonizimi i këtij ligji me teknologjitë e reja, realitetin e tregut dhe përmbushjen e detyrimeve që ka hasur Shqipëria nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim –Asociimit (MSA) me Bashkimin Evropian (BE), ka bërë prioritare kryerjen e një reforme të plotë ligjore.

Në zbatim të po këtij ligji, në korrik të vitit 1999, Parlamenti shqiptar vendosi dhe miratoi krijimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), i cili filloi veprimtarinë e tij si një organ i pavarur, misioni kryesor i të cilit ishte rregullimi, licencimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë radio e televizioneve në Republikën e Shqipërisë.

Kuadri ligjor që ka rregulluar transmetimet radiotelevizive në Republikën e Shqipërisë dhe transmetimet numerike deri në miratimin e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, përbëhet nga dy ligje të veçanta:

- Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe
- Ligji nr. 9742 datë 28.05.2007 “Për Transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë”.

Deri në Qershor të vitit 2007, Ligji 8410, ishte baza kryesore dhe e vetme për rregullimin e sektorit të medias në Shqipëri. Por ky legjislacion nuk i përgjigjej zhvillimit të vrullshëm teknologjik, ekonomik, social dhe kulturor të sektorit audioviziv, që ndodh më shpejt nga sa mund të ndryshojnë kornizat rregulluese. Ligji nr. 8410, nuk parashikonte mundësinë e transmetimit të programeve nëpërmjet teknologjisë numerike, duke u bërë në një farë mase barrierë për zhvillimin e këtij sektori. Për plotësimin e këtij boshllëku ligjor, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në Ligjin për Transmetimet Numerike, i cili kishte si objekt dhe qëllim përcaktimin e një kuadri rregullues për hyrjen e transmetimeve numerike, duke iu dhënë mundësinë operatorëve të rrjetit dhe programeve të ndërtojnë rrjete dhe transmetojnë programe në rrugë numerike.

Ligji për Mediat rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sipas nenit 6 të ligjit të mësipërm, Autoriteti i mediave audiovizive është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Struktura e AMA përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë.

Anëtarët e AMA-s zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Procedura e zgjedhjes rregullohet në nenet 9 dhe 10 të Ligjit për Mediat. Sipas këtyre dispozitave kandidat për t’u zgjedhur anëtar i AMA-s kërkohet të ketë eksperiencë jo më pak se 10 vjet në fushat e medias, transmetimeve audiovizive të shërbimit publik, tregtar ose jotregtar; prodhimit të përmbajtjes së transmetimeve audiovizive; ekonomisë, administrimit dhe rregullave të konkurrencës; çështjeve të zhvillimit të gjuhës shqipe; çështjeve që lidhen me personat me aftësi të kufizuara e grupeve të tjera vulnerabël; artit, kulturës e muzikës; drejtësisë, ligjit, administrimit publik; shkencës, mjedisit dhe zhvillimit teknologjik; mbrojtjes së konsumatorit.

Nga trupa prej 7 (shtatë) anëtarësh të AMA-s vetëm Kryetari dhe Zëvendëskryetari janë të angazhuar me kohë të plotë në veprimtarinë e përditshme të punës së AMA-s.

AMA është organ kolegjal. Procedurat e vendimmarrjes, zbatimi i tyre dhe thirrja e mbledhjeve jashtë radhe të AMA-s kryhen sipas dispozitave të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Kuorumi i kërkuar për zhvillimin e mbledhjeve është 4 anëtarë. Si rregull, vendimet e AMA-s merren kur për to votojnë pro shumica e anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve të parashikuara ndryshe në ligj. Shumica e vendimeve të AMA-s merren me shumicë të thjeshtë, përveç disa lloj vendimesh që kërkojnë shumicë të cilësuar. Një nga drejtimet kryesore të punës së AMA-s është kontrolli i përmbajtjes së programeve të ndryshme radiotelevizive: programeve informative, kulturore, programeve për fëmijë e të rinj, duke u përqendruar te realizimi i funksionit edukues, kulturor, argëtues e etik të tyre. Krahas veprimtarisë mbikëqyrëse rol të rëndësishëm luan edhe veprimtaria rregullatore të AMA.

Ligji për Mediat parashikon parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive. Përveç parimeve të përgjithshme, të cilat janë norma deklarative, në Ligjin për Mediat, ka disa dispozita që parashikojnë detyrime për ofruesit e shërbimit mediatik audioviziv duke përcaktuar që këta të fundit, në veprimtarinë e tyre, të respektojnë kërkesat të legjislacionit për median gjatë veprimtarisë audio dhe audiovizive.

Disa prej funksioneve kryesore të AMA-s janë:

- garantimi i konkurrencës së ndershme;
- hartimi i strategjive për ofrimin e shërbimeve të transmetimit;
- miratimi i kodit dhe rregulloreve të transmetimit audioviziv dhe akteve të tjera nënligjore;
- zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik;
- monitorimi i programeve të transmetuara nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA);
- bashkëpunimi me institucione të tjera për përmbushjen e objektivave ligjore si Autoritetin e Konkurrencës, Zyrën shqiptare ZSHDA-në, Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit etj. ;
- hartimi dhe miratimi i rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave dhe/ose autorizimeve, sipas përcaktimeve të Ligjit për Mediat;
- përcaktimi i pagesave për licencat.

AMA kontrollon zbatimin e Ligjit për Mediat nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën audiovizive dhe në rast shkeljesh, vendos sanksione. Fuqia, kompetenca, pavarësia financiare dhe përshtatshmëria e burimeve përbëjnë garanci legjislative për të siguruar pavarësinë e këtij autoriteti rregullator.

Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH është zbatimi i ligjshmërisë në realizimin e misionit dhe funksioneve që kryen Autoriteti i Mediave Audiovizive si dhe dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që AMA u ka bërë fondeve, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij dhe planeve të miratuara.

Auditimi ka për qëllim promovimin e transparencës duke ofruar raporte të besueshme për administrimin e fondeve si dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve për një proces të rregullt ashtu si parashikohet nga kuadri ligjor, rregullator në fuqi. Një qëllim tjetër i auditimit është edhe promovimi i përgjegjshmërisë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre. Gjithashtu auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë. (sipas ISSAI 400, p 18).

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

a. Mbi zbatimin e ligjshmërisë në realizimin e misionit dhe funksioneve që kryen AMA
Në vitin 1998 u miratua ligji nr. 8410 dt. 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar “Ligji 8410”), i cili i hapi rrugën lindjes së konkurrencës midis shoqërive publike e private në fushën e radios dhe televizionit duke

eliminuar në këtë mënyrë mundësinë e shtetit për të kontrolluar i vetëm veprimtarinë në këtë fushë.

Në korrik të vitit 1999, Kuvendi i Shqipërisë miratoi krijimin e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit (KKRT), i cili filloi veprimtarinë e tij si një organ i pavarur, misioni kryesor i të cilit ishte rregullimi, licencimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë radio e televizioneve në Republikën e Shqipërisë.

Kuadri ligjor që ka rregulluar transmetimet radiotelevizioneve në Republikën e Shqipërisë dhe transmetimet numerike përbehet nga :

- Ligji nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe
- Ligji nr. 9742 datë 28.05.2007 “Për Transmetimet Numerike në Republikën e Shqipërisë”.

Zhvillimi i medias elektronike, zhvillimet teknologjike në fushën e komunikimeve elektronike dhe të shoqërisë së informacionit si dhe detyrimet Republikës së Shqipërisë për të harmonizuar legjislacionin e saj në këtë fushë me legjislacionin evropian dhe veçanërisht detyrimet MSA-së, sollën si rezultat miratimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ka si objekt dhe qëllim përcaktimin e një kuadri rregullues për hyrjen e transmetimeve numerike, duke iu dhënë mundësinë operatorëve të rrjetit dhe programeve të ndërtojnë rrjete dhe transmetojnë programe në rrugë numerike. Gjithashtu ky ligj rregullon veprimtarinë e mediave audiovizive dhe shërbimeve mbështetëse të tyre, mbi bazën e parimit të asnjësisë teknologjike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas nenit 6 të ligjit të mësipërm, Autoriteti i Mediave është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

AMA përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë. Anëtarët e AMA-s zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

AMA është organ kolegjal. Procedurat e vendimmarrjes, zbatimi i tyre dhe thirrja e mbledhjeve jashtë radhe të AMA-s kryhen sipas dispozitave të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Një nga drejtimit kryesore të punës së AMA-s është kontrolli i përmbajtjes së programeve të ndryshme radiotelevizioneve. Krahas veprimtarisë mbikëqyrëse rol të rëndësishëm luan edhe veprimtaria rregullatore të AMA. Ligji për Mediat parashikon parimet themelore që përbëjnë bazën e zhvillimit të veprimtarisë audiovizive. Disa prej funksioneve kryesore të AMA-s janë:

- garantimi i konkurrencës së ndershme;
- hartimi i strategjive për ofrimin e shërbimeve të transmetimit;
- miratimi i kodit dhe rregulloreve të transmetimit audioviziv dhe akteve të tjera nënligjore;
- zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik;
- monitorimi i programeve të transmetuara nga Ofruesit e Shërbimit Mediatik Audioviziv (OSHMA);
- bashkëpunimi me institucione të tjera për përmbushjen e objektivave ligjore si Autoritetin e Konkurrencës, Zyrën shqiptare ZSHDA-në, Komisionin për Mbrojtjen e Konsumatorit etj.;
- hartimi dhe miratimi i rregulloreve për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencave dhe/ose autorizimeve, sipas përcaktimeve të Ligjit për Mediat;
- përcaktimi i pagesave për licencat.

AMA kontrollon zbatimin e Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën audiovizive dhe në rast shkeljesh, vendos sanksione. Fuqia, kompetenca, pavarësia financiare dhe përshtatshmëria e burimeve përbëjnë garanci legjislative për të siguruar pavarësinë e këtij autoriteti rregullator.

- i. *Bashkëpunimi për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave. Bashkëpunimi dhe këshillimi me AKEP-in, Autoritetin e Konkurrencës, Zyrën e të Drejtave të Autorit dhe organet e tjera në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga ligji.*

Plani Kombëtar i Frekuencave miratohet nga Këshilli i Ministrave. Në zbatim të nenit 22, pika 3 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, -Roli i ministrit: “Paraqet në Këshillin e Ministrave për miratim Planin Kombëtar të Frekuencave, si dhe punon për harmonizimin e këtij plani me politikën ndërkombëtare të zhvillimit të spektrit të frekuencave”. Me urdhrin nr. 23, datë 21.07.2016, të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike është ngritur grupi i punës për përditësimin e Planit Kombëtar të Frekuencave (PKF) dhe hartimin e dokumentit të Politikës Spektrale 2016-2020.

Në zbatim të urdhrit të mësipërm AMA ka përcaktuar përfaqësuesit e saj në grupin e punës të cilët janë: z. Dritan Xhelili, Drejtor Kabineti; znj. Evgjëni Bashari, Drejtor Juridik; znj. Elveda Domi, Drejtor i Planifikimit të Frekuencave dhe TIK.

Grupi i punës ka koordinuar punën si dhe ka shkëmbyer materialet dhe dokumentet në formën elektronike. Në përfundim të hartimit të PKF nga grupi i punës Ministria përgjegjëse dërgoi për mendim draftin final tek AMA, e cila nga ana e saj e konfirmoi zyrtarisht dakordësinë mbi draftin e paraqitur. PKF është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 277, datë 29.03.2017. Në këtë plan përcaktohen brezat e frekuencave dhe shërbimet përkatëse të radiokomunikimit, gjithashtu për secilin përdorim Plani ka përcaktuar edhe administratorin e spektrit. Aktualisht grupi po vazhdon punën për hartimin e Politikës Spektrale 2016-2020.

Në nenin 79, pika 2, të ligjit 97/2013 parashikohet se AMA, për monitorimin e frekuencave, bashkëpunon me AKEP-in dhe me institucionet e tjera, të ngarkuara për administrimin e spektrit të frekuencave.

Nga ana e AMA pretendohet se kanë bashkëpunuar me AKEP për shmangien e interferencave dhe se janë ngritur grupe të përbashkëta monitorimi për të identifikuar dhe analizuar interferencat e shkaktuara dhe se në fund është bërë e mundur shmangia e këtyre interferencave në afate kohore minimale.

Në datën 23.10.2015 AMA dhe Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale kanë nënshkruar marrëveshjen për bashkëpunimin ndërmjet tyre për përmbushjen e detyrimeve reciproke që lindin nga kuadri ligjor respektiv.

Nga auditimi u konstatua që vijon puna për hartimin e Politikës Spektrale referuar pikës 5 të Urdhrit nr. 23, datë 21.07.2016, ku thuhet “Grupi i punës mblidhet me njoftimin e Kryetarit dhe funksionon për përmbushjen e detyrave të përcaktuara në këtë urdhër deri në muajin dhjetor 2016” megjithëse bazuar në afate, grupi i punës duhet të kishte përfunduar hartimin e Politikave Spektrale 2016-2020.

AMA është në fazën e hartimit të dy dokumenteve me dy institucione të tjera sa i përket përmbushjes së detyrimit ligjor për bashkëpunim. Konkretisht janë Draft marrëveshja me Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit, ZSHDA, proces i cili është ndërprerë dhe projekt-memorandumi i bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës si garantues i konkurrencës së ndershme.

AMA pretendon që ndërmjet saj dhe AKEP ekziston bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve, por grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion ndonjë dokument zyrtar i cili vërteton bashkëpunimin me AKEP.

AMA nuk e ka zbatuar germën j, pika 1, neni 19 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, sa i përket bashkëpunimit me ZSHDA dhe Autoritetin e Konkurrencës.

- ii. *Procesi i licencimit të Ofruesve të Shërbimit Mediatik Audioviziv. Trajtimi i mosmarrëveshjeve midis ofruesve të shërbimeve të transmetimeve audio ose audiovizive, përfshirë mosmarrëveshjet me transmetuesin publik.*

Në nenin 19 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” janë përcaktuar funksionet bazë të AMA-s, bazuar në informacioni e dhënë nga Drejtoria Juridike dhe e Licencave për grupin e auditimit ka rezultuar se janë kryer 31 procedura për licencime/autorizime/heqje apo pavlefshmëri licence/autorizimi, për vitin 2014; 47 procedura për licencime/autorizime/heqje apo pavlefshmëri licence/autorizimi, për vitin 2015 dhe 68 procedura për licencime/autorizime/heqje apo pavlefshmëri licence/autorizimi, për vitin 2016.

Grupi i auditimit vlerësoi procesin e licencimit për rrjetet numerike dhe programet e tyre nëpërmjet procedurës “Beauty Contest” si një proces me risk të lartë sa i përket numrit të licencave dhe kërkesave të paraqitura për marrjen e tyre, dhe në përfundim të këtij vlerësimi rezultoi:

AMA me vendimin nr. 28, datë 16.04.2015 ka miratuar rregulloren “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës së ‘Beauty Contest’”. Ndërsa me vendimin nr. 29, datë 16.04.2015, “Për çeljen e procedurës të dhënies së 5 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik, sipas ‘Beauty Contest’ AMA ka vendosur të ftojë për paraqitjen e aplikimit për licenca të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor pesë subjekte, si dhe ka bërë publikimin e çeljes së kësaj procedure.

Në mbledhjen e datës 01.02.2016, me vendimet nr. 32, nr. 34, nr. 35, AMA ka vendosur mosdhënien e licencës për shoqëritë “TV Klan” sh.a.; “Top Channel” sh.a. dhe “Digit-Alb” sh.a., për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor. Ndërsa me vendimin nr. 33, datë 01.02.2016 ka vendosur mosdhënien e licencës, shoqërisë “Supersport” sh.a., me arsyetimin se aplikimi i saj nuk ishte në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore.

Në vijim, shoqëria “Digitalb” sh.a.; shoqëria “TV Klan” sh.a. dhe shoqëria “Top Channel” sh.a., janë ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar ndryshimin e vendimeve nr. 32, nr. 34 dhe nr. 35, datë 01.02.2016 të AMA.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 80-2016-1028, datë 07.03.2016, vendosi ndryshimin e akteve administrative të AMA dhe dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv, shoqërive “Digit-Alb” sh.a.; “TV Klan” sh.a. dhe “Top Channel” sh.a.. Vendimi i mësipërm ka marrë formë të prerë 15 ditë pas shpalljes së tij, duke bërë të mundur pajisjen me licenca të subjekteve të mësipërm.

Grupi i auditimit pasi u njoh me materialet e vëna në dispozicion nga ana e AMA vërejti se nga AMA nuk është ushtruar e drejta e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë për Vendimin nr. 80-2016-1028 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” miratuar me vendimin nr. 219, datë 16.04.2015 të AMA-s,

ka miratuar fillimisht vendimin nr. 231, datë 03.11.2016 të AMA-s “Për çeljen e garës për dhënien e 2 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik”. Më pas AMA, ka publikuar, në gazetën kombëtare, shpalljen për hapjen e garës për dhënien e 2 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik për rrjetet numerike të identifikuar me nr. 006 K dhe nr. 007 K, të përbëra nga:

- Licenca të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe
- Licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor, për ndërtimin e vënien në funksionim të 2 rrjeteve numerike tokësore kombëtarë në brezat e frekuencave 470-790 MHz me gjerësi brezi 8 MHz, në teknologjinë DVBT-2, me standardin e kompresionit MPEG-4.

Në vijim pranë AMA-s janë depozituar 5 aplikime dhe konkretisht:

- 1) Shoqëria “Tring TV” sh.a. aplikimi nr. 3771 prot., datë 15.12.2016, për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.
- 2) Shoqëria “ABC Neës” sh.a., aplikimi nr. 3774, prot., datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.
- 3) Shoqëria «Media Vizion» sh.a., aplikimi nr. 3772 prot., datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.
- 4) Shoqëria “Ora” sh.a., aplikimi nr. 3775, datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare transmetimi audioviziv.
- 5) Shoqëria “ADTN” sh.a., aplikimi nr. 3773 prot., datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.

Me urdhrin nr. 172, datë 12.12.2016 të Kryetarit të AMA, bazuar në Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” u ngrit Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD). KSHD në datën 15.12.2016 ka marrë në administrim nga arkiv-protokolli dosjet e dorëzuara nga subjektet e interesuara, dhe në prani të përfaqësuesve të këtyre subjekteve ka hapur aplikimet për licencë private kombëtare transmetimi audioviziv.

KSHD në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit të subjekteve të mësipërme dhe përgatitjes së relacioneve vlerësuese për përmbushjen e kriterëve ligjore, ekonomike, organizative, teknike e programore, të përcaktuara në Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” ka dalë në përfundimet e mëposhtme:

1. Aplikimi i shoqërisë “Tring TV” sh.a. binte ndesh me dispozitat e nenit 62, pika 1 ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 9 të rregullores, ku është parashikuar se: “1. Licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepet shoqërive aksionare të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, të cilat kanë si objekt ekskluziv veprimtarinë audiovizive.... 9. Mosrespektimi i kërkesave sipas këtij neni është kusht skualifikimi..”.

Bazuar sa më sipër, AMA, në kushtet kur subjekti aplikues shoqëria “Tring TV” sh.a., ka objektin e veprimtarisë në kundërshtim me nenin 62 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 9 të Rregullore së sipërcituar, me vendimin nr. 285, datë 29.12.2016, vendosi skualifikimin e shoqërisë “Tring TV” sh.a., dhe mosdhënien e licencës kombëtare private audiovizive, subjektit aplikues shoqërisë “Tring TV” sh.a.

2. Aplikimi i shoqërisë “ABC News” sh.a., nuk ishte në përputhje me kërkesat e nenit 18, pika 1, nënpika 1.1., germa “c” të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit

audioviziv”, ku është parashikuar se: “1. Subjekti aplikues për licencë kombëtare transmetimi audioviziv duhet të plotësojnë kërkesat për kualifikim si më poshtë: 1.1 Të dhënat e aplikuesit: c. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore të aksionarëve të subjektit”.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “ABC Neës” sh.a., “Vërtetimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë të datës 13.12.2016 për aksionarët Redi Sata, Alba Gina dhe Aleksandër Frangaj në të cilën vërtetohet se personat nuk kanë proces penal pranë kësaj gjykate duke filluar nga data 01.01.2016 deri më 13.12.2016” nuk është dokumentacioni i kërkuar, referuar nenit 18, pika 1, nënpika 1.1., germa “c” “Vërtetimi i gjendjes gjyqësore”. Për sa më sipër, AMA, me vendimin nr. 284, datë 29.12.2016, vendosi skualifikimin e shoqërisë “ABC NEËS” sh.a., dhe mosdhënien e licencës kombëtare private audiovizive subjektit aplikues shoqërisë “ABC Neës” sh.a.

3. Aplikimi i shoqërisë “Media Vizion” sh.a., ishte në përputhje me kriteret e ligjit nr. 97/2013 dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”.

Në këto kushte AMA me vendimin nr. 287, datë 29.12.2016, vendosi dhënien e licencës kombëtare private të transmetimit audioviziv shoqërisë “Media Vizion” sh.a.

4. Aplikimi i shoqërisë “Ora” sh.a., nuk ishte në përputhje me kërkesat e nenit 18, pika 1, nënpika 1.4., germa “f” të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”, në të cilin kërkohet: “Depozitimi i kontratave ose marrëveshjeve paraprake me mbajtësit e të drejtave të përmbajtjes që do të transmetohen dhe ritransmetohen”. KSHD, nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatoi se dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Ora” sh.a., ishin vetëm draft marrëveshje, të panënshkruara nga asnjë prej palëve dhe të pavulosura, fotokopje, të panoterizuara, materiale në gjuhën angleze, të pashoqëruara nga përkthimi i tyre në gjuhën shqipe, si dhe një dokument ishte i nënshkruar nga përfaqësuesi i një subjekti të ndryshëm nga subjekti aplikues, shoqëria “Ora” sh.a. Për sa më sipër, AMA me vendimin nr. 283, datë 29.12.2016, vendosi skualifikimin e shoqërisë “ORA” sh.a. dhe mosdhënien e licencës kombëtare private audiovizive subjektit aplikues shoqërisë “ORA” sh.a.

Nga shqyrtimi i dosjes së paraqitur nga subjekti “ORA” sh.a., ankimuar në KLSH me shkresën nr. 58. prot. datë 12.01.2017 rezultoi se:

Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit, i ngritur me urdhrin nr. 172, datë 12.12.2016 të Kryetarit të AMA ka bërë vlerësimin e dokumentacionit dhe ka dalë në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi, shoqëria “ORA” sh.a., nuk është në përputhje me kërkesat e germës “f”, pika 1.4, nenit 18, të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” në të cilin kërkohet: “Depozitimi i kontratave ose marrëveshjeve paraprake me mbajtësit e të drejtave të përmbajtjes që do të transmetohen dhe ritransmetohen”.

Gjithashtu Komisioni sqaron se pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti është konstatuar se 4 prej tyre janë draft marrëveshje, të panënshkruara nga asnjë prej palëve dhe të pavulosura. Ndërsa dokumentet e tjera janë fotokopje, dy prej dokumenteve nuk janë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe një dokument është nënshkruar nga përfaqësuesi i një subjekti të ndryshëm nga subjekti aplikues shoqëria “Ora” sh.a.

Pas verifikimeve të mësipërme Komisioni ka vlerësuar se dokumentacioni i paraqitur nga subjekti aplikues shoqëria “ORA” sh.a, duke qenë në formën e draft-marrëveshjeve, të panënshkruara, elementë ky i rëndësishëm i vlefshmërisë së formës për një kontratë apo draft-kontratë, apo fotokopje kontratash në gjuhën angleze, ose që nuk i përkasin subjektit aplikues, nuk plotëson kushtet për t’u konsideruar kontrata apo akt-marrëveshje të vlefshme, në zbatim të

kërkesave të nenit 18, pika 1, nënpika 1.4., germa “f” të Rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”.

Për sa më sipër, AMA në zbatim të nenit 18, pika 5 të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” në të cilën parashikohet se: “Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme është kusht skualifikues”, vendos për skualifikimin dhe mosdhënien e licencës kombëtare private audiovizive subjektit aplikues shoqërisë “ORA” sh.a.

Nga auditimi, u konstatua se Vendimi i AMA për skualifikimin nga gara të subjektit “ORA” sh.a. është jo plotësisht i përligjur, pasi subjekti ka paraqitur në AMA një numër prej 8 (tetë) dokumentesh, kur rregullorja nuk shprehet për një numër minimal kontratash madje ajo shprehet se subjekti mund të paraqesë marrëveshje paraprake, të cilat rezultojnë që subjekti në fjalë i ka paraqitur gjë që vërtetohet edhe nga ana e KSHD, pra interpretimi i bërë lidhur me kërkesat e rregullores është disi tendencioz. Ky fakt provon pretendimin e paraqitur nga ky subjekt në ankesën depozituar pranë KLSH.

5. Aplikimi i shoqërisë “ADTN” sh.a., ishte në përputhje me kriteret e ligjit nr. 97/2013 dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”.

Vendimi Nr. 286, Datë 29.12.2016 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë ‘ADTN’ sh.a., për licencë kombëtare private transmetimi audioviziv” ka rezultuar pa lëshim licence. Në këtë rast është vendosur si më poshtë:

Mosdhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv, shoqërisë “ADTN” sh.a., për shkak të mungesës të kuorumit të nevojshëm ligjor për lëshimin e licencës, neni 19, pika 1, germa “b” i ligjit 97/2013. AMA nuk lëshoi licencën për këtë subjekt për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm prej 5 votash. Rezultati i votimit ka qenë: 3 vota pro dhe 3 vota kundër, një anëtar i AMA ka qenë në mungesë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbledhjes së datës 29.12.2016 të AMA u vërejt se për vendimin nr. 286 ka patur koment të votës nga ana e tre anëtarëve që kanë votuar pro mosdhënies së licencës shoqërisë ADTN. Ky koment ka konsistuar në faktin se:

Shoqëria “Digit-Alb” sh.a. është e pajisur me një licencë kombëtare ndërkohë që është aksionari me 100% të aksioneve në një tjetër shoqëri, “ADTN” sh.a. që sërish pretendon një licencë kombëtare duke qenë kështu në kundërshtim me nenin 62/4 të ligjit 97/2013 i cili shprehet se : “4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale”. Gjithashtu vendimi bie në kundërshtim me nenin 9/2,3,4, të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” ku shprehet se: “2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri janë nominativë. 3. Në kuptim të këtij neni aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë. 4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20% të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audioviziv.

Për transmetimet analoge lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10% në një shoqëri të tretë kombëtare”.

Për sa më sipër nuk është zbatuar pika 9/9 e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” ku thuhet se: “Mos respektimi i kërkesave sipas këtij neni është kusht për skualifikim”.

Shoqëria “Digit-Alb” sh.a. dhe shoqëria “Top Channel”, që mbajnë aksione të njëra tjetrës dhe janë të lidhura përmes biznesit, kanë marrë secila nga një frekuencë transmetimi kombëtare duke respektuar në këtë rast jo thjesht ligjin por edhe kapacitet e tyre në treg dhe investimin që ato kanë bërë në transmetimet numerike. Një licencë e tretë (shoqëria “ADTN” sh.a. me pronar 100% të aksioneve shoqërinë “Digit-Alb” sh.a.), për këtë grup aksionaresh do të rëndonte mbi sigurimin jo vetëm të pluralizmit në media por edhe të konkurrencës së ndershme, siguri i të cilës është një nga funksionet bazë të AMA (neni 19 “Funksionet e AMA-s”, pika 1/c të ligjit 97/2013 ku thuhet: “c) garantimi i konkurrencës së ndershme, duke siguruar njëkohësisht zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së”).

Lidhur me sa më sipër është observuar nga Shoqëria “ADTN” sh.a.:

Pas marrjes së njoftimit për vendimin nr. 286, datë 29.12.2016 të AMA, shoqëria ka depozituar pranë AMA kërkesën me nr. 3922/1 prot., datë 06.01.2017 për revokim të vendimit nr. 286, datë 29.12.2016, me arsyetimin se:

“Vendimi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin për mediat dhe procedurat ligjore të parashikuara në ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”...

...ka rezultuar se tre nga anëtarët e AMA kanë votuar për mosdhënien e licencës dhe tre anëtarë të tjerë kanë votuar për dhënien. Lidhur me këtë pikë vlen të theksojmë se dhe anëtarët e AMA-s, që kanë votuar për mosdhënien e licencës nuk e kanë kundërshtuar faktin se subjekti aplikues përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga ligji për mediat dhe rregullorja e AMA- së..

Në nenin 19.1. germa “b” e ligjit për Mediat përcaktohet se dhënia e licencave bëhet me një shumicë të cilësuar. Pra duke qenë se në votimin e AMA nuk është arritur një shumicë e cilësuar prej 5 votash për dhënien e licencës, atëherë minimalisht AMA duhet që të vepronte në përputhje me parimin e arritjes së shumicës vendimmarrëse në zbatim të nenit 14.2 të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” ku përcaktohet se Kur kërkohet një shumicë e cilësuar dhe kjo nuk arrihet, kryhet një votim i dytë. Në qoftë se edhe në votimin e dytë do të përsëritet e njëjta situatë, vendimi shtyhet për t’u marrë në mbledhjen tjetër, në të cilën një shumicë e thjeshtë do të ishte e mjaftueshme.

Kështu pas mosarritjes së shumicës së cilësuar në votimin e parë duhet të ishte proceduar me një votim të dytë e nëse në përfundim të tij ende nuk do të ishte arritur shumica e cilësuar në vendimmarrje atëherë vendimi duhet të ishte shtyrë për t’u marrë në një mbledhje tjetër me një shumicë të thjeshtë. Por kjo procedurë ligjore nuk është zbatuar nga AMA... duke cenuar në këtë mënyrë të drejtat e subjektit aplikues e duke na mohuar padrejtësisht të drejtën për t’u pajisur me licencë kombëtare...

AMA në lidhje me pretendimet e parashtruara nga kërkuesi shoqëria “ADTN” sh.a., mbi detyrimin për të respektuar kërkesat e ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” në rastet e mosarritjes së shumicës së cilësuar, në kushtet kur ky subjekt ka paraqitur një aplikim në përputhje me kërkesat ligjore, programore, ekonomike, organizative e teknike në mbështetje të aplikimit të tij, AMA vlerëson se këto pretendime janë të mbështetura si në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat

audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, si dhe praktikën gjyqësore për një rast të ngjashëm.

Kështu, neni 13 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si ligj i posaçëm, që rregullon ndër të tjera, organizimin dhe funksionimin e AMA-s, lidhur me kuorumin dhe vendimmarrjen, në mënyrë të shprehur parashikon në pikën 5 se: “Procedurat e vendimmarrjes, zbatimi i tyre dhe thirrja e mbledhjeve jashtë radhe hartohen sipas dispozitave të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe janë pjesë e rregullores së brendshme”.

Në kushtet kur vetë ligji i posaçëm nr. 97/2013 parashikon në mënyrë të shprehur zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8480/1999 lidhur me procedurat e vendimmarrjes, ky i fundit në nenin 14 ka parashikuar procedurën e detyrueshme për t’u ndjekur në rastin e vendimeve me shumicë të cilësuar.

Neni 14 i ligjit nr. 8480/1999 ka parashikuar në rastin e kërkuar të vendimmarrjes me shumicë të cilësuar, një mekanizëm zhblokimi, kur kjo shumicë nuk mund të arrihet, me qëllim mundësimin e funksionimit normal të procesit vendimmarrës të një organi kolegjial, duke theksuar se: “1. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilësuar. 2. Kur kërkohet një shumicë e cilësuar dhe kjo nuk arrihet, kryhet një votim i dytë. Në qoftë se edhe në votimin e dytë do të përsëritet e njëjtë situata, vendimi shtyhet për t’u marrë në mbledhjen tjetër, në të cilën një shumicë e thjeshtë do të ishte e mjaftueshme”.

Në analizë të sa më sipër, AMA vlerëson se në kushtet kur ligji nr. 97/2013, si ligj i posaçëm referon në mënyrë të shprehur në zbatimin e dispozitave të ligjit nr. 8480/1999 akti administrative nr. 286, datë 29.12.2016 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a., për licencë kombëtare të transmetimit audioviziv” është marrë në mosrespektim të procedurës, në kuptim të nenit 109, germa b të K. Pr. Administrative, për këtë shkak duhet të anulohet dhe të procedohet me hedhjen në votim të aplikimit të paraqitur nga shoqëria “ADTN” sh.a., për marrjen e licencës kombëtare private audiovizive.

Ky qëndrim është mbajtur edhe në vendimin nr. 1044 (80-201-1028), datë 07.03.2016, të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ku për një rast të ngjashëm, mosdhënie licencë për mungesë kuorumi, kjo gjykatë ka theksuar se: “.....pas realizimit të votimit të parë, provohet qartësisht se ka shkelur ligjin duke mos realizuar një votim të dytë sipas parashikimeve të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999... AMA, pas dështimit të realizimit të votimit të parë për të tentuar arritjen e një shumice të cilësuar prej 5 votash për vendimmarrjen e saj duhet të kishte proceduar me realizimin e një votimi të dytë dhe nëse edhe në votimin e dytë sërish nuk do të arrihej një shumicë e cilësuar atëherë vendimi duhet të ishte shtyrë për t’u marrë në mbledhjen tjetër në të cilën ky vendim duhet të ishte marrë me një shumicë të thjeshtë. Në këtë kuadër gjykata çmon se vendimmarrja përkatëse që ka rrëzuar aplikimin e paditësve është marrë në zbatim të gabuar të ligjit material e atij procedural që ka parashikuar pikërisht një mekanizëm të tillë ligjor zhblokues siç është rihedhja në votim për arritjen e shumicës së cilësuar e më pas shtyrja e vendimmarrjes duke proceduar me marrjen e saj me një shumicë të thjeshtë votash për të garantuar funksionimin e organit kolegjial dhe bllokimet e mundshme të tij për shkak të votës së pakicës....”. Me këtë vendim, tashmë të formës së prerë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur shfuqizimin e vendimeve të AMA-s dhe dhënien e licencave subjekteve aplikuese.

Pas këtij observimi, AMA, në mbledhjen e datës 19.01.2017, ka shfuqizuar vendimin nr. 286, datë 29.12.2016, duke vendosur të procedojë në zhvillimin e votimit të aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a. Ashtu si rezulton në procesverbalin e mbajtur në mbledhjen e datës 19.01.2017 në votimin e parë mbi shqyrtimin e aplikimit të kërkesës shoqërisë “ADTN” sh.a., rezultati i votimit ishte 4 anëtarë pro dhënies së licencës subjektit dhe 3 anëtarë kundër këtij aplikimi. Në këto kushte, në vijim të diskutimeve të anëtarëve, u vendos zhvillimi dhe votimi i dytë lidhur me aplikimin e shoqërisë “ADTN” sh.a., gjatë të cilit u arrit i njëjti rezultat ku 4 anëtarë votuan pro dhënies së licencës subjektit dhe 3 anëtarë votuan kundër këtij aplikimi, duke u shtyrë vendimmarrja për mbledhjen e radhës, së datës 27.01.2017.

Në mbledhjen e zhvilluar në datën 27.01.2017 vijoi zhvillimi i procedurës vendimmarrëse lidhur me aplikimin e shoqërisë “ADTN” sh.a., gjatë të cilës rezultoi se 4 anëtarë ishin pro dhënies së licencës subjektit shoqërisë “ADTN” sh.a., dhe 3 anëtarë ishin kundër këtij aplikimi.

Në përfundim, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 13 pika 5 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neneve 113, 114, 117 dhe 136 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, dhe nenit 14 paragrafi 2 i ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” AMA ka vendosur: Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë “ADTN” sh.a., dhe anulimin e vendimit të AMA-s, nr. 286, datë 29.12.2016 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a., për licencë kombëtare private transmetimi audioviziv”, duke vendosur: Dhënien e licencës kombëtare private të transmetimit audioviziv, shoqërisë “ADTN” sh.a., për një periudhë prej 15 vjetësh...

Pra është lehtësisht e verifikueshme se në vendimet e saj për lëshimin e licencave, AMA ka vepruar në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Në vendimet e AMA është përdorur termi “mosdhënie”, për rastet kur është vendosur lëshimin ose jo të licencave, ky term, “mosdhënie” nuk gjen pasqyrim në ligjin organik të AMA. Ligji gjatë procesit të vendimmarrjes njihet “lëshimin” ose “heqjen” e licencave dhe logjikisht edhe të kundërtën e këtij veprimi, “moslëshimin” ose “mosheqjen”. Termi “mosdhënie” gjendet në pikën 1 të nenit 20 të Rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” e miratuar me Vendimin nr. 219, datë 12.10.2016, të AMA ku thuhet: “Vendimi për dhënien ose mosdhënien e licencës së transmetimit audioviziv ose shërbimit të programit audioviziv jepet nga AMA. Nga sa më sipër vërehet gabim material në vendimet e AMA ku shprehet për dhënien/mosdhënien e licencave term i cili nuk njihet nga ligji organik i AMA, gabim i cili vërehet edhe në pikën 1 të nenit 20 të Rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”.

Gjithashtu, gjykojmë se Vendimi nr. 286, datë 29.12.2016 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a., për licencë kombëtare private transmetimi audioviziv” rezulton të jetë:

- në kundërshtim edhe me nenin 62, pika 4 të ligjit 97/2013;
- në kundërshtim me nenin 9, pikat 2,3 dhe 4, të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”.

Konstatojmë se nuk është zbatuar pika 9, neni 9 i rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” dhe për sa më sipër është rrezikuar konkurrenca e ndershme, siguri i së cilës është një nga funksionet bazë të AMA (neni 19 “Funksionet e AMA-s”, pika 1, germa “c” e

ligjit 97/2013 ku thuhet: “garantimi i konkurrencës së ndershme, duke siguruar njëkohësisht zhvillimin e mëtejshëm të RTSH-së”). Një prej argumenteve për mos skualifikimin dhe futjen në garë të shoqërisë ADTN është se: “Aksionet e shoqërisë “Digit-Alb” sh.a., janë nominativë për aksionarët e saj dhe jo për shoqërinë “Digit-Alb” sh.a., si person juridik, i cili gëzon personalitet të ndryshëm juridik nga aksionet e saj”. Ky argument sipas AMA gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, në Vendimin nr. 47, datë 14.09.2015.

Në këtë vendim Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur specifikisht për çështjen objekt gjykimi e cila është e ndryshme nga çështja për të cilën është marrë vendimi 286, datë 29.12.2016, gjithashtu vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë i referohet ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i cili është shfuqizuar.

Edhe nëse çështja të cilës i referohet Vendimi i Kolegjit do të ishte e ngjashme me atë të vendimit 286 të AMA -s, apo ligji nr. 8410, datë 30.09.1998, të cilit i referohet Vendimi i Kolegjit nuk do të ishte shfuqizuar, jurisprudenca shqiptare nuk e njeh aplikimin e precedentit në praktikën e saj, që do të thotë se nuk mund të merret për referencë dhe të përgjithësohet vendimi për një çështje të shqyrtuar në çështje të tjera të ngjashme me të. Vetëm vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë forcën e ligjit dhe mund të përdoren si të tilla.

Vendimi 5, datë 27.01.2017 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a., për licencë kombëtare private transmetimi audioviziv”, nuk është marrë në referim të nenit 19, pika 1, germa “b”, të ligjit 97/2013, “lëshon dhe heq licencat dhe/ose autorizimet me shumicë të cilësuar”;

Në mbledhjen e kësaj date, AMA ka marrë në shqyrtim kërkesën e subjektit “ADTN” sh.a. me nr. 3922/1 prot., datë 06.01.2017 për revokim të vendimit nr. 286, datë 29.12.2016. Në këtë kërkesë subjekti kërkon vendimmarrje bazuar në ligjin ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike.

-Në lidhje me argumentin e përdorur në kërkesën e shoqërisë “ADTN” sh.a., se në vendimin nr. 286, datë 29.12.2016, anëtarët që kanë votuar pro nuk kanë kundërshtuar faktin se subjekti aplikues përmbush të gjitha kriteret e kërkuara nga ligji për mediat dhe rregullorja e AMA, në komentin e votës së tyre anëtarët në fjalë kanë sqaruar se vendimi nr. 286 është në kundërshtim me pikat 2,3,4, të nenit 9 të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” dhe se për këtë arsye duhej zbatuar pika 9, neni 9 i të njëjtës rregullore dhe si rezultat subjekti “ADTN” sh.a. duhet të skualifikohej.

-Sa i përket faktit se AMA duhet të kishte përdorur dispozitat të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” mendojmë se: Ky ligj nuk mund të aplikohet për rastet e lëshimit apo heqjes së licencave pasi ligji organik i AMA qartësisht përcakton mënyrën e votimit për lëshimin apo heqjen e licencave duke kërkuar shumicë të cilësuar. Arsyeja pse ligjvënësi ka vendosur këtë formë detyruese votimi është sepse kjo mënyrë votimi imponon konsensus të gjerë në vendimmarrjen e anëtarëve të AMA për faktin se fusha në të cilën operon AMA është shumë specifike dhe me këtë mënyrë votimi do të sigurohej ruajtja e ekuilibrave të këtij tregu si dhe mbrojtjen e tij nga monopoli.

Në lidhje me argumentimin se përdorimi i dispozitave të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, është i mbështetur edhe në vendimin nr. 1044 (80-201-1028), datë 07.03.2016, të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk është i saktë sepse në praktikën ligjore shqiptare nuk njihet aplikimi i precedentit, pra nuk mund të merret për referencë dhe të përgjithësohet vendimi për një çështje të shqyrtuar në çështje të tjera të ngjashme me të dhe vetëm vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë forcën e ligjit dhe mund të përdoren si të tilla.

Gjithashtu kjo është paragjyquese për vendimmarrjen e sistemit gjyqësor nëse vendimi i AMA për moslëshimin e licencës do të goditej në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Askush nuk mund të paragjykojë vendimin e një shkalle të gjyqësorit i cili merret i bazuar në provat dhe faktet e bëra prezent nga palët si dhe në bindjen e brendshme të trupës gjyquese.

Nga auditimi është konstatuar se në zbatim të pikës 3, neni 19 i ligjit nr. 97/2013 “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” nga ana e strukturave të AMA janë kryer kontrole/inspektime për zbatimin e ligjit nga ana e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të ligjit dhe janë vendosur sanksione për rastet e shkeljeve. Subjektet të cilat janë ndëshkuar për shkeljet e konstatuara nga ana e grupeve të inspektimit kanë ushtruar të drejtën e ankimit të sanksionit të vendosur. Në përfundim të procesit të ankimit AMA është shprehur për shfuqizimin e sanksionit me gjobë në masën 63.9% të numrit të përgjithshëm të sanksioneve të aplikuara dhe në masën 60.4% të vlerës totale të gjobave të vendosura. Më konkretisht:

Te dhëna për gjobat të cilat janë ankimuar nga subjektet private në AMA

		Të aplikuara	Të shfuqizuara	Shfuqizuar në %
Viti 2014	Numri i Gjobave	25	17	68%
	Vlera në lekë	23,300,000	15,300,000	65.60%
Viti 2015	Numri i Gjobave	66	37	56.06%
	Vlera në lekë	105,400,000	62,400,000	59.20%
Viti 2016	Numri i Gjobave	70	49	70%
	Vlera në lekë	77,090,000	46,740,000	60.63%
Totali	Numri i Gjobave	161	103	63.97%
	Vlera në lekë	205,790,000	124,440,000	60.46%

Nisur nga fakti se AMA është një institucion i pavarur i cili vetëfinancohet por edhe nga të dhënat e mësipërme grupi i auditimit verifikoi rastet shfuqizimit të sanksioneve me gjobë të marra nga ana e AMA dhe arriti në konkluzionin se:

AMA në të gjitha rastet e shfuqizimit të sanksioneve me gjobë, të vendosura nga grupet e inspektimit, ka marrë në konsideratë pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga ana e subjekteve ankimes dhe ka rrëzuar faktet e paraqitura nga grupet e inspektimit, të cilat kanë qenë të bazuara në kuadrin ligjor, rregullator të fushës, në fuqi. Pra, AMA ka favorizuar subjektet shkelës të ligjit të përfitojnë në mënyrë të padrejtë, duke i shkaktuar dëm buxhetit (80% e vlerës së gjobës shkon në buxhetin e shteti dhe 20% e saj shkon në buxhetin e AMA), në vlerën 124,440,000 lekë. AMA referuar germës “ç”, “raporton në Kuvend për veprimtarinë vjetore të AMA-s”, pika 2, neni 14 të ligjit 97/2013 “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” ka detyrim raportimin në Kuvendin e Shqipërisë të veprimtarisë së saj vjetore. Nga auditimi u vërejt se në asnjë prej viteve 2014, 2015 dhe 2016, AMA nuk ka përfshirë në raportin e veprimtarisë së saj, drejtuar Kuvendit problematikën e false së gjobave ndaj subjekteve të cilët konsiderohen shkelës të ligjit në fushën e mediave audiovizive.

iii. *Përgatitja dhe nxjerrja e udhëzimeve për RTSH-në, në lidhje me përmbushjen e detyrimeve, përcaktimi i kriterëve dhe masave rregulluese për bashkë përdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së.*

Bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar, RTSH kryen shërbime të transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Veprimtaria e RTSH-së rregullohet sipas përcaktimeve

të këtij ligji, deklaratës së qëllimit dhe kontratës së shërbimit të transmetimit publik të miratuar nga AMA. Në nenin 117 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. RTSH-ja, pas realizimit të një konsultimi publik, përgatit, jo më vonë se 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe më pas çdo 5 vjet, një kontratë të shërbimit të transmetimit publik, ku përcakton parimet që zbaton dhe veprimtaritë që merr përsipër për përmbushjen e qëllimeve të veta si transmetues publik, të cilën ia paraqet AMA-s.

2. Kontrata e shërbimit të transmetimit publik duhet të parashikojë, veç të tjerash:

a) natyrën dhe numrin e orëve të programeve të transmetimit për të miturit;
b) natyrën dhe numrin e orëve të programeve të transmetimit për shkencën dhe teknologjinë;

c) numrin e botimeve që duhet të përgatisë, botojë dhe shpërndajë në përputhje me qëllimet e veta si transmetues publik;

ç) përpilimin, publikimin dhe shpërndarjen e materialeve audiovizive, të regjistruara në përputhje me qëllimet e veta si transmetues publik.

3. AMA mund të nënshkruajë kontratën e shërbimit të transmetimit publik ose të kërkojë rishikimin e saj brenda 30 ditëve nga paraqitja e saj.”

Në përmbushje të detyrimit të nenit 117, pika 1, RTSH, në muajin prill 2014, në përputhje me afatin ligjor, ka paraqitur në AMA për miratim një kontratë. Për shkak të mungesës së vendimmarrjes nga ana e Këshillit të AMA, prej muajit prill 2014, kontrata e mësipërme rezultoi të mos jetë miratuar (sipas parashikimit në pikën 3 të nenit 117 të ligjit 97/2013),

Por nga vlerësimi i përmbajtjes së dokumentit të paraqitur rezultuan mangësi serioze në dokumentin e propozuar për miratim, plotësimi i të cilave do ta kthente kontratën në një dokument funksional për rregullimin e veprimtarisë së RTSH-së si transmetues publik.

Në kontratën e shërbimit të paraqitur për miratim në vitin 2014, përgjithësisht ishin të evidentuara çështjet themelore të veprimtarisë së RTSH ashtu siç figurojnë në dispozitat e ligjit, pa realizuar detajimin dhe konkretizimin e tyre duke sjelle si pasojë pamundësinë e evidentimit të përmbushjes nga ana e RTSH-së të detyrimeve kundrejt publikut.

Konkretisht:

1. Lidhur me anën procedurale nuk kishte të dhëna mbi realizimin e procesit të konsultimit publik gjatë procesit të hartimit të kontratës, kërkesë ligjore e parashikuar në nenin 117 të ligjit.

2. Në dokumentin e paraqitur nuk specifikoheshin kanalet (katalogu i programeve) që transmetohen apo parashikohet të transmetohen brenda afatit pesëvjeçar të vlefshmërisë së kontratës.

2.1. Në kontratë nuk përfshihet detyrimi i përcaktuar në nenin 119 të ligjit ku përcaktohen programet e detyrueshme të RTSH-së

Duke qenë se kanalet e mbështetura në rrjete analoge tokësore do të transferohen në format digjital në kontratë duhet të përcaktohen edhe kanalet shtese, të përgjithshëm apo tematikë që do të transmetohen pa pagesë në përmbushje të misionit publik të RTSH-së.

2.2. Përveç kanaleve të përshkruara në pikat 2.1 dhe 2.2 RTSH ka të drejtë të propozojë krijimin e kanaleve të reja që përmbushin kërkesat e publikut për informim, edukim dhe argëtim në funksion të misionit publik. Këto kanale të reja duhet të miratohen nga AMA pas organizimit të konsultimit publik.

2.3. Kapacitetet e lira në rrjetet numerikë të RTSH-së do të mbeten në dispozicion të mbështetjes, kundrejt pagesës të kanaleve lokale ekzistues.

3. Kontrata nuk zgjidhte çështjet e parashikuara në nenin 126 të ligjit.. “RTSH-ja, në bazë të kontratës që lidh me AMA-n, krijon, shfrytëzon dhe vë në funksionim një rrjet numerik kombëtar për të realizuar transmetimet numerike për:

a) shërbimet e veta audio dhe audiovizive pa pagesë; (trajtuar në pikën më lart)

b) shërbime të tjera me natyrë publike, të përcaktuara si të tilla nga AMA;

c) shërbime të transmetuesve të tjerë, në bazë të kontratave përkatëse.

4. Plotësimi i kërkesave të mësipërme lidhur me transmetimet audiovizive duhet të plotësohet gjithashtu edhe me të dhënat mbi strukturën programore të secilit kanal, grilën e strukturës programore etj.

5. Në kontratë nuk është përfshirë detyrimi që përcaktohet në nenin 123 të ligjit, sipas të cilit:

“Brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit financiar, RTSH-ja përgatit një raport për AMA-n për:

a) prodhimet e porositura gjatë vitit të kaluar nga fondi i prodhimit të pavarur;

b) emrin e shoqërisë ose personave të kontraktuar për këtë qëllim;

c) përdorimin e fondit të prodhimit të pavarur gjatë vitit të kaluar dhe shumën e mbetur pa u shpenzuar;

ç) çdo çështje tjetër që lidhet me ato të përcaktuara në shkronjat “a” deri në “c” të kësaj pike që AMA mund të kërkojë...”

6. Nuk ishte paraqitur projekti teknik i rrjetit analog & digjital, numri i transmetuesve, përsëritësit dhe lidhjeve radiorele, pajisjet satelitore dhe lejet përkatëse të AKEP.

7. Në kontratën e paraqitur nga RTSh nuk është trajtuar detyrimi i RTSh për ofrimin e infrastrukturës së tij për mbështetjen e operatorëve të tjerë kombëtarë, rajonale apo lokalë si një element për optimizmin e kostove, i përcaktuar nga neni 122 i ligjit 97/2013.

Në këto kushte, ka vijuar komunikimi shkresor me RTSH-në për sjelljen e dokumentit në harmoni me kërkesat e ligjit.

Konkretisht, AMA me shkresat nr. 581 prot., datë 03.04.2015; nr. 937 prot., datë 22.05.2015; nr. 1329 prot., datë 02.07.2015 ka kërkuar nga RTSh përshpejtimin e procesit për hartimin dhe miratimin nga KDRTSH së kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik.

Në vijim, me shkresat nr. 850 prot., datë 11.03.2016; nr. 2080 prot., datë 06.07.2016 AMA ka kërkuar nga RTSH informacion mbi ecurinë e procesit të hartimit të kontratës së shërbimit të transmetimit publik, ndërsa me shkresat nr. 2581/3 prot., datë 04.10.2016; nr. 3529/1 prot., datë 07.12.2016 ka dërguar komente mbi draftin e propozuar prej tyre

RTSH me shkresat nr. 2581/2 prot., datë 27.09.2016; nr. 3529 prot., datë 11.11.2016 ka dërguar draft kontratën e shërbimit të transmetimit publik.

RTSH me shkresën nr. 395 prot., datë 03.02.2017, administruar në AMA me nr. 622 protokolli, i datës 06 shkurt 2017, ka përcjellë kontratën e rishikuar së shërbimit të transmetimit publik AMA- RTSH. Në këtë shkresë, theksohet se Këshilli Drejtues i RTSH-së, me vendimin nr. 18, datë 31 janar 2017 ka miratuar kontratën e shërbimit, e cila është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së dokumentit të depozituar rezulton se janë pasqyruar sugjerimet e AMA-s, mbi riformulimin e disa neneve të kontratës. Në kontratën e shërbimit të paraqitur për miratim, janë evidentuar dhe rregulluar çështjet themelore të veprimtarisë së RTSH.

Pasi është përfunduar procesi i këshillimit publik, kryer prej RTSH-së, ky i fundit, në muajin nëntor 2016, ka depozituar në AMA, kontratën e nënshkruar të shërbimit të transmetimit publik. Në vijim, AMA, me shkresën nr. 3529/1 protokolli të datës 07 dhjetor 2016, ka bërë propozime dhe komente mbi projekt kontratën e hartuar nga RTSH.

Këshilli Drejtues i RTSH-së, me Vendimin nr. 18, datë 31 janar 2017 ka miratuar kontratën e shërbimit të transmetimit publik dhe ka kërkuar miratimin nga AMA.

AMA, konstatoi se dokumenti i ripropozuar për miratim është në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 97/2013, të sipërcituar dhe me vendimin nr. 18, datë 02.03.2017, miratoi kontratën e shërbimit të transmetimit publik.

Në këtë kontratë gjejnë rregullim çështjet ligjore, teknike, programore dhe financiare të marrëdhënies AMA-RTSH dhe parashikohen natyra dhe numri i orëve të programeve për të miturit, programet e transmetimit për shkencën dhe teknologjinë. Pjesë e kontratës së shërbimit të transmetimit publik është përcaktimi i kritereve dhe masave rregulluese për bashkpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së, lista e programeve audiovizive të RTSH-së, infrastruktura e transmetimit të RTSH-së si dhe përcaktimi i masave për të siguruar akses në informacion nga ana e personave me aftësi të kufizuara.

Kontrata e shërbimit të transmetimit publik konsiderohet si akti që rregullon marrëdhënien midis AMA-s, si autoritet rregullator për transmetimet audiovizive dhe RTSH-së, si operatori publik, misioni i të cilit është informimi, edukimi dhe argëtimi i publikut, përfshirë pakicat kombëtare.

Lidhur me përcaktimin e kritereve dhe masave rregulluese për bashkpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së, neni 122 i ligjit parashikon se:

“1. AMA, pas këshillimit me RTSH-në, mund t’i kërkojë kësaj të fundit të bashkëpunojë me një të licencuar për transmetime audio ose audiovizive, për përdorimin e mjeteve të infrastrukturës së shpërndarjes së sinjalit, për shërbimet e transmetimit audio ose audioviziv të licencës përkatëse.

2. I licencuari i shërbimit të transmetimit audio ose audioviziv i paguan RTSH-së, tarifat periodike për përdorimin e infrastrukturës së transmetimit.

3. Tarifat hartohen bazuar në parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Ato propozohen nga RTSH-ja dhe miratohen nga AMA, e cila shprehet brenda 30 ditëve nga paraqitja e propozimit. Nëse AMA nuk shprehet brenda këtij afati, tarifat konsiderohen të miratuara.”

Në zbatim të kësaj dispozite, AMA ka hartuar një draft rregullore e cila ka për qëllim të parashikojë rregullat dhe procedurat për bashkpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së nga ofruesit e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv të licencuar për transmetime audio dhe/ose audiovizive tokësore. Deri në përfundim të këtij auditimi statusi i draft rregullores mbetet i pandryshueshëm.

Sqarim i audituesit.

Nga ana e subjektit të audituar Autoriteti i Mediave Audiovizive me shkresën nr. 2678/1, datë 12.09.2017 dalëse dhe nr. 305/8, datë 12.09.2017 hyrëse në KLSH janë paraqitur observacionet për Projektraportin e auditimit. Sa i përket observimit në lidhje me pikën e auditimit, “Mbi zbatimin e ligjshmërisë në realizimin e misionit dhe funksioneve që kryen AMA” nga ana e grupi të auditimit merret në konsideratë vetëm observimi në lidhje me gjykimin e grupit të auditimit se: “...Nga sa më sipër vërehet gabim material në vendimet e AMA ku shprehet për dhënien/mosdhënien e licencave term i cili nuk njihet nga ligji organik i AMA...”. Sa i përket observimeve të paraqitura në lidhje me gjetjet e tjera të kësaj pike të auditimit grupi i auditimit vijon të ketë të njëjtin opinion ashtu si edhe në Projektraport dhe vendos të mos i marrë në konsideratë.

b. Programimi dhe realizimi i planifikimit të shpenzimeve. Auditimi i llogarive

Nxjerrja e bilancit kontabël në afat, plotësimi i pasqyrave financiare përkatëse në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj”, i ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.

Nga auditimi ka rezultuar se në Autoritetin e Mediave Audiovizive mbajtja e kontabilitetit për periudhën objekt auditimi, është bërë në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” me ndryshimet. Struktura, funksionimi dhe mbyllja e llogarive vjetore është bërë në bazë të vendimit të KM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik të organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore si dhe njësitë që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa e ndryshime të VKM nr. 248, datë 10.04.1998”.

Nga AMA në përgjithësi janë zbatuar Udhëzimi Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e llogarive vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë të menaxhimit-zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donator të huaj”, të ndryshuar.

Sipas Kapitullit I “Procedurat e raportimit të Pasqyrave Financiare”, janë përgatitur, depozituar dhe dorëzuar llogaritë vjetore në organet përkatëse si më poshtë:

Për vitin ushtrimor 2014 Pasqyrat Financiare janë përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar) me shkresën nr. 540 prot., datë 30.03.2015. Bilanci është shqyrtuar e miratuar nga AMA me Vendimin nr. 23, datë 01.04.2015.

Për vitin ushtrimor 2015 Pasqyrat Financiare janë përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar) me shkresën nr. 1020 prot., datë 31.03.2016. Bilanci është shqyrtuar e miratuar nga AMA me Vendimin nr. 53, datë 29.03.2016.

Për vitin ushtrimor 2016 Pasqyrat Financiare janë përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave (Drejtorinë e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar) me shkresën nr. 1300 prot., datë 31.03.2017. Bilanci është shqyrtuar e miratuar nga AMA me Vendimin nr. 29, datë 29.03.2017.

Bilancet Kontabile për të tre vitet e audituara janë plotësuar, shqyrtuar, miratuar e dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 të ndryshuar dhe janë shoqëruar me relacionet përkatëse si dhe me analiza të debi kredive sipas grupeve e llogarive në Aktiv e Pasiv.

Treguesit kryesorë të Balanceve sipas viteve paraqiten si më poshtë:

AKTIVI I BILANCIT

Në lekë

Llog.	Emërtimi i Llogarisë	2013	2014	2015	2016
A	Nr. AKTIVE të QENDRUSHME	27,698,026	21,936,038	19,897,564	57,387,371
21,23,24,28	Aktive të Qendëruara të Trupëzuara	27,608,026	21,846,038	16,099,287	51,078,663
212	Ndërtime e Konstruksione				34,899,242
214	Instalime, teknike, makineri, pajisje	11,483,764	11,642,006	15,005,815	19,522,571
215	Mjete transporti	10,243,314	10,243,314	10,243,314	13,855,314
218	Inventari ekonomik	93,992,559	94,103,605	3,753,825	3,065,848
219	Amortizimi i aktiveve QT (-)	-89,581,710	-95,612,986	-12,903,667	-20,264,312
232	Shpenzime proces transferimi kapital	1,470,099	1,470,099		
B	AKTIVE QARKULLUESE	377,017,267	404,614,663	385,826,038	416,835,743

	Gjendje e Inventarit	3,060,838	2,098,503	2,582,335	3,039,950
31	Materiale	3,060,838	2,098,503	2,582,335	3,039,950
	Kërkesa Arkëtuar mbi Debitorët	350,719,884	362,807,296	302,330,603	313,178,764
411-418	Klientë e Llogari të ngjashme	119,532,813	97,231,993	302,138,821	257,153,787
423,429	Personeli, deficite e gjoba	177,290,000	196,361,332	139,758	64,166
431	Të drejta e Taksa	8,289,859	8,744,159		
468	Debitorë të ndryshëm	45,607,212	60,469,812		93,722,615
49	Shuma të parash. për zhvlerësim				-37,766,545
	Llogaritë Financiare	23,236,545	39,708,864	80,913,100	100,617,029
512	Llogari në Bankë	23,193,194	39,630,985	80,912,563	100,616,492
520	Disponibilitete në Thesar	43,351	77,879	537	537
	TOTALI I AKTIVIT	404,715,293	426,550,701	405,723,602	474,223,114

PASIVI I BILANCIT

lekë

Nr. Llog.	Emërtimi i Llogarisë	2013	2014	2015	2016
A	FONDE TE VETA	394,389,174	408,186,870	197,709,646	179,459,019
101	Fonde Bazë	394,389,174	408,186,870	197,709,646	179,459,019
B	DETYRIME	6,210,700	1,792,900	331,264,583	333,969,964
401	Furnitorë e llogari të lidhura			67,590	11,234,158
	Detyrime afatshkurtër			331,264,583	333,969,964
431	Detyrime shtetit për T. Taksa	6,210,700	1,792,900		1,373,113
4341	Të tjera operacione me shtetin			218,937,286	230,064,562
437	Organizata të tjera shoqërore			909,982	1,589,747
467	Kreditorë të ndryshëm			111,348,570	89,494,892
	REZULTATI I USHTRIMIT	4,115,419	16,570,931	-123,250,627	-39,205,869
	TOTALI I PASIVIT	404,715,293	426,550,701	405,723,602	474,223,114

Nisur nga të dhënat e mësipërme dhe relacionet bashkangjitur Pasqyrave Financiare sipas viteve rezultojn:

Për vitin 2014: Në total Aktivit dhe Pasivi i Bilancit për vitin 2014 krahasuar me vitin 2013 është rritur për shumën 21,835,408 lekë.

Në Aktiv: Aktivët e Qëndrueshme janë ulur për shumën 5,761,988 lekë nga të cilat Aktivët e Qëndrueshme të Trupëzuara janë ulur për shumën 5,761,988 lekë, kjo si rezultat i llogaritjes së amortizimit për shumën 6,031,276 lekë dhe i rritjes së zërit Instalime, teknike, makineri, padisje për shumën 158,242 lekë dhe rritjes së zërit Inventari ekonomik për shumën 111,046 lekë.

Aktivët Qarkulluese janë rritur për shumën 27,597,396 lekë, kjo si rezultat i pakësimit të gjendjes së Inventarit (materiale) për shumën 962,335 lekë dhe i rritjes së Kërkesave për Arkëtim nga Debitorët për shumën 12,087,412 lekë (Klientë e Llogari të ngjashme ulur për shumën 22,300,820 lekë, Personeli, deficite e gjoba rritur për shumë 19,071,332 lekë, Të drejta e Taksa rritur për shumën 454,300 lekë dhe Debitorë të ndryshëm rritur për shumën 14,862,600 lekë) dhe i rritjes Llogarive Financiare (Llogari në Bankë dhe Disponibilitete në Thesar) për shumën 16,472,319 lekë.

Në Pasiv: Fondet e Veta (Fonde Bazë) janë rritur për shumën 13,797,696 lekë.

Detyrimet (Detyrime afatshkurtër, Detyrime për Tatim e Taksa) janë ulur për shumën 4,417,800 lekë.

Rezultatet e Ushtrimit janë rritur për shumën 12,455,512 lekë.

Për vitin 2015:

Në total Aktivit dhe Pasiv i Bilancit për vitin 2015 krahasuar me vitin 2014 është ulur për shumën 20,827,099 lekë.

Në Aktiv: Aktivitet e Qëndrueshme janë ulur për shumën 2,038,474 lekë nga të cilat Aktivitet e Qëndrueshme të Trupëzuara janë ulur për shumën 5,746,751 lekë.

Aktivitet Qarkulluese janë ulur për shumën 18,788,625 lekë.

Në Pasiv: Fondet e Veta (Fonde Bazë) janë ulur për shumën 210,477,224 lekë.

Detyrimet (Detyrime afatshkurtër Detyrime për Tatim e Taksa) janë rritur për shumën 329,471,683 lekë.

Rezultatet e Ushtrimit janë ulur për shumën 139,821,558 lekë.

Për vitin 2016:

Në total Aktivit dhe Pasiv i Bilancit për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 është rritur për shumën 68,499,512 lekë.

Në Aktiv: Aktivitet e Qëndrueshme janë rritur për shumën 37,489,807 lekë nga të cilat Aktivitet e Qëndrueshme të Trupëzuara janë rritur për shumën 34,979,376 lekë.

Aktivitet Qarkulluese janë rritur për shumën 31,009,705 lekë.

Në Pasiv: Fondet e Veta janë ulur për shumën 18,250,627 lekë.

Detyrimet (Detyrime afatshkurtër, Detyrime për Tatim e Taksa) janë rritur për shumën 2,705,381 lekë.

Rezultatet e Ushtrimit janë rritur për shumën 84,044,758 lekë.

Nga auditimi me zgjedhje i Pasqyrave Financiare dhe të dhënave të paraqitura në anekset dhe dokumentacionin shtesë bashkangjitur rezulton:

1. Nuk është mbartur saktë në fillim të periudhës për vitin ushtrimor gjendja e disa llogarive në fund të periudhës të vitit paraardhës, konkretisht për vitin 2015:

Totali i Bilancit të mbyllur (Aktivitet dhe Pasiv) me datën 31.12.2014 është për shumën 426,550,701 lekë, ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është mbartur si gjendje fillimi (Ushtrimi Paraardhës) për shumën 364,813,479 lekë pra me diferencë më pak për shumën 61,737,222 lekë.

Në Aktivin e Bilancit nuk janë mbartur saktë grupet, klasat dhe llogaritë:

* Aktive të Qëndrueshme: Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 21,936,038 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës shuma 20,465 939 lekë me diferencë më pak për shumën 1,470,099 lekë. Diferenca e mësipërme ka ardhur si rezultat i mbartjes më pak në Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara llogaria 232 Shpenzime në Proces për Transferime Kapitale për shumën 1,470,099 lekë.

* Aktive Qarkulluese: Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 404,614,663 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 344,347,540 lekë me diferencë më pak për shumën 60,267,123 lekë.

Diferenca e mësipërme ka ardhur si rezultat i mbartjes me ndryshime të llogarive përbërëse të Klasës 4 Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët, konkretisht:

- Llogaria 411-418 “Klientë e Llogarit të Ngjashme” Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 97,231,993 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 302,342,284 lekë me diferencë më shumë për shumën 205,110,291 lekë.

- Llogaria 423-429 "Personeli, Paradhënie, Deficite e Gjopa" Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 196,361,332 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 0 lekë me diferencë më pak për shumën 196,361,332 lekë.

- Llogaria 431 "Të Drejta e Taksa për tu Derdhur në Shtet" Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 8,744,159 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 0 lekë me diferencë më pak për shumën 8,744,159 lekë.

- Llogaria 435 "Sigurime Shoqërore" Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 0 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 70,671 lekë me diferencë më shumë për shumën 70,671 lekë.

- Llogaria 436 "Sigurime Shëndetësore" Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 0 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 3,532 lekë me diferencë më shumë për shumën 3,532 lekë.

- Llogaria 437,438 "Organizma të tjera Shoqërore" Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 0 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 123,686 lekë me diferencë më shumë për shumën 123,686 lekë.

- Llogaria 468 "Debitorë të Ndryshëm" Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 60,469,812 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 0 lekë me diferencë më pak për shumën 60,469,812 lekë.

Në Pasivin e Bilancit nuk janë mbartur saktë grupet, klasat dhe llogaritë:

* Fondet e Veta: Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 408,186,870 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës shuma 212,924,734 lekë me diferencë më pak për shumën 195,262,136 lekë. Diferenca e mësipërme ka ardhur si rezultat i mbartjes më pak në llogarinë 101 "Fondet Bazë".

* Detyrime: Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 1,792,900 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 167,103,832 lekë me diferencë më shumë për shumën 165,310,932 lekë.

Diferenca e mësipërme ka ardhur si rezultat i mbartjes me ndryshime të llogarive përbërëse të Klasës 4 Detyrime Afatshkurtër, konkretisht:

- Llogaria 431 "Detyrime ndaj Shtetit për Tatim-Taksa" Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 1,792,900 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 0 me diferencë më pak për shumën 1,792,900 lekë.

- Llogaria 4341 "Të tjera Operacione me Shtetin (kreditor)" Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 0 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën 167,103,832 lekë me diferencë më shumë për shumën 167,103,832 lekë.

* Rezultati i Ushtrimit (Saldo Kreditore): Bilanci i vitit 2014 është mbyllur për shumën 16,570,931 lekë ndërsa në Bilancin e vitit 2015 është paraqitur nga Viti Paraardhës për shumën - 15,215,087 lekë me diferencë më pak për shumën 31,786,018 lekë.

Si rezultat i veprimeve të mësipërme megjithëse Bilanci vjetor dhe Rezultati i vitit 2014 është miratuar nga AMA me Vendimin nr. 23, datë 01.04.2015 dhe nuk ka vendim tjetër për ndryshimin e treguesve të miratuar Ai është ndryshuar gjatë mbartjes në Bilancin e vitit 2015 dhe për pasojë Bilanci i Vitit 2015 ka pësuar ndryshime e transformime në Aktiv, në grupe, klasa e llogari si: Aktive të Qëndrueshme llogaria 232 Shpenzime në Proces për Transferime Kapitale, Aktive Qarkulluese Llogaria 411-418 "Klientë e Llogari të Ngjashme", Llogaria 423-429 "Personeli, Paradhënie, Deficite e Gjopa", Llogaria 431 "Të Drejta e Taksa për tu Derdhur në Shtet", Llogaria 435 "Sigurime Shoqërore", Llogaria 436 "Sigurime Shëndetësore", Llogaria 437,438 "Organizma të tjera Shoqërore", Llogaria 468 "Debitorë të Ndryshëm" dhe në Pasiv si:

Fondet e Veta llogaria 101”Fondet Bazë “ .Detyrime Llogaria 431 “ Detyrime ndaj Shtetit për Tatim-Taksa ”, Llogaria 4341 “ Të tjera Operacione me Shtetin (kreditor)” dhe në Rezultatin Ushtrimor .

2. Nuk janë mbartur si Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët (Llogaria 411 Klientë) detyrimet e lindura e të papaguara për licenca për subjekte të cilave nga AMA ju është hequr Licensa, konkretisht për vitin 2015:

Gjatë vitit 2015 nga AMA disa subjekteve për arsye të ndryshme ju janë konsideruar të pavlefshme licencat. Deri në momentin e heqjes së licencave këta subjekte kanë rezultuar me detyrime financiare të papaguara, detyrime të lindura gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencave por këta detyrime nuk janë mbartur si Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët në Llogarinë 411“Klientë” konkretisht:

- Subjekti “TV Vora S3” hequr licenca me Vendimin Nr. 47, datë 11.06.2015 me detyrime për shumën 400,000 lekë.

- Subjekti “Egnatia-Radio TV Kabëll” hequr licenca me Vendimin Nr. 48, datë 11.06.2015 me detyrime për shumën 4,055,000 lekë.

- Subjekti “TV Oreda” hequr licenca me Vendimin Nr. 50, datë 11.06.2015 me detyrime për shumën 850,000 lekë.

- Subjekti “Epiri” hequr licenca me Vendimin Nr. 51, datë 11.06.2015 me detyrime për shumën 3,050,000 lekë.

- Subjekti “Info Kabëll “ hequr licenca me Vendimin Nr. 52, datë 11.06.2015 me detyrime për shumën 2,050,000 lekë.

Nga sa më sipër rezulton që megjithëse Vendimet e AMA-s janë marrë për pavlefshmërinë e licencave të subjekteve e jo për zhvlerësim apo heqje detyrimesh financiare detyrimet e këtyre subjekteve për shumën 10,405,000 lekë nuk janë mbartur e paraqitur si detyrime për të cilat të merreshin dhe masat ligjore për arkëtimin e tyre.

Për veprimet e mësipërme nuk u paraqitën dokumentacion justifikues, argumente e sqarime të detajuara për secilin ndryshim dhe as veprimet kontabile të kryera për këta ndryshime.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet neni 6 ku përcaktohet:

- Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre....

- Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes.

dhe neni 10 ku përcaktohet:

1. *Pasqyrat financiare sigurojnë transparencën përmes të dhënave të plota dhe paraqesin, me vërtetësi, të dhënat e nevojshme për vendimmarrje. Ato përgatiten bazuar në një kontabilitet ushtrimor dhe në vijueshmërinë e veprimitarisë së njësisë ekonomike, për një të ardhme të parashikueshme.*

3. *Të dhënat për elementet dhe për shumat që ndikojnë në vendimmarrjet ekonomike të përdoruesve paraqiten veçmas në pasqyrat financiare.....*

- 5 *Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet trajtohen në përputhje me metodat kontabël, të cilat sigurojnë plotësinë, paanësinë, kujdesin dhe paraqitjen me vërtetësi të pasqyrave financiare.*

Si dhe në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik ” kapitulli Dokumentimi i Lëvizjes së Aktiveve pika 34 ku përcaktohet:

Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kudoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi; pika 35 ku përcaktohet : Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim ...dhe pika 36 ku përcaktohet : Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.

3. Gjatë vitit 2016 janë ulur si Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët një numër i konsiderueshëm subjektesh për shumën 37,766,545 lekë.

Gjatë vitit 2016 nga AMA për arsye të ndryshme me vendime të veçanta ju janë hequr licencat apo autorizimet 22 subjekteve. Këta subjekte kanë rezultuar me detyrime të konsiderueshme të pashlyera për shumën 37,766,545 lekë. Detyrimet e lindura e të pashlyera vetëm për vitin 2016 për këta subjekte janë për shumën 21,817,710 lekë. Peshën kryesore të totalit (rreth 50 %) të këtyre detyrimeve e zë subjekti “Tring IPTV për detyrime për autorizimin e dhënë për vitin 2016.

Për shumën 37,766,545 lekë janë rënduar shpenzimet e vitit 2016 dhe kjo shumë është evidentuar në Aktivin e Bilancit me minus tek llogaria 49 “Shuma të parashikuara për zhvlerësim” duke ulur në këtë mënyrë për këtë shumë edhe Klasën 4 “Kërkesa Arkëtimi për Debitorët”.

Për veprimet e mësipërme nuk u paraqitën dokumentacion justifikues, argumente ligjore e shënime shpjeguese të detajuara për secilin subjekt por vetëm pretendime se detyrimet e këtyre subjekteve janë të pamundura për tu arkëtuar .

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare për institucionet qendrore organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhim/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007, ku përcaktohet : Në rreshtat respektive (37,53,63) të rubrikave përkatëse të aktivit të bilancit paraqiten tepricat me shenjë (-) të llogarive 39, 49, 59 , që i korrespondojnë shumave të parashikuara për zhvlerësim....Në rast se janë evidentuar vlera të tilla kërkohet argumentimi në shënimet shpjeguese.

4. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 468, datë 03.06.2015 ka kaluar në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive objekti me emërtimin Atelier për Dekorin e Radio Televizionit në zonën kadastrave 8160 me numër pasurie 2/94 me sipërfaqe totale 10177 m² me sipërfaqe ndërtese 6202 m².

Nga ana e AMA-s janë kryer riparime dhe janë përfshirë në Aktivet e Qëndrueshme të Trupëzuara të vitit 2016 vetëm vlera e situacioneve të likuiduara për shumën 34,899,242 lekë dhe nuk është përfshirë vlera tjetër e objektit.

Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 5, datë 11.07.2017.

Në shpjegimet e dërguara nga AMA mbi Projektraportin e Auditimit, për konstatimin se nuk është mbartur saktë në fillim të periudhës për vitin 2015, gjendja e disa llogarive në mbyllje të vitit ushtrimor 2014 pretendohet se nga ana e sekretarit të përgjithshëm nga auditimi paraprak i pasqyrave financiare të AMA-s u konstatuan disa parregullsi dhe mungesë transparence në mbajtjen e llogarive kontabile të cilat ishin reflektuar në mbylljen e pasqyrave financiare deri në vitin 2014.

Nga ana e AMA-s në asnjë fazë të auditimit të KLSH-së *nuk është paraqitur* asnjë material apo dokument zyrtar ku të argumentohet se nga ana e sekretarit të përgjithshëm është kryer auditim i pasqyrave financiare të AMA-s me konstatimet për parregullsitë dhe mungesën e transparencës në mbajtjen e llogarive kontabile në mbylljen e pasqyrave financiare deri në vitin 2014, me përgjegjësitë e masat e rekomanduara e të marra që të shërbenin si bazë për kryerjen e veprimeve kontabile e sistemimin e llogarive përkatëse në kontabilitet e në pasqyrat financiare.

Mangësitë dhe të metat e paraqitura janë në kundërshtim me:

Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet neni 6 ku përcaktohet:

1. *Regjistrimet kontabël justifikohen me evidencë mbështetëse, në formë dokumentare ose informatike, që sigurojnë besueshmërinë e tyre....*
2. *Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ekonomik ose e ngjarjes.*

Me Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik” kapitulli Dokumentimi i Lëvizjes së Aktiveve pika 34 ku përcaktohet : *Veprimet ekonomike që kryhen në njësitë publike si dhe faktet që kanë sjellë ose mund të sillnin ndryshime në pasurinë që ato kanë në administrim e ruajtje, pasqyrohen kurdoherë në dokumentet përkatëse dhe menjëherë pasi kryhet veprimi*; pika 35 ku përcaktohet : *Regjistrimi i veprimeve ekonomike në librat e kontabilitetit bazohet në dokumente origjinale që përdoren për këtë qëllim ...dhe pika 36 ku përcaktohet : Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktuesin e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin dhe të tjera të dhëna të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative.*

Për sa më sipër observacionet e paraqitura nga ana e subjektit AMA nuk merren në konsideratë nga ana e grupit të audituesve.

Auditimi i zërit të llogarisë paga, shpërblime e të tjera personeli (llog. 600) dhe Sigurime Shogërore (llog. 601).

AMA përbëhet nga Kryetari, Zëvendëskryetari dhe 5 anëtarë. Anëtarët e AMA-s zgjidhen nga Kuvendi për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë. Autoriteti i Mediave Audiovizive, për vitin 2014 ka funksionuar mbi bazën e strukturave organike të miratuara, për vitin 2014 është zbatuar Vendimi i Kuvendit nr. 184, dt. 19.05.2008. Për vitin 2015 është zbatuar Vendimi i Kuvendit nr. 184, dt. 19.05.2008 dhe VKM 537, dt. 06.08.2014 dhe VK 35/2015.

Për vitin 2016 është zbatuar Vendimi i Kuvendit nr. 184, dt. 19.05.2008 dhe gjate vitit 2016 me miratimin e strukturës së re nga Kuvendi me VK nr. 19/2016, është bërë ristrukturimi i gjithë stafit të AMA-s.

Grupi i auditimit kërkoi të verifikojë dokumentet e dosjes së Kryetarit të AMA për vlerësimin e përputhshmërisë me kriteret e përcaktuara në ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Për këtë arsye u kërkua vënia në dispozicion e dosjes nga ana e sektorit të burimeve njerëzore. Nga sektori përkatës, grupit të auditimit iu paraqit vetëm vendimi i zgjedhjes së Kryetarit të AMA nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe një CV e cila ndodhej edhe në faqen e Web të institucionit.

Grupi i auditimit konstaton se nuk ekziston dosja me dokumentacionin përkatës të Kryetarit të AMA si dhe nuk ka dokument të deklarimit të konfliktit të interesave në momentin e marrjes së

detyrës nga ana e tij. Grupi i auditimit u vu në pamundësi të vlerësimit të përputhshmërisë me ligjin të zgjedhjes së Kryetarit të AMA.

Nga verifikimi i numrit të punonjësve rezultoi se, institucioni për periudhën objekt auditimi, ka respektuar strukturën dhe numrin e punonjësve sipas organikës dhe se të gjithë punonjësit janë pjesë e kësaj strukture. Struktura dhe organika e institucionit ka të përcaktuar emërtimin e pozicioneve të punës, kategorinë dhe numrin e punonjësve gjithsej. Numri i punonjësve të miratuar sipas strukturës organike për vitet objekt auditimi, krahasuar me faktin për aparatin e AMA paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Viti 2014			Viti 2015			Viti 2016		
		Plan	Fakt	Ndryshimi	Plan	Fakt	Ndryshimi	Plan	Fakt	Ndryshimi
I.	Punonjës gjithsej	48	48	-	50	50	-	58	58	-
1	Drejtues	16	16	-	19	19	-	26	26	-
2	Specialistë	22	22	-	22	22	-	25	25	-
3	Teknikë	4	4	-	3	3	-	2	2	-
4	Nëpunës të thjeshtë	2	2	-	2	2	-	1	1	-
5	Punëtorë	4	4	-	4	4	-	4	4	-
II.	Punëtorë të përkohshëm				1	1	-	1	1	-

Rezulton se, institucioni ka punuar me organikë të plotë dhe nga auditimi i liste pagesave rezultoi se në nuk është tejkaluar numri i parashikuar në organikë. Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe fondit të veçantë, për vitin 2014, 2015 dhe 2016, paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Artikulli	2014		2015		2016	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Pagat (600)	49,000,000	43,852,801	60,500,000	42,927,647	63,300,712	53,609,669
2	Sigurime Shoqërore (601)	7,200,000	6,866,144	7,800,000	6,574,515	9,468,000	8,406,226
3	Fondi i veçantë dhe Zëri shpërblime	3,500,000	2,370,337	7,200,000	4,992,444	7,214,320	5,346,328
4	Shpërblim për punë të mirë	0	240,380	0	437,420	0	154,650
5	Shp. në fund vitit	0	1,810,457	0	4,124,574	0	4,814,683
6	Ndihmë ekonomike	0	0	0	100,000	0	80,000
7	Shpërblim për dalje pension	0	112,700	0	190,700	0	179,035
8	Aktiv. social-kulturor	0	206,800	0	139,750	0	117,960

Nga përlogaritja, për vitin 2014, fondi i pagave është realizuar në masën 89,5%, ndërsa, sigurimet shoqërore janë realizuar në masën 95%. Për vitin 2015, fondi i pagave është realizuar në masën 71% ndërsa sigurimet shoqërore realizuar në 84%. Për vitin 2016, fondi i pagave është realizuar në masën 85% dhe sigurimet shoqërore realizuar në masën 88%.

Me përzgjedhjen rastësore të listë pagesave u konstatua se llogaritjet për pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe tatimi mbi të ardhurat personale janë kryer në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e tyre. Llogaritjet janë bërë për çdo punonjës, kontributi i sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimi mbi të ardhurat personale është ndalur rregullisht çdo muaj.

Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave dhe analizës së veprimeve të llogarisë “paga shpërblime”, u konstatua:

Për vitin 2014, me Urdhrin Nr. 628, prot., datë 16.12.2014, në mbështetje të Vendimit të AMA nr. 17, datë 28.10.2013, “Për miratimin e projektbuxhetit të vitit 2014”, është urdhëruar përdorimi i fondit të veçante për vitin 2014, në masën **3,000,000 lekë**.

Për vitin 2015, me shkresën Nr. 1017 prot., datë 17.12.2015 nga Sekretari i Përgjithshëm është urdhëruar shpërblimi i punonjësve, mbështetur në Vendimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive nr. 15, datë 17.12.2014, “Për miratimin e projektbuxhetit të vitit 2015. Masa e shpërblimit ka qenë **4,124,574 lekë**.

Për vitin 2016, me shkresën nr. 1102 prot., datë 19.12.2016, dhe bazuar në vendimin e AMA nr. 101, datë 09.12.2015, “Mbi miratimin e projektbuxhetit 2016”, është vendosur masa e shpërblimit prej **4,814,683 lekë**.

Shpërblimi për të tre vitet është i pa bazuar në ligj; projektbuxheti nuk është dokument justifikues. Është evidente se Projektbuxhetet për vitet e përmendura rezultojnë të jenë hartuar duke mos konsideruar rezultatet e pasqyrave financiare dhe gjendjen ekonomike të institucionit për vitin paraardhës.

Më konkretisht:

Për vitin 2014; në mbështetje të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”, me shkresën me nr. 540 prot., datë 30.03.2015, AMA ka depozituar në Ministri të Financave pasqyrat financiare për vitin kalendarik 2014 **me rezultatin ekonomik (15,215,087) lekë**.

Për vitin 2015; me shkresën me nr. 1020 prot., datë 31.03.2016, AMA ka depozituar në Ministri të Financave pasqyrat financiare për vitin kalendarik 2015 **me rezultatin ekonomik (123,250,627) lekë**.

Për vitin 2016; me shkresën me nr. 1300 prot., datë 31.03.2017, janë depozituar në Ministri të Financave pasqyrat financiare për vitin kalendarik 2016 **me rezultatin ekonomik (39,205,869) lekë**.

Në këto kushte shpërblimet e dhëna për rezultate në punë në shumën totale prej **11,939,257 lekë**, nuk janë të justifikuara ligjërisht dhe as në termat e menaxhimit të shëndoshë financiar; sipas bilanceve për vitet 2014, 2015, 2016 institucioni rezulton me rezultate ekonomike financiar negativ. Referuar Nenit 17, të Ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” dhe Nenit 9 të Ligjit Nr. 10 296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, përgjegjshmëria menaxheriale është detyrimi i menaxherëve të njësive, në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë.

Përgjegjshmëria përfshin çështjet që lidhen me ndarjen e detyrave zhvillimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të gjitha transaksionet financiare, bashkërendimin me shërbimet

qendrore të harmonizimit si dhe me vlerësimin dhe raportimin për sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Përgjegjshmëria menaxheriale përfshin gjithashtu përgjegjësinë për veprimet e kryera.

Nëpunësi autorizues duhet të sigurohet për zbatimin korrekt të çdo Ligji apo VKM-je në fuqi dhe të jetë i ndërgjegjshëm se zbatimi i tyre është detyrim ligjor dhe jo preferencë individuale.

Pavarësia e institucionit të AMA, nuk nënkupton funksionimin në injorim të kuadrit ligjor.

Auditimi i zërit të llogarisë mallra dhe shërbime (llog. 602).

Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për administrimin, ruajtjen, dokumentimin e vlerave materiale e monetare. Kryerjen e inventarizimeve:

Në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe ligjit Nr. 10296, datë 8.7.2010 për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, AMA ka zbatuar dispozitat ligjore lidhur me administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimi i vlerave monetare dhe materiale. Hyrjet dhe daljet e inventarit dhe mallrave e materialeve janë bërë me dokumente të rregullta Fletë Hyrje e Fletë Dalje. Inventari dhe pajisjet në përdorim të punonjësve është regjistruar në kartelat personale të secilit punonjës përgjegjës dhe lëvizjet dokumentohen me dokumentacion të rregullt.

Me procesverbale e akt dorëzime është bërë lëvizja e pajisjeve të ndryshme nga magazina tek punonjësit e anasjelltas si dhe ndryshimi i punonjësve me përgjegjësi materiale.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, për periudhën vitet 2014-2016, në zbatim të pikës 81, kreu IV, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, çdo vit ka ngritur grupet e punës, sipas urdhrave të brendshëm të titullarëve të AMA-s e konkretisht :

- Për Vitin 2014 u paraqitën: Urdhër nr. 193 datë 27.11.2014 për ngritjen e komisionit për “ Inventarizim dhe dorëzimin e vlerave material të magazinës së AMA-s, Relacion datë 27.11.2014 “Mbi inventarizimin dhe dorëzimin e vlerave materiale të magazinës së AMA-s, Urdhër nr. 211 datë 16.12.2014 për ngritjen e grupit të punës për “ Inventarizim e vlerave materiale për vitin 2014 ” ,Relacion nr. 21 Prot. datë 12.01.2015 “Mbi kryerjen e inventarizimit të vlerave material dhe monetare, për vitin 2014”, Në relacionet përkatëse është përshkruar rezultati i inventarizimeve në magazinë dhe sipas personave përgjegjës. Janë mbajtur shënimet përkatëse për pajisjet që nuk funksionojnë.

- Për Vitin 2015 u paraqitën: Shkresë nr. 21/1 Prot. datë 12.03.2015 “Mbi vlerësimin e aktiveve në Institucion” ku është paraqitur lista e materialeve për t’u verifikuar nga komisioni i vlerësimit, Urdhër nr. 73 datë 16.03.2015 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të Institucionit”, Proces Verbal nr. 217 Prot. datë 03.04.2015 i Komisionit të Vlerësimit të Aktiveve të Institucionit. Bashkangjitur këtij proces verbal janë proces verbalet ku paraqiten defektet përkatëse të çdo pajisje të mbajtura midis Komisionit dhe Personit Përgjegjës të mbajtura në ngarkim. Shkresë nr. 217/1 Prot. datë 07.04.2015 “Mbi asgjësimin e aktiveve të vlerësuara si jashtë funksionimi të Institucionit të AMA-s”, Urdhër nr. 103 datë 09.04.2015 “Për ngritjen e komisionit për nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi në Autoritetin e Mediave Audiovizive”, Proces verbal nr. 217/2 datë 24.04.2015 i Komisionit të nxjerrjen e aktiveve nga përdorimi, pjesë e së cilës është edhe një kontratë lidhur midis Shtëpisë së Ofertave dhe AMA, Shkresë nr. 322 Prot. datë 05.05.2015 me lëndë “Dërgohet lista e aktiveve të nxjerra nga përdorimi në njësi”, Urdhër nr. 1042 datë 29.12.2015 për ngritjen e grupit të punës për “Kryerjen e inventarizimit fizik të

aktiveve të Institucionit për vitin 2015”, Relacion nr. 1042/1 Prot. datë 29.01.2016 “Mbi kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale dhe monetare, për vitin 2015”, Shkresë nr. 652 prot. datë 15.07.2016 me lëndë “Relacion mbi vlerësimin e aktiveve të Institucionit të AMA-s, për listën e materialeve me vlerë të mbetur 0 lekë.

- Për vitin 2016 u paraqitën: Urdhër nr. 108 datë 15.07.2016 për “Ngritjen e komisionit të vlerësimit të aktiveve të Institucionit”, Proces verbal nr. 652/2 Prot. datë 17.10.2016 për vlerësimin e aktiveve, ku bashkangjitur ndodhen proces verbalet e defekteve të konstatuara për çdo artikull, Shkresë nr. 652/3 Prot. datë 17.10.2016 dhe 652/4 prot., datë 21.10.2016 me lëndë “Relacion mbi vlerësimin e Aktiveve të AMA-s nga Komisioni i Vlerësimit, Urdhër për ngritjen e grupit të punës me nr. 652/5 Prot. datë 01.11.2016, Proces verbal nr. 652/6 prot., datë 11.11.2016 “Për nxjerrjen e aktiveve të AMA-s jashtë përdorimit dhe tjetërsimi i tyre”, Formularët e Deklarimit ku rezulton që anëtarët e Komisionit nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit, Urdhër nr. 34, datë 11.01.2017, për ngritjen e grupit të punës për “Kryerjen e inventarizimit fizik të aktiveve të Institucionit për vitin 2016”, Relacion nr. 34/1 Prot. datë 29.01.2017 “Mbi kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale dhe monetare, për vitin 2016”.

Nga grupi I auditimit u audituan dhe *mbi konsumimin e karburantit të automjeteve të institucionit*. Përdorim të AMA-s për vitin 2015-2016, nga ku rezultoi se ky institucion ka patur në inventar, 4 automjete :

1. Skoda Yeti me targë AA 503 BO
2. Skoda Yeti me targë AA 496 BO
3. Toyota Land Cruiser me targë TR 2910 I
4. Hyundai me targë AA 089 NO

Nga grupi i auditimit, u vërejt se:

Për vitin 2014 dhe 2015 deri në shtator të vitit 2015, për disiplinimin e shpenzimeve të transportit, *nuk ka Urdhër të Brendshëm për ngritjen e komisionit për administrimin dhe përdorimin e karburantit për kronometrimin e km dhe normën e harxhimit karburantit për km 100 km e përshkruar.*

Në Korrik i vitit 2016, Drejtoresha e Shërbimeve të Brendshme, shkresën nr. 617, datë 04.07.2016, drejtuar Sekretares së Përgjithshme znj. Alba Qirjazi, është kërkuar që “Me qëllim menaxhimin e konsumit të karburantit për makinat në dispozicion të AMAS “të merën masat për llogaritjen e sasisë së karburantit që makinat konsumojnë për një distancë prej 100 km”.

Nga Sekretarja e Përgjithshme kishte dalë Urdhri nr. 618, datë 04.07.2016 për ngritjen e grupit të punës për llogaritjen e harxhimit të karburantit për çdo automjet për 100 km të përshkruar.

Nga grupi i punës me shkresën nr. 618 datë 14.07.2016 ishte përcaktuar norma e harxhimit për 4 automjetet në dispozicion AMA-së, i cili ka të përcaktuar për të katër automjetet normativat e shpenzimit për 100 km sipas Itinerareve 1(Tiranë – Fier) dhe Itinerarit 2 (Rrogozhinë Çorovodë) përkatësisht;

1. Skoda Yeti me targë AA 503 BO Itinerari 1 për 100 km 13.4 l
2. Skoda Yeti me targë AA 496 BO Itinerari 1 për 100 km 13.5 l
3. Toyota Land Cruiser me targë TR 2910 I Itinerari 1 për 100 km 15.5 l
4. Toyota Land Cruiser me targë TR 2910 I Itinerari 2 për 100 km 18.5 l
5. Hyundai me targë AA 089 NO Itinerari 1 për 100 km 10.5 l

Sipas informacionit, nga Drejtoresha aktuale e Shërbimeve të Brendshme, AMA, ka përcaktuar mënyrën për lëvizjet dhe shërbimet që duhet të kryej çdo automjet dhe nga 4 automjetet, 3 automjete janë caktuar të lëvizin për inspektime dhe 1 automjet në shërbim të administratës (Hyundai me targë AA089O).

Siç shihet komisioni, ka kronometruar vetëm për km e përshkruara për lëvizjet interurbane dhe jo dhe për ato urbane dhe kjo ka bërë që të gjitha fletë udhëtimet për çdo automjet, për lëvizje urbane, të plotësoheshin duke llogaritur harxhimin e karburantit me sasinë për lëvizjet interurbane, gjë e cila ka sjell një llogaritje fiktive dhe jo korrekte.

Në dispozicion të AMA-se, për nevoja pune, është marrë me qira automjeti HYUNDAI me targë AA084 ML për një periudhë 4 mujore.

Nga auditimi i ushtruar për këtë periudhën 2014 ,2015, u vërejt se në të gjitha rastet Fletë udhëtimet nuk ishin plotësuar në mënyrë korrekte, pasi ato, si për udhëtimet brenda qytetit dhe ato jashtë, plotësoheshin vetëm me firmën e shoferit, pa u vërtetuar me firmën e personit për të cilin është kryer shërbimi si dhe pa përcaktuar km e përshkruara, por mjaftohej duke përcaktuar vetëm vend nisjen dhe vend mbërritjen ,veprim ky që le shteg për mos eficientë në kontrollin e harxhimit të karburantit.

Daljet e karburantit nga magazina për këtë periudhë, bëheshin sipas rastit dhe nevojës për shërbim për çdo përdorues mjeti, duke pasur bashkëlidhur “kërkesën e dërgimit me shërbim” të firmosura nga eprori direkt dhe “Urdhër dorëzimit” të firmosur nga Përgjegjësj e Administratës.

- Në disa raste daljet e karburantit nga magazina, ishin të firmosura nga drejtuesit e mjetit por nuk përputhen në datë me dokumentin “kërkesë për shërbim” dhe “urdhër dorëzimit”.

- Në shumë lëvizje të kryera me automjetet, nuk janë evidentuar me saktësi distancat e përshkruara për lëvizjet e kryera brenda Qytetit nga ana e drejtuesve të mjetit.

Duke parë këto mangësi u kërkuar akt rakordimet e mbajtura ndërmjet magazinës dhe financës, ku u vërejt se për asnjë rast nuk kishte një akt akordim të mbajtur.

- Gjithashtu për çdo mjet, nuk kishte kartela të veçanta për harxhimin e karburantit të cilat të korrespondojnë me sasinë e karburantit të bërë dalje nga magazina.

Për sa më lart u bë verifikimi midis fletë daljeve nga Magazinës dhe Fletë udhëtimet për periudhën 2015 ,2016 për çdo muaj dhe u konstatua se kishte diferenca të cilat jepen në tabelën e më poshtme:

Për vitin 2015

Muajt	AA 496 BO		AA 503 BO		AA084 ML		AA 089 NO		TR 2910 I	
	Fd	F-udh	Fd	F-udh	Fd	F-udh	Fd	F-udh	Fd	F-udh
Janar	149	204	-	-	-	-	-	-	-	-
Shkurt	132	152	-	-	-	-	-	-	50	0
Mars	157	147	-	-	-	-	-	-	-	-
Prill	170	250	530	400	-	-	-	-	-	-
Maj	600	300	-	-	-	-	-	-	-	-
Qershor	400	200	-	-	-	-	-	-	-	-
Korrik	350	300	600	450	-	-	230	150	-	-
Gusht	420	310	190	300	-	-	-	-	-	-
Shtator	450	260	290	480	270	240	-	-	-	-
Tetor	300	200	-	-	240	200	-	-	300	510
Nëntor	-	-	-	-	260	220	-	-	90	0
Dhjetor	-	-	-	-	-	-	-	-	280	250
Gjithsej	3128	2323	1610	1630	770	660	230	150	720	760
Diferenca+/-	805 litra		+20 litra		110 litra		80 litra		40 litra	

Nga sa më lart shihet qartë se ka një mos rakordim midis sasive të mara me fletë dalje dhe atyre të harxhuara sipas fletë udhëtimit duke krijuar diferenca të pajustificuara dhe të papërdorura nga drejtuesit e automjeteve.

Dhe gjithsej për vitin 2015 sipas llojit të automjetit diferenca në +/-jepen në tabelë

<i>Lloji Automjetit</i>	<i>Magazina</i>	<i>F-udhëtimet</i>	<i>Diferenca+/-</i>	<i>Karburant</i>
AA 496 BO	3128	2323	805 litra	Benzine
AA 503 BO	1610	1630	20	Benzine
AA084 ML	770	660	110 litra	Nafte
AA 089 NO	230	150 litra	80 litra	Nafte
TR 2910 I	720	760	+40	Nafte
Gjithsej	6,458 litra	5,523 litra	935 litra	Karburant

Pra në muajt të cilët u konstatuan me diferenca në sasi midis fletë daljeve të firmosura nga shoferët dhe fletë udhëtimit rezulton se nga magazina për vitin 2015, **janë bërë dalje 6,458 litra dhe harxhuar sipas fletë udhëtimeve 5,523 pra me diferencë prej 935 litra karburant në vlerë 162,253 lekë nga të cilat (785 litra benzinë në vlerë 137,656 lekë nga të cilat (230 litra x 200.38 = 46,087 + 555 litra x 175.8 = 97,569 lekë) dhe 150 litra naftë në vlerë 24,597 lekë, nga të cilat (80 litra x 149.18 = 14,064 lekë + 70 litra x 150.47 leke = 10,533 lekë)**

Po kështu dhe për vitin 2016 nga ana e Financës nuk ishte mbajtur asnjë akt rakordim për dhe as kartela personale për automjet mbi sasitë e harxhuara dhe atyre të mara me fletë dalje nga magazina dhe nga verifikimi i fletë daljeve të magazinës dhe flete udhëtimeve të vëna në dispozicion konstatoi se kishte diferenca për muajt e mëposhtëm:

Për vitin 2016

<i>Muajt</i>	<i>AA 496 BO</i>		<i>AA 089 NO</i>		<i>TR 2910 I</i>	
	<i>Fd</i>	<i>F-ud-h</i>	<i>Fd</i>	<i>F-udh</i>	<i>Fd</i>	<i>F-udh</i>
Janar	-		-	-	-	-
Shkurt	270	200	-	-	-	-
Mars	-		-	-	-	-
Prill	260	120	-	-	100	0
Maj	310	290	-	-	-	-
Qershor	380	350	-	-	-	-
Korrik		-	230	150	280	260
Gjithsej	1220	960	230	150	380	260
Diferenca+/-	260		80		120	

Dhe gjithsej për vitin 2016 sipas llojit të automjetit diferenca në +/-jepen në tabelë.

<i>Lloji Automjetit</i>	<i>Magazina</i>	<i>F-udhëtimet</i>	<i>Diferenca+/-</i>	<i>Karburant</i>
AA 496 BO	1220	960	260	Benzinë
AA 089 NO	230	150	80	Naftë
TR 2910 I	380	260 litra	120 litra	Naftë
Gjithsej	1,830 litra	1,370 litra	460 litra	

Për sa i përket vitit 2016 në bazë të fletë udhëtimeve që na u vunë në dispozicion dhe fletë daljeve të magazinës për muajt që **ishin me diferenca janë harxhuar 1,370 litra karburant për makinat dhe duke i krahasuar me daljet që janë bërë dalje nga magazina për këta muaj një sasi prej 1,830 litra kemi një diferencë prej 460 litrash në vlerë 86,605 lekë (nga të cilat 260**

litra benzinë, ku $210\text{litra} \times 183,4 = 38,514 \text{ lekë} + 40\text{litra} \times 200,38 \text{ lekë} = 8,015\text{lekë} + 200 \text{ litra naftë} \times 200,38 = 40,076\text{lekë}$).

Për dy vitet 2015,2016 diferencat në karburant prej 1,395 litra nga të cilat 945 lira benzinë dhe 450 litra naftë me vlerë prej 248,858 lekë

Për shumën 248,858 lekë që del diferencë nga krahasimi i dokumentacionit të fletë udhëtimeve me daljet nga magazine për 1,395 litra mbajnë përgjegjësi personat e sipërcituar në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 të menaxhimit financiar dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, nuk kanë kryer akt rakordimet të cilat kanë çuar në mos përdorim të sasisë së karburantit nga personat përgjegjës sipas automjeteve që dispononin.

Për sa më sipër është mbajtur Proces verbalit nr. 3 datë, 14.07.2017.

Nisur nga observacioni i bërë nga AMA mbi justifikimin e karburantit në fletë dalje të magazinës në sasi më tepër prej 1,395 litra, na ato ë dala nga magazina, se nuk qëndron diferenca e mësipërme duke e justifikuar më fletë dalje të dhjetorit 2014si dhe me justifikimin e ngatërimit të fletë udhëtimeve të të njëjtit drejtues automjeti, nuk meren në konsideratë nga ana jonë mbasi si në dokumentacionin justifikues bashkëlidhur nga ana e AMA-s, fletë dalje të dhjetorit 2014 nuk justifikojnë diferencën pasi F. udhëtimet në të cilat kanë të evidentuar sasinë e karburantit e janë me datë 15.01.2015.

Nga auditimi u audituan gjithë sasia e daljeve nga magazina e justifikuar kjo me flete udhëtime të mbajtura nga drejtuesit për çdo automjet.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Për sa më lartë rekomandojmë

Për diferencën e krijuar nga mosrakordimi fletë dalje dhe fletë udhëtime prej 1.395 litra karburant(benzine dhe naftë) në vlerë 248,858 lekë të bëhet zhdëmtimi i saj

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet arkës dhe bankës.

Në auditimin për ligjshmërinë dhe saktësinë e veprimeve të kryera nëpërmjet arkës u konstatua:

- Nëpërmjet arkës gjatë gjithë periudhës së audituar janë kryer arkëtime nga subjekte të ndryshme në shuma të konsiderueshme (deri në qindra mijë lekë).
- Nëpërmjet arkës gjatë gjithë periudhës së audituar janë kryer pagesa të ndryshme në mënyrë të vazhdueshme si për likuidim të blerjeve të kryera me Procedurë Prokurimi me Vlera të Vogla, shërbime të ndryshme, shpenzime telefonike, shpenzime udhëtim e dieta, etj.
- Në arkë janë mbajtur shuma të konsiderueshme lekë (deri mbi 500,000 lekë) dhe kur sigurimi fizik i arkës nuk i plotëson kushtet e nevojshme.
- Nëpërmjet arkës vetëm nga arkëtarët janë blerë në change të ndryshme valutë në Euro shuma të konsiderueshme deri në mijëra Euro.

Veprimet e mësipërm përbën shkelje të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” Kapitulli Dokumentimi i vlerave monetare dhe letrave me vlerë, ku përcaktohet:

Pika 61: Pagesat ndërmjet njërive publike dhe entiteteve të sektorit privat bëhen nëpërmjet Sistemit të Thesarit direkt në llogarinë bankare të përfituesit. Njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë të detyruara të procedojnë me kryerjen e pagesës për mbylljen e detyrimeve menjëherë pas marrjes së faturës tatimore nga furnitori dhe të vërtetuar me kryerjen e shërbimit/marrjes në dorëzim të aktiveve në përputhje me kushtet e kontratës.

Pika 63: Veprimet me para në dorë kryhen vetëm brenda limitit ditor të arkës, të miratuar nga Nëpunësi i Parë Autorizues me propozim të Sistemit të Thesarit, me akte të veçanta sipas specifikave të njësive publike.

Pika 64: Veprimet me para në dorë kryhen për transaksionet financiare në formën e paradhënies për udhëtime e dieta, gjithashtu edhe për arkëtimin e të ardhurave në vlera më të vogla se 1000 lekë.

Pika 65: Tërheqja e limitit të arkës kryhet nëpërmjet Sistemit të Thesarit sipas procedurave të përcaktuara për këtë qëllim.

Nga ana e subjektit AMA, në observacionin e paraqitur lidhur me projekt raportin e auditimit mbi shkeljet e konstatuara nga ana e grupit të auditimit, shprehet se: “AMA është subjekt i pavarur dhe se për këtë institucione nuk ekzistojnë urdhra apo udhëzime të cila të rregullojnë veprimtarinë ligjore të kryer nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë” nuk merret në konsideratë nga grupi i auditimit pasi ligji për kontabilitetin, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrolli si dhe urdhrat e udhëzimet e dala në funksion të tyre janë të detyrueshme dhe iu nënshtrohen të gjitha institucionet e shteti shqiptar.

Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, shërbime etj. :

Pas përcaktimit të ardhurave të pritshme për tu arkëtuar nga Drejtoria Ekonomike janë njoftuar Drejtoritë e AMA-s për depozitim të kërkesave mbi nevojat për investime, aparatura, aktivitete, projekte, apo nevoja të tjera sipas profilit të sektorit dhe mbi këtë bazë janë parashikuar nevojat përkatëse.

Parashikimi i nevojave për mallra dhe shërbime llog 602, si nevojat për materiale zyre, kancelari, bojëra për printer dhe fotokopje, shpenzime për shërbime furnizuese, shërbime mirëmbajtje, është bërë nga sektori i financës dhe administratës duke shfrytëzuar shpenzimet historike të faktit për këto zëra të minimumit 3 vite.

Për hartimin e nevojave për shpenzime udhëtimi, të brendshme ose të jashtme, për dieta, bileta avioni apo karburant etj. janë marrë për bazë parashikimet lidhur me numrin e inspeksioneve që do kryhen dhe nevojat për përfaqësime jashtë vendit.

Shpenzimet e transportit, si karburant, vaj, pjesë ndërrimi etj., janë parashikuar sipas konsumit mesatar të rezultuar nga vitet e kaluara, si dhe bazuar në distancat e përcaktuara në Planin e Veprimit nga Drejtoria e Mbikëqyrjes.

Miratimi i planit të shpenzimeve për vitet 2014-2016, është kryer nëpërmjet vendimeve të AMA Për Vitin 2014 Projektbuxheti është miratuar me Vendimin nr. 17, datë 28.10.2013.

Për llogarinë 602 Mallra e Shërbime për vitin 2014 janë planifikuar shuma 51,500,000 lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar për shumën 18,588,438 ose në masën 36,1%. Sipas zërave kryesorë rezultojnë:

- Shpenzime për Udhëtim e Dieta janë planifikuar për shumën 8,000,000 lekë, janë realizuar për shumën 3,281,561 lekë, ose në masën 41 %
- Materiale e shërbime të tjera janë planifikuar për shumën 6,000,000 lekë, janë realizuar për shumën 708,070 lekë, ose në masën 12 %
- Shërbime nga të tretë janë planifikuar për shumën 6,000,000 lekë, janë realizuar për shumën 4,866,072 lekë, ose në masën 81 %
- Fushata për informimin e publikut është planifikuar për shumën 5,000,000 lekë nuk është realizuar fare.
- Kryerja e shërbimit on-line për monitorim frekuence është planifikuar për shumën 5,000,000 lekë nuk është realizuar fare.

Asnjë nga zërat e shpenzimeve nuk rezulton që të ketë kaluar shumat e planifikuara. Justifikimi për këtë është mungesa e kuorumit të nevojshëm për vendimmarrje që ka ndikuar në zërat e ndryshme të shpenzimeve.

Për Vitin 2015 Projektbuxheti është miratuar me Vendimin nr. me vendimin nr. 15, datë 17.12.2014 dhe me vendimin nr. 37, datë 11.05.2015, një ndryshim në zërat e projekt buxhetit të miratuar me vendimin 15, datë 17.12.2014.

Për llogarinë 602 Mallra e Shërbime për vitin 2015 janë planifikuar shuma 56,500,000 lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar për shumën 36,371,453 ose në masën 64,4%. Sipas zërave kryesorë rezulton:

- Shpenzime për Udhëtim e Dieta janë planifikuar për shumën 4,000,000 lekë, janë realizuar për shumën 4,393,747 lekë, ose në masën 110 % me një tejkalim prej 393,747 lekë. *Kjo justifikohet me shtimin e inspektimeve nga grupet e punës në AMA-s, në kuadër të luftës kundër piraterisë.*
- Shërbime nga të tretë janë planifikuar për shumën 6,000,000 lekë, janë realizuar për shumën 4,832,743 lekë, ose në masën 81 %
- Materiale e shërbime të tjera janë planifikuar për shumën 6,000,000 lekë, janë realizuar për shumën 5,332,782 lekë, ose në masën 89 %.
- Fushata për informimin e publikut është planifikuar për shumën 15,000,000 lekë , janë realizuar 5,936,800 lekë, ose në masën 40%.
- Krijimi i Call Center pranë AMA-s është planifikuar për shumën 4,000,000 lekë nuk është realizuar fare.

Për vitin 2016 Projektbuxheti është miratuar me Vendimin nr. 101, datë 09.12.2015.

Për llogarinë 602 Mallra e Shërbime për vitin 2015 janë planifikuar shuma 102,292,428 lekë. Ky zë shpenzimesh është realizuar për shumën 65,362,096 ose në masën 63,9%. Sipas zërave kryesorë rezulton:

- Shpenzime për Udhëtim e Dieta janë planifikuar për shumën 6,600,000 lekë, janë realizuar për shumën 4,654,295 lekë, ose në masën 71 %.
- Shërbime nga të tretë janë planifikuar për shumën 4,505,000 lekë, janë realizuar për shumën 3,539,240 lekë, ose në masën 79 %.
- Materiale e shërbime të tjera janë planifikuar për shumën 4,488,000 lekë, janë realizuar për shumën 1,811,028 lekë, ose në masën 40 %.
- Detyrime dhe kompensime legale (likuidimet e bëra për titujt ekzekutiv) janë planifikuar për shumën 42,853,678 lekë, janë realizuar për shumën 26,991,286 lekë, ose në masën 63 %.
- Fushata për informimin e publikut është planifikuar për shumën 9,300,000 lekë, janë realizuar 9,536,513lekë, ose në masën 103%.
- Shpenzime për studim tregu, trajnime etj. është planifikuar për shumën 17,350,000 lekë, janë realizuar 7,501,037 lekë, ose në masën 43%.
- Krijimi i Call Center pranë AMA-s është planifikuar për shumën 4,000,000 lekë janë realizuar për shumën 3,376,800 lekë.

Argumentimi dhe llogaritja e fondit limit

Argumentimi dhe përlllogaritja e fondit limit është kryer bazuar në nenin 59, pika “a” të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” duke marrë parasysh vlerat e buxhetuara për vitet 2014-2016, dhe kërkesave për mallra (sasitë) dhe shërbime të parashikuara ose ne disa raste është kryer testimi i tregut, duke përcaktuar në këtë mënyrë fondin limit pa dhe me TVSH.

Auditimi i zërit të llogarisë shpenzime për investime (llog. 230 dhe 231).

Prokurimi i fondeve publike

Prokurimi i fondeve publike për periudhën 01.11.2014 deri 31.12.2016 sipas procedurës jepet nga pasqyra në vijim:

N r	Lloji procedurës	V I T E T									
		2014				2015			2016		
		Nr	F L	fituar	Vend	nr	F L	fituar	nr	F L	fituar
1	Blerje të vogla	201	3,530,	3,328		272	24,051	10,480	165	19,818	8,907
				202				13,578			10,911
2	Negocim pa shpallje								1	9,187	9,187
	Shtesa 20 %								1	3,835	3,324
	Te tjera neni 33/b										511
3	KP					5	13,112	12,197	4	10,569	8,984
	Diferenca %							915			1,585
4	Hapur								1	49,999	47,259
											2,740
5	VKM nr 1195, datë 5.8.2008 ftese per negociate					1	10,583	10,500	1	85,291	85,291
6	Shërbim konsulence								1	2,666	2,550
											116
	Shuma 1 deri 6	201	3,530,	3,328		278	47,746	33,177	174	181,365	165,502
	Diferenca							14,569			15,863

Nga pasqyra konstatohet se sipas viteve efekti i garës është:

1. Për vitin 2014 në masën 202 mijë lekë më pak se sa fondi limit i planifikuar, ose 6 për qind ndaj shumës gjithsej.
2. Për vitin 2015 në masën 14,569 mijë lekë më pak se sa fondi limit i planifikuar, ose 31 për qind ndaj shumës gjithsej.
3. Për vitin 2016 në masën 15,863 mijë lekë më pak se sa fondi limit i planifikuar, ose 9 për qind ndaj shumës gjithsej.

Nga pasqyra konstatohet se efekti garës është kryesisht në procedurën e prokurimit “blerje me vlera të vogla”¹.

Për vitin 2015 “Blerjet me vlera të vogla” zënë një peshë të konsiderueshme prej 32 për qind të fondit të prokuruar gjithsej.

(Të dhënat janë marrë në format elektronik nga zj. Erisa Imerali me detyrë Drejtore e Shërbimeve të Brendshme. Për vitin 2014 nuk është hartuar regjistër i parashikimit dhe realizimit të prokurimit publik. Të dhënat janë nxjerrë nga dokumentacioni i arkës dhe bankës).

U auditua procedura e prokurimit:

- + “Shërbim konsulence” me fond limit 2,669 mijë lekë,
- “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” me fond limit 49,999 mijë lekë.

Lidhur me auditimin e procedurës së tenderit me objekt:

1. “Shërbim konsulence”.

Gjatë vitit 2016, AMA-s me Vendim të Këshillit të Ministrave i është kaluar në administrim “Godina e Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar”.

Për të bërë funksionale këtë godinë AMA-s i janë çelur fonde për:

- “Hartimi i projektpreventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” dhe në vazhdim

- “Rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”.

Disa të dhëna për tenderin me objekt “Hartimi i projektpreventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” janë:

Të dhëna për prokurimin	Komisioni i Vlerësimit Ofertave	Njësia e prokurimit
a	b	c
1. Urdhër prokurimi. nr. 36, dt. 4.3.2016 2. Fondi limit 2,666,190 lekë. 3. Procedura e prok. “Shërbim Konsulence” 4. Data e zhvillimit 23.3.2015 5. Kontraktuesi subjekti BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C” sh.p.k. Data e lidhjes kontratës 8.6.2016 Vlera e kontratës 3,060,000 lekë. Diferenca ndaj FL 116,190 lekë	Erjona Rusmali Rais Petrela Erjona Fishta	Fjoralba Murati Flutura Dashi Luçiano Bojaxhiu

“Hartimi i projektpreventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”, me numër reference 22631, i zhvilluar në vitin 2016, disa të dhëna për të cilin janë:

Mbështetur në sistemin elektronik të APP konstatohet se kanë paraqitur interes për të marrë pjesë në tender 4 operatorë ekonomikë (OE) nga të cilët dy janë skualifikuar si më poshtë:

“Atelier 4” sh.p.k. skualifikuar

“Sphaera” sh.p.k. skualifikuar

“AA & E Engineering” sh.p.k. me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, e cila në fund të procedurës së vlerësimit nga KVO është vlerësuar me 78,4 pikë.

“AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. me ofertë ekonomike 2,550,000 lekë, e cila në fund të procedurës së vlerësimit nga KVO është vlerësuar me 89,74 pikë

Nr	Operatorët ekonomikë	Njësia e matjes	Ofertat ekonomike		Kualifikuar/skualifikuar
			Pa TVSh	Me TVSh	
1	Atelier 4				skualifikuar
2	“Sphaera” sh.p.k.				skualifikuar
3	“AA & E Engineering” sh.p.k.	000 L	2,161		kualifikuar
4	“AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k.	”	2,550		kualifikuar

Kontrata midis palëve është lidhur datë 8.6.2016 me afat për “Hartimin e projektzbatimit ...” deri datë 28.6.2016 (datë 28.6.2016 duhet të jetë dorëzuar projektzbatimi I rikonstruksionit të godinës ...”).

1.1. Parregullsi e konstatuar:

KVO ka pranuar/kualifikuar BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. në kundërshtim me nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2016 “Për rregullat e prokurimit publik” në të cilin është përcaktuar se ...

1.1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

1.1.2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Në nenin 3 të kontratës së bashkëpunimit datë 10.2.2106 të noteruar lidhur midis palëve është përcaktuar shoqëria “AVE Consulting” sh.p.k. do të ketë 7 për qind të fitimit dhe të pjesëmarrjes, shoqëria “D & C partners” sh.p.k. do të ketë 30 për qind të fitimit dhe pjesëmarrjes. Nga sa më sipër konstatohet që në kontratën e bashkëpunimit palët (OE) nuk janë shprehur për pjesën e shërbimit, punës ... elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

1.2. Parregullsi e konstatuar:

OE “D & C Partners” sh.p.k. nuk ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për muajin janar, shkurt 2016, në kundërshtim me germen 2b të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në zbatim të VKM nr. 379, datë 11.6.2014 shtesa të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” I ndryshuar... në të cilin ndër të tjera është përcaktuar se ... *OE duhet të paraqesë një vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike... Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik...*

OE “AVE Consulting” sh.p.k. I ka shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike për muajin janar, shkurt 2016.

1.3. Parregullsi e konstatuar:

Kontratat e punës të lidhura midis OE “AVE Consulting” sh.p.k. dhe punonjësve që parashikohen të kryejnë punën objekt prokurimi, nuk kanë vlerë pasi nuk janë të noteruara dhe personat nuk janë të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë.

Të paktën dy prej tyre

- Daniel Gjoka me profesion arkitekt, i cili është parashikuar të mbulojë 70 për qind të shërbimit për kategorinë e punimeve në projektim 1a, 1b, 1c, 2a, dhe 2b, ka kontratë të pa noterizuar me afat 1.8.2015 deri 30.5.2016, e cila përfundon para afatit të kryerjes së punimeve dhe nuk gjendet në listë pagesat e kësaj periudhe.

- Alfred Lako me profesion inxhinier ndërtimi, I certifikuar për “Vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i cili është parashikuar të mbulojë 70 për qind të shërbimit për kategorinë e punimeve

në projektim të kësaj natyre, ka kontratë të pa noterizuar me afat 1.10.2015 deri 31.7.2016, nuk gjendet në listë pagesat e kësaj periudhe.

Sa më sipër në kundërshtim me pikën 4 të pikës 2 të “Kriteret e veçanta të Kualifikimit” të shtojcës 9 të DST në të cilën ndër të tjera është përcaktuar se ... *OE duhet të ketë një numër mesatar punonjësish të siguruar prej minimum 10. Për të vërtetuar këtë OE duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave, ... Për periudhën janar – dhjetor 2015, ... i shoqëruar me listë pagesë... Gjithashtu të gjithë drejtuesit teknikë duhet të jenë përfshirë në këto lista...*

Në projektet e ndryshme të zbatimit si elektrik, hidraulik etj, gjenden e 12 personave që mbulojnë shërbimin me kategoritë e punimeve që kanë në licencë, por në asnjë rast nuk është firma e tyre për projektin përkatës, psh për projektin elektrik të jenë firmat e dy inxhinierëve elektrikë të OE, Hysen Gjoka (AVE Consulting sh.p.k.) dhe Majlinda Mema (D&C Partners sh.p.k.).

Në projekt zbatimin të dorëzuar (arkitektura fleta A4-01, A3-04, A3-03, A3-02, A3-01 etj, ka firmosur zj. Anila Katundi, e cila nuk gjendet në stafin, listë pagesat apo personelin e afuar nga OE të BOE.

Me parregullsitë e konstatuara, KVO e përbërë nga zj. Eriona Rusmali me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Erjona Fishta me detyrë jurist, z. Rais Petrela me detyrë arkitekt (i jashtëm) në cilësinë e anëtarëve, duhet të skualifikonte BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. Me skualifikimin e tij, **fitues rezultoi “AA & E Engineering me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj ofertës ekonomike të BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners”, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik.**

Komente (Observacione) nga KVO (nr. 687/1, datë 7.7.2017 e AMA)

KVO përmbledhur ka bërë “Observacione”/sqarime se ... *konkluzioni i audituesve shtetërorë është i pa mbështetur pasi oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ku njëri prej të cilëve përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë përcaktohet pjesa e shërbimit ... që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.... Kontrata e bashkëpunimit është e paraqitur nga BOE është hartuar në formën e duhur ligjore... dhe përmbush elementët formalë të kërkuar... KVO ka vlerësuar si të rregullt kontratën noteriale të depozituar nga BOE pasi nga shqyrtimi i saj dhe i tërësisë së dokumentacionit ligjor të dy OE është arritur në përfundimin se secili prej anëtarëve të BOE i përmbush kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta. Theksojmë se procedura e prokurimit publik është “shërbim konsulence”, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale Pikërisht për shkak të natyrës së veçantë të kësaj procedure KVO ka vlerësuar me pikëzim të lartë ofertën teknike të paraqitur nga BOE ... Si përfundim KVO ka vepruar në harmoni me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.*

Të dy operatorët kanë paraqitur vërtetimet për shlyerjen e detyrimeve të faturuara të energjisë përmbushja e kriterëve të veçanta prej OE lider të kriterëve të veçanta është vlerësuar si kriter i përmbushur prej OE.

Lidhur me numrin e punonjësve... OE të ketë një numër mesatar punonjësish të siguruar minimumi prej 10 vetësh, për periudhën janar – dhjetor 2015 drejtuesit teknikë të jenë të

përfshirë në këto listëpagesa. Z. Daniel Gjoni me profesion arkitekt dhe Alfred Lako me profesion ing mjedisi sipas pikës 5 të KVK të DST kanë kontratë të rregullt pune. Në asnjë pikë të DST, nuk është parashikuar që inxhinierët e kontraktuar përmes një kontrate pune të përkohshme të përshihen në listë pagesat e shoqërisë kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar kohe...kundrejt punëdhënësit, i cili merr përsipër të paguajë...

Sqarim i audituesit.

Në “vërejtjet”/sqarimet e KVO, nuk ka ndonjë element shtesë ndaj të mëparshmëve, që grupi i auditimit të arsyetojë/vlerësojë ndryshe, për rrjedhojë, me argumentet e dhëna hollësisht në akt konstatim dhe Projektraport, “vërejtjet”/sqarimet e KVO, nuk qëndrojnë.

1.4. Lidhur me “Saktësinë e llogaritjes së fondit limit” në tenderin me objekt “Hartimi i projektpreventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”, me numër reference 22631, i zhvilluar në vitin 2016 me fond limit të llogaritur 49,999,949 lekë, i paraqitur/hartuar nga BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. me z. Arben Dervishi drejtues ligjor dhe teknik (AVE) dhe OE “D & C partners” me z. Edison Drishti drejtues ligjor/teknik dhe Vasillaq Shkurti drejtues teknik. Tenderi është zhvilluar datë 23.3.2016

Pasaktësi të konstatuara:

1.4.1. Në preventiv, në pjesën A-I me numër/emërtim “Punime prishje...”:

A-1.1. është përfshirë dhe zëri i punimeve “Ngritje, mobilim, mirëmbajtje ...” me analizë An me vlerë **236,078 lekë** (187,364 x 1,05 fondi rezervë x 1.2 TVSH).

A-1.2. është përfshirë dhe zëri i punimeve “Rrethim I përkohshëm me rrjetë teli” me vlerë **270,270 lekë** (214,500 x 1,05 fondi rezervë x 1.2 TVSH).

Përfshirja si zëra punimi me vete në preventiv/situacion i sa më sipër është në kundërshtim me germën B/3 të “Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi” të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 në të cilën është përcaktuar se në shpenzimet e përgjithshme përfshihen *Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, skelat, makineritë, tabelat sinjalizuese etj.*

Në zbatimin e punimeve të “Rikonstruksionit të godinës...” në preventivin fitues dhe në situacionin e punimeve për zërat e punimeve sipas A-1.1. dhe A-1.2 BOE “Mela” sh.p.k. & “Curri sh.p.k. zbatuese e punimeve të tenderit, i janë likuiduar respektivisht **50,000 lekë** dhe **160,750 lekë**, të cilat nën arsyetimin e mësipërm janë përfituar padrejtësisht nga OE “Mela” sh.p.k. dhe përbëjnë **dëm ekonomik**.

1.4.2. Pasaktësi e konstatuar:

Në strukturën e kostos, në preventivin e hartuar/dorëzuar nga BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k., midis zërave të punimeve është përfshirë vlera e pajisjeve me TVSH përkatëse, në kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, e cila përcakton se *në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat, si më poshtë:*

Në preventiv, në pjesën “Instalime hidro sanitare” zëri I punimeve me analizë 10, me emërtim “FV grup presioni I ujit të pijshëm ...” një copë me vlerë 314,000 lekë, e cila duhet të ishte vendosur/shtuar në fund të preventivit (pa u vlerësuar me TVSH).

Në preventivin fitues të “Rikonstruksionit të godinës...” dhe në situacionin e punimeve të paraqitur nga BOE “Mela” sh.p.k. & “Curri sh.p.k. zbatuese e punimeve të tenderit, vlera e kësaj pajisje në preventivin fitues është 267,044 lekë, e cila është **rritur me fondin rezervë prej 13,352 leke** (I parashikuar në masën 5 për qind) dhe vlerën e TVSH prej **53,408 lekë**, që përfaqëson pagesë/përfitim të padrejtë nga OE “Mela” sh.p.k., dhe nën këtë arsyetim është **dëm ekonomik**.

I njëjti arsyetim për:

- zërin e punimeve me numër rendor E2-4 “Analizë” “FV Detektor optik tymi me vetadresim të kompletuar me baza” të kapitullit E “Instalimi, sistemi I sinjalizimit kundra zjarrit” 46 copë me vlerë 257,600 lekë.

Vlera e shtuar padrejtësisht është **66,896 lekë** (nga e cila fondi rezervë 12,800 lekë dhe TVSH 54,096 lekë), e cila përbën **dëm ekonomik**.

- zërin e punimeve me numër rendor Z-2.1 “Analizë” “FV Panel komandimi I impiantit të MKZ për një zonë detektimi dhe shuarje të zjarrit” të kapitullit Z-2 “Impianti I mbrojtjes nga zjarri – Arkiva” 1 copë me vlerë 85,000 lekë.

Vlera e shtuar padrejtësisht është **22,100 lekë** (nga e cila fondi rezervë 4,250 lekë dhe TVSH 17,850 lekë), e cila përbën **dëm ekonomik**.

Në projekt zbatimin të dorëzuar (arkitektura fleta A4-01, A3-04, A3-03, A3-02, A3-01 etj, ka firmosur zj. Anila Katundi, e cila nuk gjendet në stafin, listë pagesat apo personelin e afruar nga OE të BOE.

Komente (Observacione) nga Komisioni i marrjes në dorëzim (nr. 669/1, datë 10.7.2017 e AMA) Komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. Enkelejd Lama me detyrë Drejtor I Drejtorisë së Mbikëqyrjes, Rais Petrela me detyrë arkitekt (i jashtëm) dhe Erisa Imerali me detyrë Drejtore e Shërbimeve të Brendshme cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Marrjes në Dorëzim të shërbimit të kryer përmbledhur ka bërë “vërejtje”/sqarime se ... kanë kontrolluar numrin e fletëve të dorëzuara të projekteve, relacioneve, specifikimeve teknike, përmbajtjen e tyre et hedhur në CD, si dhe ka kryer kontrollin aritmetik të preventivit. Komisioni... nuk ka hartuar preventiv, këto janë hartuar dhe dorëzuar nga hartuesit e projektpreventivit pra nga BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D 7 c Partners” sh.p.k....Komisioni thjesht ka marrë në dorëzim projektzbatimin e BOE Komisioni nuk ka të drejtë t’u kërkojë shoqërive stafin që kanë pasur, kanë apo do të kenë punësuar,. Anila Katundi është drejtues ligjor i OE “Sfera studio” sh.p.k. në të cilën arkitekt Daniel Gjoni është drejtues ligjor dhe teknik Anila Katundi ka firmosur në mungesë dhe me porosi të Daniel Gjoni, i cili mban përgjegjësi të plotë ligjore dhe profesionale...

Përsa i përket parregullsive të konstatuara lidhur me zërat e preventivit në pjesën A-1 punime prishje, sqarojmë se në procesin e tenderimit zërat e punimeve janë subjekt i uljeve nga ana e OE pjesëmarrës. Ulja e shpenzimeve plotësuese dhe normës së fitimit do të sillte automatikisht edhe uljen e vlerës së punimeve për ngritjen e kantierit dhe garantimin e sigurtisë në punë...bazuar në VKM nr. 312, datë 5.5.2015 “Për miratimin e rregullores “për sigurinë në kantier” bazuar në eksperiencat e mëparshme si dhe praktikën e institucioneve ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri si Banka Botërore, BERZH etj, siguria në kantier, shpenzimet për

Garantimin e sigurisë në punë, nuk duhet të jenë subjekt i uljeve në procesin e tenderimit...

Lidhur me TVSH e pajisjeve ju sqarojmë se të gjitha pajisjet që janë konsideruar në preventiv janë dhënë thjesht si çmim pajisje pa përfshirë vlerën e TVSH. TVSH është shtuar në fund për të përfituar vlerën totale të pajisjes. Praktikisht është e njëjta gjë. Pra nuk kemi dëm ekonomik...

Sqarim i audituesit.

Në “vërejtjet”/sqarimet e KVO, nuk ka ndonjë element shtesë ndaj të mëparshmëve, që grupi i auditimit të arsyetojë/vlerësojë ndryshe, për rrjedhojë, me argumentet e dhëna hollësisht në akt konstatim dhe Projektraport, “vërejtjet”/sqarimet e KVO, nuk qëndrojnë.

Vlen të theksohet se argumentet/sqarimet e KVO lidhur me:

- nocionin “shpenzimet plotësuese” dhe “fitimin”, nuk janë të sakta, nuk kanë lidhje me ato.

- Pasqyrimin e TVSH për pajisjet në një preventiv/situacion e jap saktë UKM nr. 2, datë 8.5.2003 dhe çdo veprim ndryshe nga sa përcaktohet aty, duhet të ishte shoqëruar me dokumentacionin përkatës, çka nuk është bërë.

2. “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”.

Godina objekt rikonstruksioni ka qenë pjesë dhe ndodhet prapa Radio Televizionit Shqiptar në rrugën “Abdi Toptani” në formë me përmasa 14 m x 20 m me tre kate.

Pjesa e hyrjes (balli, me orientim lindje) është 14 m dhe është e ana e vetme e lirë nga mund të punohet, futesh (rruga Abdi Toptani”), kurse tre anët e tjera janë të kufizuara (mbyllura), me objekte të tjerë, pa mundësi kalimi.

Midis AMA përfaqësuar nga Alba Qirjazi dhe z. Florian Demçe është lidhur “kontratë shërbimi” datë 21.7.2016. Në nenin të saj me emërtim “Specifikime” është përcaktuar se ... *ofruesi I shërbimit duhet të përgatisë të gjitha kërkesat teknike të KVK, për kualifikimin në hartimin e dokumenteve të tenderit. Ofruesi I shërbimit duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë të asnjësisë përse I përket nxitjes së konkurrencës.*

Parregullsi të konstatuara në hartimin e KVK nga Njësia e prokurimit (Florian Demçe):

2.1. Ka kërkuar që operatorët ekonomikë që shfaqin interes për pjesëmarrje në tender të kenë në licencë kategori të punimeve për zëra punimesh, të cilat nuk përmbahen në preventivin e punimeve të objektit në kundërshtim me nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar i cili ndër të tjera përcakton se ... *kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata.*

Nenin 26/5 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në të cilin është përcaktuar se ... *Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

Argumentim:

Njësia e prokurimit ka kërkuar që licenca profesionale e shoqërisë të përmbajë kategorinë e punimeve:

2.1.1. NP – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit përcakton se ...*Punime të inxhinierisë mjedisore Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.*

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurorë, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

2.1.2. N. S - 18 Punime topogjeodezike ... *Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

2.1.3. N.S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë ... *Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zëizoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.*

Autoriteti kontraktor, në rikonstrukcionin/punimet që do t kryejë, nuk ndodhet në asnjë prej situatave të përshkruara.

2.2. Të disponojnë numrin e nevojshëm **mesatar** të punonjësve ... *për periudhën janar 2015 qershor 2016 është 100 punonjës.*

Për këtë shifër nuk jepet ndonjë llogaritje, ose argument se mbi çfarë baze është kryer dhe konkretisht se për çfarë specialitetesh është llogaritur.

Mbështetur në normat/punonjës/makineri sipas manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015, numri i punonjësve të nevojshëm sipas specialiteteve, nuk e kalon shifrën 40.

Megjithëse objekti paraqet rikonstrukcion të një godine me madhësi modeste me sipërfaqe prej 280 m²/kati është kërkuar që **OE zbatues** të ketë në 12 punonjës inxhinier të profesioneve të ndryshme, nga të cilët 6 Drejtues teknikë dhe 6 pjesë e stafit, të punësuar të vërtetuar me listë pagesa etj.

Evidentohet në veçanti kërkesa për inxhinier mjedisi kur punime të tilla nuk ka, ekspert zjarrfikës megjithëse ka thjesht punime ndërtimi pa ndonjë rrezikshmëri të veçantë për rënie zjarri, inxhinier topograf, inxhinier hidroteknik telekomunikacioni, dy inxhinier mekanikë, dy ndërtimi etj, të cilët mbështetur në zërat e punimeve dhe volumet që përmban preventivi, nuk janë të nevojshëm.

2.3. OE duhet të dëshmojë se brenda numrit të kërkuar të punonjësve ka të punësuar në stafin e vet 50 punonjës me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT, të cilët duhet të jenë të pasqyruar në listë pagesa minimum për dy muajt e fundit (qershor – maj 2016), prej të cilëve manovratorë 3, hidraulikë dy pllakashtrues një etj.

Dëshmia e kualifikimit të IQT është standard me përmbajtje si vijon ... *mbështetur në ligjin Nr. 8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike"* me shënimin "Fiton" të nënshkruar.

Përmbajtja si më sipër, ka të bëjë me sigurinë e pajisjeve elektrike gjatë funksionimit dhe nuk ka asnjë lidhje me punën për rikonstrukcionin e godinës që do të kryejnë manovratorët pllakashtruesit, bojaxhinjtë etj.

Element që vlen të evidentohet është kriteri që i vendosur në germën C 5 sipas së cilës *OE duhet të dëshmojë se brenda numrit të kërkuar të punonjësve ka të punësuar në stafin e vet 50 punonjës me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT, të cilët duhet të jenë të pasqyruar në listë pagesa minimum për dy muajt e fundit (qershor – maj 2016).*

Megjithëse është kriter i panevojshëm, i formuluar kështu, pra që OE të ketë të punësuar në stafin e vet 50 punonjës me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga IQT, të cilët duhet të jenë të pasqyruar në listë pagesa minimum për dy muajt e fundit (qershor – maj 2016) Autoriteti Kontraktor ka diskriminuar, minimizuar deri në pamundësi pjesëmarrjen/konkurrencën e OE në tender.

2.4. Janë kërkuar tre ekskavatorë nga të cilët një me zinxhir dhe dy me goma, 6 makina vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës minimal mbi 100 ton (3 mjete me kapacitet mbi 20 ton dhe 3 me kapacitet mbajtës minimum 15 ton, ndërkohë që:

- Sipas preventivit zëri "Transport mbeturinash" është 333 m³ në distancë 5 km,

- Pjesa e mundshme që mund të ndërhyhet/punohet nga OE është vetëm ajo ballore e godinës që do të rikonstruktohet me gjatësi rreth 14 m, në një rrugë një kalimshe me gjerësi rreth 8 m'.

Volumi I punës dhe vet madhësia e objektit, kufizojnë ndjeshëm mjetet e nevojshme për realizimin e punës të cilat maksimalisht duhet të kërkoreshin një ekskavatorë dhe një makinë vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës 20 ton.

Për më tepër përcaktimi I bërë në germën d. 1 b të KVK që shoqëron shtojca nr. 9 "mbi disponibilitetin e makinerive" në të cilën është kërkuar që ... *Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera ... gjatë periudhës që do të realizohet ky objekt ... e bën kërkesën për makineritë edhe më diskriminuese për OE që kërkojnë të konkurrojnë.*

I njëjti arsyetim është i vlefshëm edhe për rrjeta mbrojtëse 2000 m², skela metalike 2,000 m², kur sipërfaqe e jashtme objektit në të cilën parashikohet të punohet është rreth 680 m², ose rreth tre herë më shumë etj.

Në tërësi praktika e ndjekur në hartimin/vendosjen e KVK është në kundërshtim me:

- Nenin I "Objekti dhe qëllimi" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" I ndryshuar në të cilin është përcaktuar se:

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

- Nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar i cili ndër të tjera përcakton se ... *kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata.*

- Nenin 26 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në të cilin është përcaktuar se ...*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.*

Pasi njihesh me procedurën e zhvillimit të tenderit vlen të evidentohet pjesëmarrja e vetëm një Bashkim Operatorësh ekonomikë, I cili është dhe fitues, çka të çon në përfundimin se hartimi I KVK, ka qenë në funksion të paracaktimit të OE fitues.

Në kushtet që në organikë nuk ka pasur inxhinier ndërtimi, ose të ngjashëm për hartimin e KVK të DST, AMA ka rekrutuar z. Florian Demçe si ekspert të jashtëm.

Në dosjen e rekrutimit të tij gjenden:

- Memo datë 1.7.2016 drejtuar për miratim zj. Alba Qirjazi me objekt “nevojën e procedimit të rekrutimit të një eksperti të jashtëm I cili do të përfshihet në njësinë e prokurimit për objektin “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”.

- “Shpallje për rekrutim ekspertësh të jashtëm” I botuar në faqen zyrtare të AMA. Në “shpallje...” ndër të tjera është përcaktuar se “*Eksperti në bashkëpunim të ngushtë me AMA do të angazhohet në hartimin e dokumentacionit të nevojshëm në mbështetje të Ligjit 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” ...*

Kualifikimet dhe aftësitë e ekspertit të njësisë së prokurimit:

- Diplomë e integruar ose ekuivalenti i saj në inxhinieri ndërtimi,
- Eksperienca të mëparshme në formulimin e detyrave të ngjashme.

- Diplomë inxhinier ndërtimi për Florjan Demçe, shoqëruar me “Letër për eksperiencë të ngjashme”, por të pa konfirmuara nga subjekti/institucioni në të cilat I ka kryer. Në të nuk jepet gjithashtu nëse aktualisht është i licencuar, ose i punësuar.

- Kontratë shërbimi datë 21.7.2016 lidhur midis Alba Qirjazi dhe Florian Demçe me objekt *Hartimi I dokumenteve të tenderit...* (është paraqitur vetëm një kandidaturë).

Komente (Observacione) të zj. Alba Qirjazi me detyrë Sekretare e Përgjithshme, në cilësinë e eprorit, i cili ka miratuar procedurën e zgjedhjes së ekspertit të jashtëm në përgatitjen e KVK dhe z. Florian Demçe me profesion inxhinier ndërtimi, në cilësinë e ekspertit të jashtëm të rekrutuar nga AMA përgatitjen e të gjithë kërkesave teknike të Kushteve të Veçanta për Kualifikim (nr. 679/1, datë 10.7.2017 e AMA. Observacionet në vijim përmbahen në këtë shkresë).

Lidhur me kategorinë e punimeve të kërkuara nga AK operatorëve ekonomikë (sipas pikës 2.1. të këtij materiali).

Konkluzioni i audituesve është i pa mbështetur pasi:

Së pari AK i vendos kriteret për kualifikim në mënyrë që të njohë gjendjen e OE ofertues i cili nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojë se zotëron kualifikimin e nevojshëm

teknik (makineri pajisjet) dhe profesional (stafi përbërës, numrin e punonjësve) ... OE duhet të ketë besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe stafin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës...

Së dyti Para se objekti të prokurohej është hartuar një raport i vlerësimit mjedisor të tij. Kjo për të parë impaktet që do të ketë ky objekt në mjedisin rrethues, duke qenë se zona është mjaft e populluar... në VNM theksohet se duke qenë se ndërtohet në një zonë të populluar dhe është një aktivitet kompleks i përbërë nga një sërë aktivitete të cilat zhvillohen në një hapësirë të kufizuar, por të shpërndara në pjesë të ndryshme në kohë, ka mpakte negative pothuajse në të gjithë komponentët mjedisorë si zhurmat, ujërat pluhurat, toka, bimësia trafiku dhe prodhimi i mbetjeve. Impakti më i fortë regjistrohet në aspektet e para si dhe në vështirësitë e mëdha lidhur me zbutjen e ndjeshmërisë dhe pakënaqësisë së komunitetit. Në bazë të lokalizimit të kantierit, limitet për t'u respektuar janë shumë shtrënguese, në funksion të pranisë së zonave të urbanizuara dhe receptorëve të ndjeshëm si shkolla, banesa shumëkatëshe, RTSH etj, etj. të kësaj natyre.

Sqarim i audituesit.

Sa trajtohet në "Observacion", nuk ka lidhje me sa është argumentuar hollësisht në akt - konstatim dhe Projektraport nga audituesi, për rrjedhojë, "Observacioni", nuk qëndron.

Koment (Observacion) lidhur me numrin mesatarë të punonjësve (100 punonjës të kërkuar).

Së pari mbështetur në normat punonjës/makineri/transport sipas manualit të miratuar me VKM e muajit mars 2015 dhe në marrëveshjen e Drejtorisë Përgjithshme të Tatimeve dhe Shfaqjes së Ndërtuesve të Shqipërisë, për efekt të llogaritjes së kontributit të sigurimeve shoqërore, pjesa që zënë pagat dhe kontributi i sigurimeve shoqërore në koston minimale për efekt fiskal do të jetë 17,6 për qind e koston së ndërtimit pa TVSH. Vlera e objektit 49,999,926 lekë pa TVSH. Fondi i pagës së punonjësve 49,999,926 lekë x 17,6 për qind = 8,799,926 lekë.

Mbështetur në pagën bazë përkatëse, përkatësisht kategorive të punëtorëve ta parashikuar në normë për çdo zë pune sipas manualit të miratuar me VKM e muajit mars 2015 specialist + punëtor (sp+p) pagën orare minimale për kategori të parë të punëtorisë 150 lekë/ora (njehsuar me gjithë sigurimet shoqërore)

Orët e punës së punonjësve $8,799,926 : 150 \text{ lekë/ora} = 58,667 \text{ orë pune}$

Sipas Kodit të punës një punonjës duhet të punojë 40 orë në javë dhe e llogaritur 160 orë/muaj.

Afati për ndërtimin e objektit është 4 muaj e përkthyer ndryshe $4 \times 160 \text{ orë/muaj} = 640 \text{ orë pune për një punonjës.}$

$58,667 : 640 \text{ orë/punonjës} = 92 \text{ punonjës.}$

Duke marrë në konsideratë që AK kërkon që objekti të mbarojë në kohë të shkurtër duke i dhënë garanci është gjykuar për numrin 100 punonjës nga OE. Numri 100 punonjës për periudhën janar 2015 deri qershor 2016 nuk diskriminon asnjë operator ekonomik Qëllimi i AK ka qenë që KVK të thjeshtohen afër KPK për të nxitur konkurrencën dhe një trajtim të barabartë midis OE.

Sqarim i audituesit.

Me argumentet e dhëna hollësisht në akt konstatim dhe Projektraport (pika 2.1 deri 2.4.), "Observacionet", nuk qëndrojnë.

Vlen të theksohet edhe njëherë se në procedurat e prokurimit publik, në llogaritjet e ndryshme për fondin limit, apo tregues të tjerë lidhur me nevojën për mjete pune, apo punonjës,

material/dokumentacion bazë janë manualet e çmimeve të miratuara, në rastin konkret manualet e çmimeve të miratuara me VKM nr. 629, datë 15.7.2015.

Në “analizat teknike” (strukturën e çmimeve) të manualeve, element përbërës është dhe “Punëtorja” (paga dhe shtesa për paga në masën 16,7 për qind, e cila përfaqëson sigurimet shoqërore që paguhën nga punëdhënësi) kundrejt njësisë matëse përkatëse (copë, m², m³, ton etj.).

Mbështetur në manual, nevojat për “punëtori” etj, llogariten mbi bazën e çmimit për orë pune (sipas manualeve 185 lekë/ora), dhe orët e punës sipas njësisë matëse për zërin e punimeve duke e shtrirë për gjithë volumet e punës të parashikuar sipas preventivit.

“Llogaritjet” e paraqitura nga zj. Alba Qirjazi dhe z. Florian Demçe, për nevojat për punonjës etj, nuk kanë lidhje me çfarë përcaktojnë manualet, janë tërësisht të pa mbështetura në to, për rrjedhojë janë të gabuara.

E formuluar ndryshe, AK ka kërkuar mesatarisht 100 punëtorë në ditë për 4 muaj resht për “Rikonstruksionin e godinës së AMA”, e cila (godina) paraqet një figurë gjeometrike drejtkëndësh, me perimetër (shuma e gjatësisë së brinjëve 68 ml gjithsej, dy brinjë me gjatësi 14 ml dhe dy brinjë me gjatësi 20 ml).

Pra ka kërkuar 100 punëtorë për 68 ml gjatësi gjithsej, që është perimetri i godinës, ose në rreth 1.5 punëtorë/ml gjatësi.

Gjithsesi edhe me llogaritjet e vet AK, rezultojnë 92 punonjës, jo 100 që janë kërkuar në KVK.

Koment (Observacion) lidhur me kërkesën në KVK që kompania të ketë një mjek.

Është kërkuar sipas legjislacionit në fuqi për të gjitha kompanitë që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e ndërtimit dhe të punëve publik, bazuar në “Rregulloren për sigurinë në kantier” ligjin nr. 10,237, datë 18.2.2010, neni 23.

Sqarim i audituesit.

Pavarësisht se sa më sipër nuk është parashikuar në Nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar i cili ndër të tjera përcakton se ... *kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata* dhe Nenin 26 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, më sipër pranohet dhe reflektohet në raportin përfundimtar.

Koment (Observacion) nga Alba Qirjazi dhe Florian Demçe lidhur me “mbrojtjen” e kritereve që janë vendosur në KVK, sipas të cilave ... *operatori ekonomik ...Të ketë ekspert zjarrfikës pjesë të stafit, inxhinier telekomunikacioni, inxhinier hidroteknik, dy inxhinierë mekanikë, dëshmia e kualifikimit nga IQT, numri i mjeteve, kapaciteti i tyre ... etj.*

Audituesi konstaton se me argumentet e paraqitur hollësisht në akt konstatim dhe Projektraport (pika 2.1 deri 2.4.), “Observacionet”, nuk qëndrojnë.

Lidhur me procedurën e “Ligjshmërisë, rregullshmërisë të procedurës së kualifikimit” të BOE “Mela” sh.p.k. dhe “Curri” sh.p.k. në tenderin me emërtim “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” disa të dhëna për të cilin janë:

Të dhëna për prokurimin	Komisioni i Vlerësimit Ofertave	Njësia e prokurimit
a	b	c
1. Urdhër prokurimi, nr. 115, dt. 21.7.2016 2. Fondi limit 49,999,999 lekë. Procedura e prok. Hapur 4. Data e zhvillimit 22.8.2016 5. Kontraktuesi BOE "Mela" sh.p.k. & "Curri" sh.p.k. 47,259,763 lekë 6. kontrata lidhur datë 9.9.2016 Diferenca me fondin limit 2,740,236 lekë.	Evgjeni Bashari kryetare Arjola Kadare Erjon Ngjela	Enkelejd Lamaj Monika Plasa Florian Demçe

Nga verifikimi në sistemin elektronik të APP u konstatua se ka paraqitur ofertë ekonomike vetëm BOE "Mela" sh.p.k. & "Curri" sh.p.k. me vlerë (fond limit) 47,259,763 lekë.

Midis OE është lidhur kontrata e noteruar për bashkimin e përkohshëm të operatorëve (BOE) ekonomikë "Mela" sh.p.k. dhe "Curri" sh.p.k. në të cilën ndër të tjera është përcaktuar se:

- Shoqëria "Mela" sh.p.k; do të kryejë 16 për qind të **gjithë punimeve të parashikuara** (sipas preventivit),
- Shoqëria "Curri" sh.p.k. do të kryejë 84 për qind të **gjithë punimeve të parashikuara** (sipas preventivit).
- Kryesuese e këtij bashkimi do të jetë shoqëria "Mela" sh.p.k.

2.5. Parregullsia e konstatuar:

2.5.1. OE "Mela" sh.p.k. në licencën e shoqërisë nuk ka kategoritë e punimeve:

- NP-12 "Punime të inxhinierisë së mjedisit",
- NS-18 "Punime topogjeodezike",
- NS- 19 "Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë", në kundërshtim me pikën 2.a.I dhe 2. a.II të KVK të miratuara me DST.

2.5.2. OE "Mela" sh.p.k. në licencën e shoqërisë nuk ka Drejtues teknik të punësuar me kontratë pune të vlefshme të profesionit:

- Inxhinier topograf
- Inxhinier mjedisi,
- inxhinier telekomunikacioni.

Në staf, nuk ka të punësuar të punësuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listë pagesa, një inxhinier mekanik dhe një ekspert zjarrfikës, në kundërshtim me pikën 2.C.2 dhe 2.C.4 të KVK të miratuara.

2.5.3. OE "Curri" sh.p.k. në licencën e shoqërisë nuk ka Drejtues teknik të punësuar me kontratë pune të vlefshme të profesionit:

- Inxhinier topograf
- inxhinier telekomunikacioni.

Në staf, nuk ka të punësuar të punësuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listë pagesa, një inxhinier hidroteknik, një arkitekt dhe një mjek, në kundërshtim me pikën 2.C.2 dhe 2.C.4 të KVK të miratuara.

Nuk ka një mjet "autobot uji". Mjeti i tipit benz me targë SH 4082 E i paraqitur në shtojcën 9 "Mbi disponimin e makinerive" si autobot uji, me kod "GA" në lejen qarkullimin e mjetit, nuk është "autobot uji", por një kamion me përdorim tjetër.

Me parregullsitë e konstatuara KVO, duhet të skualifikonte BOE “Mela” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k.

Parregullsitë e konstatuara ngarkojnë me përgjegjësi KVO e përbërë nga zj. Evgjëni Bashari me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Licencave, në cilësinë e kryetarit, Arjola Kadare me detyrë Përgjegjëse Zyrës së Financës dhe Erjon Ngjela me profesion inxhinier ndërtimi ekspert i jashtëm, në cilësinë e anëtarëve të KVO.

Koment (Observacion) nga KVO.

Konkluzioni i audituesve shtetërorë është i pambështetur... Në interpretim të nenit 74 pika 3 e VKM nr. 914, datë 29.12.2014, KVO, në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga BOE ka detyrim ligjor për të verifikuar plotësimin e kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të parashikuara në dokumentet e tenderit për secilin nga operatorët ekonomikë të BOE, ndërsa në lidhje me vlerësimin e plotësimit të kërkesave ekonomike, financiare, profesionale dhe teknike duhet të vlerësojë, përmbushjen e tyre, jo më nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në mënyrë të veçantë, por nga i gjithë bashkimi i operatorëve ekonomikë.

Konkretisht në pikën 1 të akt konstatimit konkludohet se OE “Mela” sh.p.k. nuk ka në licencën e shoqërisë kategoritë e punimeve të përcaktuara në KVK të miratuara në pikën 2.a.I dhe 2.a.II, por nuk vlerësohet OE “Curri” sh.p.k. në licencën e të cilit janë kot kategori punimi NP-12 “Punime të inxhinierisë të mjedisit”, NS-18 “Punime topogjeodezike”, NS-19 “Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë”... etj.

Sqarim i audituesit.

“Observacionet” e bëra nga KVO, janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të cituara në pikën 2.5. të akt konstatimit dhe Projektraporti, për rrjedhojë *nuk qëndrojnë.*

Vlen të theksohet se në arsyetimet e KVO, tejkalohet fakti që në kontratën e noterizuar lidhur midis palëve, për bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Mela” sh.p.k. dhe “Curri” sh.p.k. ndër të tjera është përcaktuar se:

- Shoqëria “Mela” sh.p.k.; do të kryejë 16 për qind të **gjithë punimeve të parashikuara** (sipas preventivit),
- Shoqëria “Curri” sh.p.k. do të kryejë 84 për qind të **gjithë punimeve të parashikuara** (sipas preventivit).

Mbështetur në nenin 74 “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 në të cilin është përcaktuar se ...

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. *Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.*

2. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, *përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi...*

3. *Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në*

përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Parregullsia e evidentuar nga audituesi në akt konstatim dhe Projektraport lidhet saktësisht paragrafin e fundit të nenit 74/3, e cila në rastin konkret, mbështetur në kontratën lidhur midis palëve, i detyron ato të plotësojnë secila, tërësisht kriteret e parashikuara në KVK të DST.

Nga auditimi u vërejt se: Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar, për vitin 2014, janë depozituar pranë APP, regjistri i parashikimeve për prokurimet publike, por nuk janë përgatitur realizimet 4 – mujore të faktit. Për vitet 2015, 2016, janë depozituar pranë APP regjistrin e parashikimeve si dhe realizimet sipas periudhave 4 – mujore, të ndara sipas llojit të prokurimit.

Për vitin 2015, sipas regjistrit të parashikimeve ishin parashikuar dhe realizuar 20 prokurime me vlerë të vogël.

Më konkretisht praktikat e parashikuara në regjistrin e parashikimeve dhe realizimi i tyre jepet në tabelën e mëposhtme:

Prokurimet AMA, viti 2015

Nr.	Prokurime me vlerë të vogël	Vlera e parashikuar (ne leke)	Vlera e shpenzuar (ne leke)	KLASIFIKIMI	
				602	231
1	Blerje Pajisje Zyre	500,000	643,142		X
2	Riparim dhe shërbime për automjete	600,000	1,120,967	X	
3	Siguracion, taksa regjistër. Kolaudim	480,000	201,552	X	
4	Blerje bojëra printeri e fotokopje	480,000	479,293	X	
5	Blerje kancelari	480,000	530,713	506,953	23,760
6	Blerje abonime shtypi	480,000	348,000	X	
7	Blerje materiale të ndryshme	480,000	840,671	X	
8	Shërbim mirëmbajtje gjeneratori	300,000	331,080	X	
9	Shërbim mirëmbajtje pajisjeve elektronike	400,000	377,260	X	
10	Materiale pastrimi	350,000	236,520	X	
11	Lavash dhe parkim makinash	330,000	60,100	X	
12	Shpenzim për udhëtim jashtë	960,000	939,810	X	
13	Shpenzime për krijimin dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit të AMA	480,000	420,000	X	
14	Shpenzime për mirëmbajtjen e faqes së internetit dhe monitorimin	480,000	7,000	X	
15	Blerje shtypshkrime, libra dhe përkthime	400,000	153,035	X	
16	Shpenzime për administratën	250,000	459,144	X	
17	Shpenzime për asistencë teknike	480,000	141,000	X	
18	Shpenzime për mirëmbajtje	1,000,000	1,003,938	X	
19	Shpenzime për pritje përcjellje	120,000	97,278	X	
20	Shpenzime për konferenca rajonale dhe kombëtare	3,000,000	1,133,036	X	

Referuar regjistrimit vihet re se: në zërat parashikuar për “Blerje Pajisje Zyre”, “Riparim dhe shërbime për automjete”, “Blerje kancelari”, “Blerje materiale të ndryshme”, “Shpenzime për mirëmbajtje”, nga AMA ka kaluar fondin e parashikuar për tu realizuar ky shpenzim, pasi nga Autoriteti Kontraktor nuk është bërë ndryshim në regjistrin e prokurimit në APP, pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit numër 3, datë 27.01.2015.

Titullari i AMA-s, për “procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël” bazuar, nenit 40, kreu IV, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas urdhrave, nr. 5, datë 07.01.2015, nr. 10, datë 19.01.2015 dhe nr. 10/1, datë 24.04.2015, ka ngritur komisionet e prokurimit me vlerë të vogël.

Nga auditimi i ushtruar mbi realizimin e prokurimeve me vlerë të vogël në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) u konstatua se, për procedurat e prokurimit “Blerje me vlerë të vogël” për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ka mangësi dhe parregullsi gjatë realizimit të këtyre procedurave të cilat binin ndesh me ligjin e prokurimit publik.

-Në shumë raste nuk bëhet përlllogaritje e fondit limit nga komisioni i caktuar me urdhrin e titullari, por fondi limit përcaktohet apriori ose duke marrë parasysh parashikimin e bërë në projekt buxhet, në kundërshtim me Urdhrin Nr./33, datë 11/07/2013 “Për gjurmët standarde të auditit”, nenin 59 kreu 7 i Ligjit të Prokurimit Publik.

-Disa nga procedurat për blerje të vogla nuk u nënshtroheshin procedurave online të prokurimit publik, por kryheshin në mënyrë shkresore, në kundërshtim me pikën 5 dhe 8 të Udhëzimit Nr. 3, datë, 27.01.2015 “Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël”

-Nga Autoriteti kontraktor procedurat e nisura në mënyrë shkresore, bëheshin me urdhra të dala nga titullari sipas formularit 5 në kundërshtim me pikën 5 të Udhëzimit Nr. 3, datë, 27.01.2015 “Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël”, pasi këto lloj procedurash një pjesë është realizuar në mënyrë shkresore me formularin 2 dhe më vonë me atë të formularit 5. Më konkretisht për:

“Blerje Pajisje Zyre”, në vlerë sipas parashikimit prej 500,000 lekë është likuiduar në vlerë prej 643,142 lekë.

Nga Autoriteti Kontraktor kjo procedure vetëm në një rast është kryer duke ju nënshtuar rregullave të prokurimit publik sipas urdhër prokurimit nr. 46, datë 11.03.2015 në fond limit 93,600 lekë me fitues Erzeni sh.p.k.

Gjithë procedurat e tjera janë realizuar në mënyrë shkresore, në kundërshtim me pika 5 Udhëzimit Nr. 3, datë, 27.01.2015 “Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël”.

Për këtë procedurë, nga Titullari i Autoriteti Kontraktor, kishin dalë Urdhrat e Prokurimit për çdo rast zhvillim procedure, ku 5 Urdhra ishin sipas formularit 2 në vlerë totale likuiduar nëpërmjet bankës prej 300,220 lekë me TVSH dhe 12 Urdhra ishin sipas formularit 5, me vlerën totale të likuiduar prej 342,922 lekë me TVSH. Procedurat e likuiduar me cash nëpërmjet arkës ishin në 6 praktika, sipas urdhër Prok. me nr. 106, dt. 12.05.2015, me vlerë 2,500, fitues F. Haxhiraj, urdhër Prok. Nr. 160, datë 21.07.2015, me vlerë 2,200 lekë, fitues Tregu lirë, urdhër Prok nr. 242, datë 10.11.2015, me vlerë 3,600 lekë, me fitues Milda Bratko, urdhër Prok me nr. 247, datë 21.11.2015, me vlerë 1,500 lekë, fitues Tregu lirë, urdhër prok. Me nr. 51, datë 12.03.2015, me vlerë 7,500 lekë, fitues Global Electronics, urdhër Prok nr. 258, datë 03.12.2015, me vlerën 17,920 lekë, fituesi KID ZONE, pra kundërshtim me pikën 8, të udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar, për mallrat, shërbimet ose punë të ngjashme, të cilat nuk e kalojnë vlerën e 100,000 lekë, për gjithë vitin. Ku citohet “Kur vlera e përlllogaritur për mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor, brenda vitit kalendarik nuk është më e

madhe se 100.000 (njëqind mijë) lekë autoriteti kontraktor mund të kryejë prokurimin në rrugë shkresore sipas formularit Nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi. ”

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë, duke shkaktuar copëtim të fondit të parashikuar për prokurim publik dhe duke bërë shmange ose anashkaluar procedurat online të Prokurimit Publik

1-Për “Riparim dhe shërbime për automjete” është parashikuar si fond limit në regjistrin e parashikimeve në masën prej 600,000 lekë me TVSH dhe realizuar sipas regjistrit të realizimit të prokurimeve në vlerën prej 1,120,967 lekë, duke tejkaluar fondin për prokurimet me vlerë të vogël prej 800,000 mijë lekë, në kundërshtim me pikën 1 të udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015.

Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 17 procedura prokurimi. Nga këto procedura, 8 prej tyre janë kryer vetëm me Formularin 2, pasi ofruesi i shërbimit është koncesionari shoqëria “Porche Albania” sh.p.k. ku janë blerë 2 nga automjetet e Institucionit, në vitin 2011, por procedurat e tjera për këtë zë janë kryer me kompani të tjera, nëpërmjet Formularit 5, konkretisht 7 procedura në vlerën prej 368,706 lekë. Gjithashtu janë mbajtur dhe 2 proces verbale emergjence, sipas modelit të përcaktuar në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar. Likuidimi i 5 prej procedurave të realizuara për këtë zë janë bërë nëpërmjet arkës cash, në vlerën totale prej 32,880 lekë.

2.-Zëri “Blerje kancelari” është parashikuar si fond limit në masën prej 480,000 lekë me TVSH, procedura blerje me vlerë të vogël dhe është realizuar në vlerën prej 527,713 lekë. Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 8 procedura prokurimi. Nga këto vetëm në një rast është kryer duke ju nënshtruar rregullave të prokurimit publik sipas urdhër prokurimit nr. 8, datë 14.01.2015 në fond limit 237,600 lekë me fitues Info soft sh.p.k.

Ndërsa 6 prej janë kryer nëpërmjet Formularit 5, në vlerën totale prej 27,440 lekë, të cilat janë likuiduar nëpërmjet arkës në lekë.

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara sipas VKM nr., 914, datë 29.12.2014, si dhe procedurat në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë, duke çuar në copëtim të fondit të prokuruar.

3- “Blerje bojëra printeri e fotokopje” është parashikuar si fond limit në masën prej 480,000 lekë me TVSH, procedura blerje me vlerë të vogël, shpenzim. Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 7 procedura prokurimi. Nga këto procedura, 6 prej janë kryer nëpërmjet Formularit 5, në vlerën totale prej 79,333 lekë. Ndërkohë procedura me nr. prot 270/22, datë 06.05.2015, me fitues shoqërinë “N. Electronics” sh.p.k. është kaluar me Formularin nr. 6, të përcaktuar në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar për rastet kur bëhet anulimi 2 herë në mënyrë të njëpasnjëshme procedurave të blerjeve me vlerë të vogël, në sistemin elektronik të APP.

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara sipas VKM nr., 914, datë 29.12.2014, si dhe procedurat në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë, duke çuar në copëtim të fondit të prokuruar.

4-“Blerje material të ndryshme” është parashikuar si fond limit në masën prej 480,000 lekë me TVSH, procedura blerje me vlerë të vogël është kryer duke mos ju nënshtruar rregullave të prokurimit publik. Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 50 procedura prokurimi. Të gjitha këto procedura rezultojnë të jenë kryer nëpërmjet mënyrës shkresore të përzgjedhjes së fituesit, Formulari 2 dhe Formulari 5.

Likuidimi i 36 prej procedurave të realizuara për këtë zë janë bërë nëpërmjet arkës cash, në vlerën totale prej 100,268 lekë

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara sipas VKM nr., 914, datë 29.12.2014, si dhe procedurat në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë.

5-“Shërbim mirëmbajtje gjeneratori” është parashikuar si fond limit në masën prej 300,000 lekë me TVSH, procedura blerje me vlerë të vogël. Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 4 procedura prokurimi, në vlerën totale prej 331,080 lekë. Të gjitha këto procedura rezultojnë të jenë kryer nëpërmjet mënyrës shkresore të përzgjedhjes së fituesit, Formulari 2 dhe Formulari 5, likuidimi I praktikave është kryer nëpërmjet sistemit bankar.

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara sipas VKM nr., 914, datë 29.12.2014, si dhe procedurat në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë.

6-“Shërbim mirëmbajtje pajisjeve elektronike” është parashikuar si fond limit në masën prej 400,000 lekë me TVSH, procedura blerje me vlerë të vogël. Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 10 procedura prokurimi, në vlerën totale prej 377,260 lekë. Të gjitha këto procedura rezultojnë të jenë kryer nëpërmjet mënyrës shkresore të përzgjedhjes së fituesit, Formulari 2 dhe Formulari 5, likuidimi I praktikave është kryer nëpërmjet sistemit bankar.

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara sipas VKM nr., 914, datë 29.12.2014, si dhe procedurat në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë.

Për vitin 2016 AMA ka depozituar pranë APP regjistrin e parashikimeve si dhe realizimet sipas periudhave 4 – mujore, të cilat të ndara sipas llojit të prokurimit dhe klasifikimit kontabël janë si më poshtë:

Nr.	Prokurime me vlere te vogël	Vlera e parashikuar (ne leke)	Vlera e shpenzuar (ne leke)	KLASIFIKIMI	
				602	231
1	Blerje Pajisje Zyre	600,000	429,405		X
2	Lavash dhe parkim makinash	400,000	492,500	x	
3	Riparim dhe shërbime për automjete	1,855,000	474,576	x	
4	Siguracion, taksa regjistër. Kolaudim	210,000	330,595	x	
5	Shpenzime te tjera transporti	100,000	10,480	x	
6	Blerje bojëra printeri e fotokopje	600,000	504,200	x	
7	Shpenzime per mirëmbajtje te pajisjeve te zyrës	340,000	269,530	x	
8	Blerje kancelari	2,500,000	717,461	x	
9	Materiale pastrimi	300,000	273,348	x	
10	Shpenzime per mirëmbajtje te pajisjeve elektronike dhe te veglave te punës	1,105,750	248,616	x	
11	Shpenzime per mirëmbajtjen e godinës	1,230,000	790,300	x	
12	Blerje material te ndryshme	548,000	542,773	259,678	283,095
13	Blerje abonime te ndryshme	600,000	422,600	x	
14	Linje internet ADSL	30,000	104,328	X	
15	Materiale dhe shërbime te tjera	200,000	189,260	x	
16	Shpenzime per pritje përcjellje	250,000	71,410	x	
17	Mbikëqyrje Punimesh për Rikonstrukcion e Atelier për dekorin e Radio-Televizionit të kaluar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe përshtatje për zyra.	956,386	44,301	x	

18	Monitorimi i fushatës për Informimin e Publikut	960,000	598,500	x	
19	Organizim konferencash dhe nënshkrim marrëveshjes	2,240,000	1,996,555	x	

-Për vitin 2016, procedurat e prokurimeve me vlerë të vogël, sipas nenit 40, kreu IV, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, janë kryer nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, ngritur me urdhër të titullarit me nr. 5, datë 08.01.2016. Ndërsa procedurat me vlerë mbi 800,000 lekë, janë kryer me komisione të veçanta sipas rastit.

Referuar regjistrimit vihet re se në zërat parashikuar për, “Riparim dhe shërbime për automjete”, “Blerje kancelari”, “Shpenzime për mirëmbajtje të pajisjeve elektronike dhe të veglave të punës”, fondet janë parashikuar me vlera sh të larta në krahasim me realizimin e kryer

Pra shihet qartë se për këto shpenzime nga AMA, janë parashikuar me vlera mbi kufijtë monetarë duke aplikuar “për blerje të vogla, të vendosura në regjistrin e parashikimit të realizimit publik, në kundërshtim me ligjin për Prokurimin Publik.

1-Autoriteti për zërin “Blerje pajisje zyre” ka parashikuar si fond limit masën prej 600,000 lekë me TVSH, të klasifikuar si procedura Blerje me vlerë të vogël, llogari investimi e realizuar në vlerën prej 351,405 lekë. Praktikata e realizimit të këtij zëri janë kryer nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, me urdhër prokurim sipas formularit nr. 2, nga Sekretari i Përgjithshëm në rolin e Autoritetit Kontraktor, të ndarë në 13 procedura të veçanta, me vlerë të vogël.

Rezulton se, vetëm dy procedura janë kryer konform ligjit ato sipas Urdhrave nr. 12 datë 26.01.2016 me fond limit 62,000 lekë me fitues TECH sh.p.k dhe me urdhrin nr. 19, datë 08.02.2016, ndërsa 11 nga procedura janë kryer sipas Formularit 5,, me vlerën totale të likuiduar prej 329,705 lekë me TVSH, në kundërshtim pikën 8, të udhëzimit nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar, *ku citohet “Kur vlera e përlllogaritur për mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor, brenda vitit kalendarik nuk është më e madhe se 100.000 (njëqind mijë) lekë autoriteti kontraktor mund të kryejë prokurimin në rrugë shkresore sipas formularit Nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.”*, pasi vlera për blerjen e këtij grup mallrash kalon vlerën e 100,000 lekë, për gjithë vitin.

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë, duke shkaktuar copëtim të fondit të parashikuar për prokurim publik.

Likuidimet e procedurave të përfunduara për këtë zë ishin kryer nëpërmjet sistemit bankar dhe në formë cash nga arka në lekë. Procedurat e likuiduar me cash nëpërmjet arkës janë 5 praktika, sipas urdhër Prok. me nr. 30, dt. 26.02.2016, me vlerë 7,990 lekë, fitues Neptun sh.p.k, urdhër Prok. Nr. 108, datë 15.09.2016, me vlerë 2,490 lekë, fitues Neptun sh.p.k, urdhër prok nr. 127, datë 10.10.2016, me vlerë 8,000 lekë, me fitues Shkëlzen Xhani, urdhër Prok me nr. 128, datë 10.10.2016, me vlerë 9,025 lekë, fitues Info Soft sh.a., urdhër prok. Me nr. 129, datë 10.10.2016, me vlerë 3,400 lekë, fitues Rrelli.

2- “Riparim dhe shërbime për automjete” është parashikuar si fond limit në masën prej 1,855,000 lekë me TVSH. Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 13 procedura prokurimi. Nga këto procedura, 5 prej tyre janë kryer vetëm me Formularin 2, *pasi ofruesi i shërbimit është koncesionari shoqëria “Porche Albania” sh.p.k., dhe “Hyundai” sh.p.k ku janë blerë 3 nga automjetet e Institucionit, në viti 2011 dhe 2016, ndërsa procedurat për këtë zë, riparimet janë kryer në kompani të tjera, nëpërmjet Formularit 5, konkretisht 7 procedura në vlerën prej*

219,764 lekë, 6 prej procedurave, likuidimi është realizuar nëpërmjet arkës cash, në vlerën totale prej 74,100 lekë.

3-“Shërbim mirëmbajtje pajisjeve të zyrave” është parashikuar si fond limit në masën prej 340,000 lekë me TVSH, procedura blerje me vlerë të vogël, shpenzim. Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 8 procedura prokurimi, në vlerën totale prej 269,530 lekë. Të gjitha këto procedura rezultojnë të jenë kryer nëpërmjet mënyrës shkresore të përzgjedhjes së fituesit, Formulari 2 dhe Formulari 5, likuidimi i praktikave është kryer kryesisht nëpërmjet sistemit bankar, përveç 1 procedure, në vlerën 3,000 lekë, e cila është likuiduar me cash.

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara sipas VKM nr., 914, datë 29.12.2014, si dhe procedurat në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë.

4-“Blerje kancelari” është parashikuar si fond limit në masën prej 2,500,000 lekë me TVSH, procedura blerje me vlerë të vogël dhe është realizuar në vlerën prej 615,261 lekë, siç shihet parashikimi për këtë zë është i pabazuar në nevojat konkrete të AMA-s dhe nisur nga parashikimi, procedura e prokurimit duhej të ishte ajo me vlera mbi 800,000 lekë.

Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 16 procedura prokurimi. Nga këto procedura, 14 prej janë kryer nëpërmjet mënyrës shkresore të përzgjedhjes së fituesit, Formulari 2 dhe Formulari 5, në vlerën totale prej 282,225 lekë, nga të cilat janë likuiduar nëpërmjet arkës në lekë, 11 procedura në vlerën totale prej 68,0025 lekë, vetëm 2 procedurat e tjera për nevojat për këtë zë, janë kryer nëpërmjet sistemit elektronik të APP, me Ftesë për ofertë, duke qenë kështu në përputhje me udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar.

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara sipas VKM nr., 914, datë 29.12.2014, si dhe procedurat në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë, duke çuar në copëtim të fondit të prokuruar.

5- “Blerje material të ndryshme” është parashikuar si fond limit në masën prej 548,000 lekë me TVSH dhe është realizuar në vlerën prej 775,677 lekë, me procedura blerje me vlerë të vogël. Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 21 procedura prokurimi. Të gjitha këto procedura rezultojnë të jenë kryer nëpërmjet mënyrës shkresore të përzgjedhjes së fituesit, Formulari 2 dhe Formulari 5. Dhe për këtë shpenzim nuk është respektuar fondi limit.

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara sipas VKM nr., 914, datë 29.12.2014, si dhe procedurat në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë.

Likuidimi i 16 prej procedurave të realizuara për këtë zë janë bërë nëpërmjet arkës cash, në vlerën totale prej 88,878 lekë.

6-“Shpenzime për Mirëmbajtjen e godinës” është parashikuar si fond limit në masën prej 1,230,000 lekë me TVSH, ndërsa procedura e prokurimit është parashikuar për “blerje me vlerë të vogël”, në kundërshtim me LPP. Ky zë është realizuar në vlerë prej 818,300 lekë. Në realizimin e këtij zëri rezultojnë 5 procedura prokurimi. Nga këto procedura, 4 prej tyre janë kryer nëpërmjet mënyrës shkresore të përzgjedhjes së fituesit, Formulari 2 dhe Formulari 5, në vlerën totale prej 240,300 lekë, të cilat rezultojnë të likuiduara nëpërmjet sistemit bankar dhe vetëm 1 procedurë është realizuar nëpërmjet sistemit elektronik të APP, në vlerën prej 550,000 lekë me Ftesë për Ofertë dhe fitues firmën Alban Kardashi.

Në këto kushte rezulton se AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara sipas VKM nr., 914, datë 29.12.2014, si dhe procedurat në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për

shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë, duke çuar në copëtim të fondit të prokuruar.

Auditimi i lidhjes dhe zbatimit të kontratës deri në marrjen në dorëzim të mallrave

Janë ndjekur procedurat e përpilimit të kontratave për mallra/shërbime/punë. Në përfundim të shërbimit apo dorëzimit të mallit, janë hartuar relacione se shërbimi/malli është në përputhje me kërkesat e Institucionit janë firmosur faturat e furnitorëve nga përfaqësuesi i grupit të marrjes në dorëzim dhe mallrat janë bërë hyrje në magazinë e janë prerë Fletë Hyrjet përkatëse.

Në rastin e shërbimeve të cilat janë të zgjatura në kohë dhe për shërbime që janë të kërkuara specifikisht nga një sektor të ndryshëm (teknik), faturat janë firmosur nga përfaqësues të këtyre sektorëve duke konfirmuar kryerjen e shërbimit. *Për sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr. 6, datë 11.07.2017 dhe Proces verbalit nr.2 datë, 14.07.2017.*

c. Mjedisi i kontrollit dhe vlerësimi i MFK

Nga auditimi i kryer në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i unifikuar, u konstatua se institucioni i AMA nuk zbaton asnjë parim, rregull apo procedurë administrative për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë publike. Me shkresën nr. 12050/1, datë 25.08.2015, “Mbi caktimin e nëpunësit autorizues dhe zbatues të AMA”, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik cakton Nëpunës Autorizues Znj. Alba Qirjazi me detyrë Sekretar i Përgjithshëm dhe Nëpunës Zbatues Znj. Erisa Imerali në funksionin e nëpunësit zbatues. Sipas përcaktimeve në ligj, Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës në zbatim të Ligjit të MFK-së dhe i raporton titullarit të njësisë publike për zbatimin e sistemeve të MFK-së në të gjitha strukturat, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej tij. Nëpunësi autorizues është koordinator për MFK dhe koordinator i riskut.

Për periudhën e audituar, AMA nuk ka ndërtuar një dokument strategjik mbi aktivitetin e institucionit, me vendosjen e objektivave dhe e evidentimin e risqeve për çdo sektor në strukturë. Nuk ka asnjë praktikë të dokumentuar të analizimit dhe azhurnimit që synon minimizimin e riskut të paktën një herë në vit, siç përcaktohet në manualin për MFK.

Nuk ka asnjë rast praktike të dokumentuar të raportimit periodik për përmbushjen e objektivave, sipas manualit për MFK; rrjedhimisht nëpunësi autorizues nuk ka zbatuar detyrimet e përcaktuara në ligjin për MFK.

d. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 849/1, datë 18.10.2013, i miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit është kryer auditimi i institucionit të Autoritetit të Mediave Audiovizive me objekt: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik dhe financiar” për periudhën 01.01.2011 deri në 30.09.2013. Në përfundim të auditimit janë lënë 10 rekomandime për të cilat subjekti me shkresën nr. 275 prot, datë 28.01.2014 “ Mbi masat e marra në zbatim të rekomandimeve e Raportit Përfundimtar të Kontrollit të ushtruar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Autoritetin e Mediave Audiovizive” ka raportuar në KLSH.

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

NR.	GJETJE	REKOMANDIM	ZBATIM
1	Nga auditimi i buxhetit për vitin 2011, 2012 dhe 9/M e vitit 2013 rezultoi se, nga largimin puna të 11 punonjësve janë paguar për një pozicion pune dy persona, nga vendimet e Komisionit të Shërbimit Civil dhe vendimet e gjykatave periudha 01.01.2011 deri më 30.09.2013 likuiduar shuma prej 14,629,828 lekë që ka sjell një efekt negativ financiar për buxhetin e institucionit, për largimet nuk janë zbatuar procedurat, në kundërshtim me Ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999 për "Statusi i Nëpunësit Civil", trajtuar në mënyrë të detajuar në Aneksin A- Mbulimi i Auditimit, faqet 6-7 të Projektraportit të Auditimit.	KKRT të analizojë me përgjegjësi rekrutimin e punonjësve për vitin 2011, 2012, dhe të mos largojë nga puna punonjësit, pa shkaqe të arsyeshme dhe ligjore	<u>Zbatuar</u>
2	Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se: a) Në "Pasiv" grupin B nuk janë pasqyruar detyrimi që ka AMA ndaj tatim taksave në fund të periudhës. Për vitin 2011, arkëtuar nga subjektet taksa 16,081,620 lekë, derdhur për llogari të tatim taksave vlera 15,258,049 lekë diferenca mbetur gjendje 31.12.2011 vlera 823,571 lekë, kjo duhej pasqyruar në llogarinë 432, likuidimi është bërë në vitin pasardhës. Për vitin 2012, arkëtuar nga subjektet taksa 12,284,111 lekë, derdhur për llogari të tatim taksave vlera 10,398,911 lekë diferenca mbetur gjendje 31.12.2011 vlera 1,885,200 lekë, kjo duhej pasqyruar në llogarinë 432 se likuidimi është bërë në vitin pasardhës. b) Dorëzimi i pasqyrave financiare nga operatorët e radiotelevizioneve private sipas nenit 8 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.2008 "Për Radion dhe Televizionin Publik e privat në Republikën e Shqipërisë". Viti 2011 nga 220 operatorë kanë dorëzuar 128 ose 59 %, viti 2012 nga 250 operatorë kanë dorëzuar 103 operatorë ose 41 % e tyre.	Drejtoria ekonomike në mbyllje të pasqyrave financiare të pasqyroje detyrimet e grupit B në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Të zbatohen hapat ligjore, për dorëzimin e bilanceve nga radiotelevizionet privat pranë institucionit.	<u>Zbatuar</u>
3	Nga auditimi i pagesave për raportet mjekësore punonjësve rezultoi se nuk janë mbajtur deri në 14 ditë nuk është mbajtur tatimi mbi të ardhurat sipas ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 8483, datë 28.12.199 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar neni 8 pika b. sipas të cilit të ardhurat që i merr i punësuar për 14 dite e para me raport mjekësor, nuk janë të përjashtuara për qellim të tatimit mbi të ardhurat personale, vlera e pa tatuar është 1,306,830 lekë x 10% tatimi = 130,683 lekë për 24 punonjës.	Nga Drejtoria ekonomike të saktësohet, të kontabilizohet dhe të arkëtohet vlera 130,683 lekë, për 24 punonjësve sipas listës bashkëngjitur.	<u>Zbatuar</u> Urdhër i Kryetarit të AMA nr. 19, datë 28.01.2014
4	Gjatë auditimit të arkës në lekë dhe në valutë, rezulton se arka ka qenë me gjendje më 31.12.2011 dhe 31.12.2012, kjo bie në kundërshtim me udhëzimi nr. 30 datë 27.11.2011 "për menaxhimin e vlera materiale dhe monetare", pra në çdo fund vitit duhet të bëjë derdhje në bankë dhe gjendja e arkës duhet të jetë zero (0).	Drejtoria ekonomike të marrë masat që në fund të vitit ushtrimore, mjetet monetare të dorëzojë në llogaritë bankare, arka të mbetet me gjendjen 0.	<u>Zbatuar</u>
5	Nga verifikimi i vlerave të kaluar me xhirim nëpërmjet bankës, me urdhrat e prokurimit të nxjerrë nga titullari, për blerjeve me vlera të vogla, nuk plotësohet formulari nr. 3, për testimin e tregut, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, kreu VI, pika 2. "Për blerjet me vlera të vogla".	Drejtoria ekonomike mbas daljes së urdhrat të titullarit, për blerjet me vlera të vogla të plotësojë dokumentacionin e saktë e të plotë, duke bërë testimin e tregut dhe plotësimin e formularit 3	<u>Zbatuar</u>

6	Nga auditimi i pagesave rezultoi se, punonjësve është paguar orë pune shtesë mbi kohën normale periudha Janar 2011-30.09.2013, me një vlerë 1,081,568 lekë, të bazuar në vendimit nr. 511 datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen në punë”, por në kundërshtim me vendimin nr. 472 datë 2.07.2011 “Për disiplinimin e fondeve për orët e punës të kryera mbi kohën normale”.	Nga Drejtoria ekonomike të saktësohet, të kontabilizohet dhe të arkëtohet vlera 927,343 lekë, për orët shtesë sipas listës të punonjësve bashkëngjitur.	Zbatuar Urdhër i Kryetarit të AMA nr. 18, datë 28.01.2014
7	Nga auditimi Pagesave për udhëtim e dietave të punonjësve, për shërbimet e kryera jashtë qendrës së punës, brenda vendit, në disa urdhër shërbimet ka mangësi të dokumentacioni shoqërues, në kundërshtim me vendimin nr. 997 datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës”, është paguar padrejtësisht vlera 232,000 lekë për 14 punonjës.	Nga Drejtoria ekonomike të saktësohet, të kontabilizohet dhe të arkëtohet vlera 232,000 lekë, për 14 punonjësve sipas listës bashkëngjitur	Zbatuar Urdhër i Kryetarit të AMA nr. 19, datë 28.01.2014
8	Në fund të vitit 2012 AMA ka dhënë shpërblim punonjësve nga fondi i veçantë me vlerë 1.203.195 lekë, paguar 32 punonjës, pagesa është bërë sipas vendimit nr. 929 date 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, por në kundërshtim me vendimin nr. 849 datë 16.12.2012 ,ku në pikën nr. 9 theksohet “Përjashtimisht për vitin 2012 fondi i veçantë nuk përdoret për shpërblimet e punonjësve.	Nga Drejtoria ekonomike të saktësohet, të kontabilizohet dhe të arkëtohet vlera 1,203,195 lekë, për 32 punonjës sipas listës bashkëngjitur.	Zbatuar Urdhër i Kryetarit të AMA nr. 18, datë 28.01.2014
9	Nga auditimi i lëvizjeve të vlerave materiale dhe monetare rezultoi se, mungon dokumentacioni për 3,949 litra karburant me vlerë 641,273 lekë, që del si diferencë nga krahasimi i dokumentacionit me hyrje dhe daljet nga magazina, në kundërshtim me ligjin nr. 6942, datë 25.12.1984, Udhëzimit nr. 70, datë 11.03.1985 me ndryshime, ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Për këtë shumë rekomandojmë që shuma prej 641,273 lekësh.	KKRT me grup pune në bazë të dokumentacionit të saktësojë vlerën 641,273 lekë, dhe të nxjerrë përgjegjësitë për punonjësit që nuk kanë mbajtur dokumentacionin e duhur, të bëhet kontabilizimi dhe arkëtimi i vlerës.	Zbatuar Urdhër i Kryetarit të AMA nr. 269, datë 10.12.2013; Urdhri nr. 20, datë 28.01.2014
10	Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se, sanksionet e vendosura nga KKRT për shkeljet që kanë dalë nga inspektimet, nuk janë kontabilizuar dhe pasqyruar në bilanc, sanksionet janë vendosur në zbatim të nenit 137 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.2008 “Për Radion dhe Televizionin Publik e privat në Republikën e Shqiptarë”. Për vitin 2011, vlera e gjobave për tu paguar 30,710 mijë lekë nga 71 raste, paguar 6 subjekte vlerën 1,400 mijë lekë ose 5% e totalit mbeten pa arkëtuar 29,310 mijë lekë. Për vitin 2012, vlera për tu paguar 17,880 mijë lekë nga 63 raste, paguar 3 subjekte vlerën 460 mijë lekë, mbeten për arkëtim 17,420 mijë lekë. Totali për dy vite 46,730 mijë lekë, vlera këto të pa regjistruara në pasqyrat financiare. Për arkëtimin e gjobave nuk është zbatuar marrëveshja me marrëveshjen e bashkëpunimi nr. 782 prot, datë 02.12.2010 me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nr. 15290/4 prot. datë 01.12.2010 dhe ka hyrë në fuqi me datën 01.01.2011. Nuk është zbatuar edhe Ligji nr. 10279, date 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” neni 46.	KKRT, Drejtoria ekonomike të analizojë me përgjegjësi gjendjen e debitorëve, të saktësojë vlerën 46,730,000 lekë e detajuar sipas operatorëve dhe mbas saktësismit të bëhet kontabilizimi i tyre, duke marrë hapat ligjore për arkëtimin.	Zbatuar Është kontabilizuar dhe vijon procesi i ekzekutimit të tyre nga shoqëritë private përmbartimore.

Për sa më sipër vlerësohet se për rekomandimet e lëna nga grupi i audituesve të KLSH-së, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 849/1, datë 18.10.2013, subjekti AMA ka marrë masat e duhura që ato të zbatohen.

Gjetje dhe Rekomandime

Gjetje: Nga ana e strukturave të AMA janë kryer kontrole/inspektime për zbatimin e ligjit nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën objekt të ligjit dhe janë vendosur sanksione për rastet e shkeljeve. Subjektet të cilat janë ndëshkuar për shkeljet e konstatuara nga grupet e inspektimit kanë ushtruar të drejtën e ankimit për sanksionin e vendosur. Në përfundim të procesit të ankimit AMA është shprehur për shfuqizimin e sanksionit me gjobë në masën 63.9% të numrit të përgjithshëm të sanksioneve të aplikuara dhe në masën 60.4% të vlerës totale të gjobave të vendosura.

Gjatë auditimi u vërejt gjithashtu se në rregulloren e AMA-s nuk kryetere të cilat të përcaktonin mënyrën dhe arsyet e faljes së gjobave të vëna ndaj shkelësve të ligjit 97/2013.

AMA referuar germës “ç”, pika 2, neni 14 të ligjit 97/2013 “Për mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” ka detyrim raportimin në Kuvendin e Shqipërisë të veprimtarisë së saj vjetore. Nga auditimi u vërejt se në asnjë prej viteve 2014, 2015 dhe 2016, AMA nuk ka përfshirë në raportin e veprimtarisë së saj, drejtuar Kuvendit, problematikën e faljes së gjobave ndaj subjekteve të cilët konsiderohen shkelës të ligjit në fushën e mediave audiovizive.

Rekomandimi: Autoriteti i Mediave Audiovizive të marrë masat të menjëhershme për të ndryshuar Rregulloren e Autoritetit të Mediave Audiovizive duke shtuar në të një nen të veçantë për mënyrën dhe kriteret që bëjnë të mundur shfuqizimin e sanksioneve (gjobave) të vëna ndaj subjekteve shkelës të ligjit të mediave audiovizive, për të shmangur mundësinë e abuzimit apo të korrupsionit

Menjëherë

Rekomandimi: Autoriteti i Mediave Audiovizive të përshijë në raportin e saj vjetor drejtuar Kuvendit të Shqipërisë problematikën e faljes së gjobave ndaj subjekteve të cilët konsiderohen shkelës të ligjit në fushën e mediave audiovizive, dhe të reflektojë rekomandimet përkatëse.

Menjëherë

Gjetje: Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” me vendimin nr. 231, datë 03.11.2016 ka shpallur hapjen e garës për dhënien e 2 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik për rrjetet numerike të identifikuar me nr. 006 K dhe nr. 007 K. Konstatuam se pranë AMA-s janë depozituar 5 aplikime dhe konkretisht:

6. Shoqëria “Tring TV” sh.a. aplikimi nr. 3771 prot., datë 15.12.2016, për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.
7. Shoqëria “ABC News” sh.a., aplikimi nr. 3774, prot., datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.
8. Shoqëria «Media Vizion» sh.a., aplikimi nr. 3772 prot., datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.
9. Shoqëria “Ora” sh.a., aplikimi nr. 3775, datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare transmetimi audioviziv.

10. Shoqëria “ADTN” sh.a., aplikimi nr. 3773 prot., datë 15.12.2016 për marrje licence kombëtare të transmetimit audioviziv.

Komisionin e Shqyrtimit të Dokumentacionit (KSHD) i ngritur me urdhrin nr. 172, datë 12.12.2016, në vijim të shqyrtimit të dokumentacionit të aplikimit të subjekteve të mësipërme dhe përgatitjes së relacioneve vlerësuese për përmbushjen e kriterëve ligjore, ekonomike, organizative, teknike e programore, të përcaktuara në Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” ka dalë në përfundimet e mëposhtme:

- Aplikimi i shoqërisë “Tring TV” sh.a. bie ndesh me dispozitat e nenit 62, pika 1 ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nenit 9 të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”. Bazuar sa më sipër, AMA, me vendimin nr. 285, datë 29.12.2016, vendosi skualifikimin e shoqërisë “Tring TV” sh.a., dhe mosdhënien e licencës kombëtare private audiovizive.
- Aplikimi i shoqërisë “ABC News” sh.a., nuk ishte në përputhje me kërkesat e nenit 18, pika 1, nënpika 1.1., germa “c” të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”. Për këto arsye, AMA, me vendimin nr. 284, datë 29.12.2016, vendosi skualifikimin e shoqërisë “ABC News” sh.a., dhe mosdhënien e licencës kombëtare private audiovizive.
- Aplikimi i shoqërisë “Media Vizion” sh.a., ishte në përputhje me kriteret e ligjit nr. 97/2013 dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”, prandaj AMA me vendimin nr. 287, datë 29.12.2016, vendosi dhënien e licencës kombëtare private të transmetimit audioviziv shoqërisë “Media Vizion” sh.a.
- Aplikimi i shoqërisë “Ora” sh.a., nuk ishte në përputhje me kërkesat e nenit 18, pika 1, nënpika 1.4., germa “f” të rregullores “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”. Për sa më sipër, AMA me vendimin nr. 283, datë 29.12.2016, vendosi skualifikimin e shoqërisë “ORA” sh.a.

Nga shqyrtimi i dosjes së paraqitur nga subjekti “ORA” sh.a., ankimuar edhe në KLSH me shkresën nr. 58. prot. datë 12.01.2017, rezultoi se vendimi i AMA për skualifikimin nga gara të subjektit “ORA” sh.a. është jo plotësisht i përligjur, pasi subjekti ka paraqitur në AMA një numër prej 8 (tetë) dokumentesh. Rregullorja e miratuar me Vendimin e AMA nr. 219, datë 12.10.2016, neni 18, pika 1.4, germa “f” shprehet: “*Depozitimi i kontratave ose marrëveshjeve paraprake me mbajtësit e të drejtave të përmbajtjes që do të transmetohen dhe ritransmetohen*” pra, nuk shprehet për një numër minimal kontratash. Ky fakt provon pretendimin e paraqitur nga ky subjekt në ankesën depozituar pranë KLSH.

- Aplikimi i shoqërisë “ADTN” sh.a., ishte në përputhje me kriteret e ligjit nr. 97/2013 dhe rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv”. Vendimi Nr. 286, datë 29.12.2016 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë ‘ADTN’ sh.a., për licencë kombëtare private transmetimi audioviziv” ka rezultuar me mosdhënien e licencës kombëtare të transmetimit audioviziv, shoqërisë “ADTN” sh.a., për shkak të mungesës të kuorumit të nevojshëm ligjor për lëshimin e licencës, germa “b”, pika 1, neni 19 i ligjit 97/2013.

Nga shqyrtimi i dosjes së paraqitur nga subjekti aplikues rezultoi se vendimi për kualifikim të operatorit është marrë në kundërshtim me nenin 62/4 të ligjit 97/2013 i cili shprehet se: “Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale”. Është në kundërshtim edhe me nenin 9/2,3,4, të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” ku shprehet se: “ Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri janë nominativë. 3. Në kuptim të këtij neni aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë. Për sa më sipër nuk është zbatuar pika 9/9 e rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” ku thuhet se: “Mos respektimi i kërkesave sipas këtij neni është kusht për skualifikim”. KSHD duhet të kishte propozuar skualifikimin e subjektit “ADTN” sh.a.

Pas marrjes së njoftimit për vendimin nr. 286, datë 29.12.2016 të AMA, shoqëria “ADTN” sh.a. ka depozituar pranë AMA kërkesën me nr. 3922/1 prot., datë 06.01.2017 për revokim të vendimit nr. 286, datë 29.12.2016, me arsyetimin se: “Vendimi është nxjerrë në kundërshtim me ligjin për mediat dhe procedurat ligjore të parashikuara në ligji nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Në mbledhjen e datës 19.01.2017 AMA ka marrë në shqyrtim ankesën e subjektit të interesuar dhe pas anulimit të vendimit nr. 286, datë 29.12.2016 ka proceduar me zhvillimin e votimit të aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a. bazuar në ligjin 97/2013 dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”. Në votimin e parë mbi shqyrtimin e aplikimit të kërkesës shoqërisë “ADTN” sh.a., rezultati i votimit ishte 4 anëtarë pro dhënies së licencës subjektit dhe 3 anëtarë kundër këtij aplikimi, duke mos arritur kuorumin e shumicës së cilësuar për vendimmarrje. Në votimin e dytë lidhur me aplikimin e shoqërisë “ADTN” sh.a., u arrit i njëjti rezultat si në votimin e parë, 4 anëtarë votuan pro dhënies së licencës subjektit dhe 3 anëtarë votuan kundër këtij aplikimi, edhe në këtë votim nuk u arrit kuorumi i shumicës së cilësuar për vendimmarrje. Pas këtij rezultati vendimmarrja u shty për mbledhjen e radhës, atë të datës 27.01.2017. Në mbledhjen e zhvilluar në datën 27.01.2017 vijoi zhvillimi i procedurës vendimmarrëse lidhur me aplikimin e shoqërisë “ADTN” sh.a., gjatë të cilës rezultoi se 4 anëtarë ishin pro dhënies së licencës subjektit shoqërisë “ADTN” sh.a., dhe 3 anëtarë ishin kundër këtij aplikimi.

Në përfundim, në bazuar në: nenin 19, pika 16, nenin 13 pika 5 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenet 113, 114, 117 dhe 136 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, dhe nenit 14 paragrafi 2 i ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” AMA vendosi: Pranimin e kërkesës së subjektit, shoqërisë “ADTN” sh.a., dhe anulimin e vendimit të AMA-s, nr. 286, datë 29.12.2016 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a., për licencë kombëtare private transmetimi audioviziv”, duke vendosur: Dhënien e licencës kombëtare private të transmetimit audioviziv, shoqërisë “ADTN” sh.a., për një periudhë prej 15 vjetësh...

Nga auditimi është arritur në konkluzionin se

- d. Komisionin e Shqyrtimit të Dokumentacionit ka përdorur dy standarde gjatë procedurës së vlerësimit të aplikimeve të bëra nga subjektet konkurruese për garën e dhënien së 2 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik.
- e. Procedura e votimit e ndjekur nga AMA në rastin e vendimit Nr. 5, datë 27.01.2017 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ADTN” sh.a. për revokim të vendimit nr. 286, datë 29.12.2016 të AMA-s “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a., për licencë kombëtare transmetimi audioviziv”, shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a., për licencë kombëtare të transmetimit audioviziv për shoqërinë “ADTN” sh.a. dhe dhënien e licencës private kombëtare të transmetimit audioviziv shoqërisë “ADTN” sh.a.”, është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore.
- f. AMA duke licencuar shoqërinë “ADTN” sh.a. nuk ka ushtruar një prej funksioneve bazë të saj, garantimin e konkurrencës së ndershme, në kundërshtim me nenin 62/4 të ligjit 97/2013 i cili shprehet se : *“4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20 për qind të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audio ose licencë kombëtare të transmetimit audioviziv. Për transmetimet analoge audio lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10 për qind në një shoqëri të tretë kombëtare. Një person i tillë nuk lejohet të marrë licencë transmetimi audio, lokale apo rajonale ose licencë transmetimi audioviziv, lokale apo rajonale”. Gjithashtu, në kundërshtim edhe me nenin 9/2,3,4, të rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencës kombëtare të transmetimit audioviziv dhe licencës kombëtare të shërbimit të programit audioviziv” ku shprehet se: “2. Aksionet që përfaqësojnë kapitalin në një shoqëri janë nominativë. 3. Në kuptim të këtij neni aksionar konsiderohet mbajtësi i aksioneve dhe personat e lidhur me të deri në shkallën e dytë. 4. Një person fizik ose juridik, që ka aksione në një shoqëri që disponon një licencë kombëtare transmetimi audioviziv, nuk mund të ketë më shumë se 20% të kapitalit të përgjithshëm në një shoqëri të dytë, që zotëron një licencë kombëtare transmetimi audioviziv. Për transmetimet analoge lejohet pjesëmarrja në masën deri në 10% në një shoqëri të tretë kombëtare”. Duke marrë në konsideratë pronësitë e ndërthurura (cross-ownership) të shoqërisë “Digit-Alb” sh.a., e cila është aksionare me 100% të aksioneve të shoqërisë “ADTN” sh.a., dhënia e licencës së tretë kombëtare e transmetimit audioviziv për këtë operator rrit përqendrimin në këtë treg.*

Rekomandimi: Nisur nga konstatimi se janë mbajtur dy standarde të ndryshme gjykimi dhe vlerësimi për operatorët që duhet të përfitonin licencë kombëtare të transmetimit audioviziv dhe për shkak të rritjes së përqendrimit në këtë treg duke përzgjedhur operatorin “ADTN” sh.a., AMA të rishqyrtojë Vendimin nr. 5, datë 27.01.2017 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “ADTN” sh.a., për licencë kombëtare private transmetimi audioviziv”, duke marrë parapakisht mendimin e Autoritetit të Konkurrencës.

Menjëherë

Rekomandimi: Në çdo rast të dhënies së licencave vendimi të shoqërohet me marrjen e një miratimi paraprak nga Autoriteti i Konkurrencës për të garantuar konkurrencën së ndershme dhe pluralizmin e këtij tregu me ndikim të konsiderueshëm në opinion publik.

Menjëherë

Gjetje: Nga auditimi i llogarive për periudhën objekt auditimi, për nxjerrjen e bilancit kontabël u konstatua se: Çelja e llogarive të vitit 2015 nuk është bërë e saktë për 12 zëra të bilancit pasi janë evidentuar mospërputhje me tepricën në fund të vitit 2014 të llogarive respektive konkretisht :

Në Aktivin e Bilancit nuk është bërë çelja e saktë për grupet, klasat dhe llogaritë :

- Aktive të Qëndrueshme : Çelja e vitit 2015 është bërë më pak se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 1,470,099 lekë. Kjo diferencë i përket llogarisë 232 Shpenzime në Proces për Transferime Kapitale për shumën 1,470,099 lekë.
- Aktive Qarkulluese : Çelja e vitit 2015 është bërë më pak se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 60,267,123 lekë.

Sipas llogarive rezultojnë : *Llogaria 411-418 " Klientë e Llogari të Ngjashme " me diferencë më shumë për shumën 205,110,291 lekë; Llogaria 423-429 " Personeli, Paradhënie, Deficite e Gjoha " me diferencë më pak për shumën 196,361,332 lekë; Llogaria 431 " Të Drejta e Taksa për tu Derdhur në Shtet " me diferencë më pak për shumën 8,744,159 lekë; Llogaria 435 " Sigurime Shoqërore " me diferencë më shumë për shumën 70,671 lekë; Llogaria 436 " Sigurime Shëndetësore " me diferencë më shumë për shumën 3,532 lekë; Llogaria 437,438 " Organizma të tjera Shoqërore " me diferencë më shumë për shumën 123,686 lekë; Llogaria 468 " Debitorë të Ndryshëm " me diferencë më pak për shumën 60,469,812 lekë.*

Në Pasivin e Bilancit nuk është bërë çelja e saktë për grupet, klasat dhe llogaritë :

- Fondet e Veta : Çelja e vitit 2015 është bërë më pak se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 195,262,136 lekë. Kjo diferencë i përket llogarisë 101 "Fondet Bazë " .
- Detyrime : Çelja e vitit 2015 është bërë më shumë se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 165,310,932 lekë.

Sipas llogarive rezultojnë : *Llogaria 431 " Detyrime ndaj Shtetit për Tatim-Taksa " me diferencë më pak për shumën 1,792,900 lekë; Llogaria 4341 " Të tjera Operacione me Shtetin (kreditor) " me diferencë më shumë për shumën 167,103,832 lekë.*

Rezultati i Ushtrimit (Saldo Kreditorë) : Çelja e vitit 2015 është bërë më pak se teprica në fund të vitit 2014 për shumën 31,786,018 lekë.

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.468, datë 03.06.2015 ka kaluar në përgjegjësi administrimi nga Radio Televizioni Shqiptar tek Autoriteti i Mediave Audiovizive objektin me emërtimin Atelier për Dekorin e Radio Televizionit në zonën kadastrale 8160 me numër pasurie 2/94 me sipërfaqe totale 10177 m2 me sipërfaqe ndërtese 6202 m2. Në këtë vendim nuk është përcaktuar vlera e aseteve të transferuara. Nga ana e AMA-s janë kryer riparime dhe janë përfshirë në Aktivitet e Qëndrueshme të Trupëzuara të vitit 2016, vetëm vlera e situacioneve të likuiduara për shumën 34,899,242 lekë dhe nuk është përfshirë vlera tjetër e objektit sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave. Veprimi i mësipërm shtrembëron vlerën e aktiveve të Institucionit si edhe të shpenzimeve të amortizimit, që duhen llogaritur për këtë aktiv.

Rekomandimi: Për të gjitha shumat sipas zërave e llogarive përkatëse që në Bilancin e vitit 2015 nuk janë çelur saktë sipas tepricës në fund të vitit 2014 të përgatitet dokumentacioni justifikues ligjor ku të përshkruhen me vërtetësi e saktësi veprimet, treguesit në vlerë dhe personat urdhërues e zbatues dhe zbatues dhe të kryhen veprimet përkatëse në kontabilitet.

Brenda datës 30.11.2017

Rekomandimi: Të meren masa të menjëhershme për transferimin me dokumentacion të aseteve sipas VKM Nr.468, datë 03.06.2015 duke përcaktuar vlerën e objektit, vlerën e amortizimit dhe regjistrimin e tyre në kontabilitet.

Menjëherë

Gjetje: Nuk janë evidentuar si Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët (Llogaria 411 “ Klientë) detyrimet e lindura, e të papaguara për 5 subjekte, të cilave nga AMA ju është hequr Licenca, për vitin 2015, në shumën 10,405,000 lekë. Për veprimet e mësipërme nuk u paraqitën dokumentacion justifikues, argumente e sqarime të detajuara për secilin ndryshim dhe as veprimet kontabile të kryera për këta ndryshime. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” me ndryshimet neni 6 dhe neni 10 Si dhe në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30 datë 27.12.2011 “ Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësinë e Sektorit Publik ” Dokumentimi i Lëvizjes së Aktiveve pika 34 dhe pika 36 .

Gjatë vitit 2016 janë ulur si Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët për 22 subjekte të cilëve ju janë hequr licencat apo autorizimet për shumën 37,766,545 lekë. Për këtë janë rënduar shpenzimet e vitit 2016 dhe kjo shumë është evidentuar në Aktivin e Bilancit me minus tek llogaria 49 “ Shuma të parashikuara për zhvlerësim “ duke ulur në këtë mënyrë për këtë shumë edhe Klasën 4 “Kërkesa Arkëtimi për Debitorët “. Për veprimet e mësipërme nuk u paraqitën dokumentacion justifikues , argumente ligjore e shënime shpjeguese të detajuara për secilin subjekt por vetëm pretendime se detyrimet e këtyre subjekteve janë të pamundura për tu arkëtuar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare për institucionet qendrore organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njësitë të menaxhim/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorë të huaj” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 26, datë 27.12.2007.

Rekomandimi: Për shumën 10,405,000 lekë të pa mbartur si Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët (Llogaria 411 “ Klientë) për subjektet të cilave nga AMA ju është hequr Licenca, për vitin 2015 të evidentohen sipas subjekteve detyrimet përkatëse në kontabilitet dhe të meren masat ligjore për arkëtimin e detyrimeve.

Brenda datës 30.11.2017

Rekomandimi: Për shumën 37,766,545 lekë të ulur si Kërkesa Arkëtimi mbi Debitorët të regjistruara si shuma të parashikuara për zhvlerësim për vitin 2016 të argumentohen me dokumente justifikuese ligjore dhe të meren masat ligjore për arkëtimin e detyrimeve.

Brenda datës 30.11.2017

Gjetje: Nga auditimi është konstatuar se nëpërmjet arkës gjatë periudhës së audituar janë kryer arkëtime nga subjekte të ndryshme në shuma të konsiderueshme si dhe janë kryer pagesa të ndryshme për blerjeve të kryera me Procedurë Prokurimi me Vlera të Vogla, shërbime të ndryshme, shpenzime telefonike, shpenzime udhëtim e dieta, etj. Sigurimi fizik i arkës nuk i plotëson kushtet e nevojshme. Nëpërmjet arkës janë kryer këmbime monetare në vlera të konsiderueshme në euro, veprime që bien në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “ Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Rekomandimi: Në çdo rast që për arsye emergjencash kërkohen likuiditete të ndryshme nga ai i përcaktuar prej MF të ketë dokumentacion shkresor në formën e lejes së marrë nga MF.

Veprimet si arkëtimet dhe pagesat për shumat mbi limitin ligjor të përcaktuar të arkës të kryhen nëpërmjet bankës. Veprimet në Euro të kryhen nëpërmjet llogarisë bankare në Euro.

Në vazhdimësi

Gjetje: Komisioni i përlllogaritjes së shpenzimeve të karburantit në AMA, për vitet 2014 dhe 2015, në kronometrimin e km të përshkruara dhe karburantin e harxhuar për to nuk ka bërë kronometrim për lëvizjet urbane, por është mjaftuar me kronometrimin vetëm për km e përshkruara për lëvizjet interurbane, gjë që ka sjellë llogaritje fiktive dhe jo korrekte të karburantit. Në disa raste daljet e karburantit nga magazina, nuk përputhen në datë me dokumentin “kërkesë për shërbim” dhe “urdhër dorëzimit” si dhe për asnjë rast nuk janë mbajtur akt rakordime ndërmjet magazinës dhe financës për harxhimin e karburantit. Nga drejtuesit e automjeteve në të gjitha rastet Fletë udhëtimet nuk ishin plotësuar në mënyrë korrekte për udhëtimet brenda qytetit por edhe për udhëtimet jashtë qytetit, ato plotësoheshin vetëm me firmën e shoferit, pa u vërtetuar me firmën e personit për të cilin është kryer shërbimi si dhe pa përcaktuar km e përshkruara, por mjaftoheshin duke përcaktuar vetëm vend nisjen dhe vend mbërritjen. Ky veprim le shteg për mos efikasitet në kontrollin e harxhimit të karburantit.

Rekomandimi: Nga ana e financës të mbahen aktrakordime të përmuajshme me magazinën, për fletëdaljet e karburantit dhe përputhshmërinë e tyre me “urdhërat e dorëzimit” për të bërë të mundur kontrollin me efektivitet të karburantit. Komisionet e ngritura për kronometrimin e harxhimit të karburantit për km e përshkruara si dhe drejtuesit të bëjnë kronometrimin e harxhimit të karburantit si për lëvizjet urbane dhe ato interurbane. Në të gjitha rastet fletë udhëtimet të plotësohen për km e përshkruar dhe në përfundim të shërbimit të firmosen nga drejtuesi i automjetit dhe nga personat që kryejnë shërbimin me këtë automjet.

Menjëherë

Gjetje: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga zj. Eriona Rusmali me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Erjona Fishta me detyrë jurist, z. Rais Petrela me detyrë arkitekt (i jashtëm) në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” ka kualifikuar/shpallur padrejtësisht fitues BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. me parregullsi në dokumentacionin ligjor kualifikues si më poshtë:

i. BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. nuk ka përcaktuar në ofertë pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Në kundërshtim me nenin 74 të VKM nr. 914, datë 29.12.2016 “Për rregullat e prokurimit publik” në të cilin është përcaktuar se ...Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të notërizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen

në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi. Në nenin 3 të kontratës së bashkëpunimit datë 10.2.2016 të noteruar lidhur midis palëve është përcaktuar shoqëria “AVE Consulting” sh.p.k. do të ketë 7 për qind të fitimit dhe të pjesëmarrjes, shoqëria “D & C partners” sh.p.k. do të ketë 30 për qind të fitimit dhe pjesëmarrjes. Nga sa më sipër konstatohet që në kontratën e bashkëpunimit palët (OE) nuk janë shprehur për pjesën e shërbimit, punës ... elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi.

ii. OE “D & C Partners” sh.p.k. nuk ka shlyer detyrimet e energjisë elektrike për muajin janar, shkurt 2016, në kundërshtim me germen 2b të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” në zbatim të VKM nr. 379, datë 11.6.2014 shtesa të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik.

iii. Kontratat e punës të lidhura midis OE “AVE Consulting” sh.p.k. dhe punonjësve që parashikohen të kryejnë punën objekt prokurimi, nuk kanë vlerë pasi nuk janë të noteruara dhe personat nuk janë të përfshirë në listë pagesat e shoqërisë.

Sa më sipër në kundërshtim me pikën 4 të pikës 2 të “Kriteret e veçanta të Kualifikimit” të shtojcës 9 të DST në të cilën ndër të tjera është përcaktuar se ... OE duhet të ketë një numër mesatar punonjësish të siguruar prej minimum 10. Për të vërtetuar këtë OE duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave, Për periudhën janar – dhjetor 2015, ... i shoqëruar me listë pagesë... Gjithashtu të gjithë drejtuesit teknikë duhet të jenë përfshirë në këto lista. Në projektet e ndryshme të zbatimit si elektrik, hidraulik etj, gjenden e 12 personave që mbulojnë shërbimin me kategoritë e punimeve që kanë në licencë, por në asnjë rast nuk është firma e tyre për projektin përkatës, psh për projektin elektrik të jenë firmat e dy inxhinierëve elektrikë të OE, Hysen Gjoka (AVE Consulting sh.p.k.) dhe Majlinda Mema (D&C Partners sh.p.k.). Në projekt zbatimin të dorëzuar (arkitektura fleta A4-01, A3-04, A3-03, A3-02, A3-01 etj, ka firmosur zj. Anila Katundi, e cila nuk gjendet në stafin, listë pagesat apo personelin e afruar nga OE të BOE. Me parregullsitë e konstatuara, KVO duhet të skualifikonte BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. Me skualifikimin e tij, fitues rezulton “AA & E Engineering me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj ofertës ekonomike të BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners”, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik.

Rekomandimi: Komisionit të vlerësimit të ofertave i përbërë nga zj. Eriona Rusmali me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Erjona Fishta me detyrë jurist, z. Rais Petrela me detyrë arkitekt (i jashtëm) të zhdëmtojnë vlerën **389,000 lekë**, ose nga 129,667 lekë/secili, pasi në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA” ka kualifikuar/shpallur padrejtësisht fitues BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. Me skualifikimin e tij, fitues do të rezultonte OE “AA & E Engineering” sh.p.k. me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj ofertës ekonomike të BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners”.

Menjëherë

Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të kontabilizojë dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Gjetje: Lidhur me “Saktësinë e llogaritjes së fondit limit” në tenderin me objekt “Hartimi i projektpreventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA”, me numër reference 22631, i zhvilluar në vitin 2016 me fond limit të llogaritur 49,999,949 lekë, i paraqitur/hartuar nga BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. me z. Arben Dervishi drejtues ligjor dhe teknik (AVE) dhe OE “D & C partners” me z. Edison Drishti drejtues ligjor/teknik dhe Vasillaq Shkurti drejtues teknik. Pasaktësi të konstatuara:

i. Në preventiv, në pjesën A-1 me numër/emërtim “Punime prishje...”: A-1.1. është përfshirë dhe zëri i punimeve “Ngritje, mobilim, mirëmbajtje ...” me analizë An me vlerë 236,078 lekë (187,364 x 1,05 fondi rezervë x 1.2 TVSH). A-1.2. është përfshirë dhe zëri i punimeve “Rrethim I përkohshëm me rrjetë teli” me vlerë 270,270 lekë (214,500 x 1,05 fondi rezervë x 1.2 TVSH). Përfshirja si zëra punimi me vete në preventiv/situacion i sa më sipër është në kundërshtim me germën B/3 të “Shpenzimet e përgjithshme dhe fitimi” të UKM nr. 2, datë 8.5.2003 në të cilën është përcaktuar se në shpenzimet e përgjithshme përfshihen Shpenzimet për masat e sigurimit teknik, rrethimet e përkohshme gjatë ndërtimit në lartësi, **skelat**, makineritë, tabelat sinjalizuese etj. Në zbatimin e punimeve të “Rikonstruksionit të godinës...” në preventivin fitues dhe në situacionin e punimeve për zërat e punimeve sipas A-1.1. dhe A-1.2 BOE “Mela” sh.p.k. & “Curri sh.p.k. zbatuese e punimeve të tenderit, i janë likuiduar respektivisht **50,000 lekë** dhe **160,750 lekë**, ose 210,000 lekë gjithsej, të cilat nën arsyetimin e mësipërm janë përfituar padrejtësisht nga OE “Mela” sh.p.k. dhe përbëjnë **dëm ekonomik**.

ii. **Pasaktësi e konstatuar:** Në strukturën e kostos, në preventivin e hartuar/dorëzuar nga BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k., midis zërave të punimeve është përfshirë vlera e pajisjeve me TVSH përkatëse, në kundërshtim me germën A/7 paragrafi i fundit i UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, e cila përcakton se në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat, si më poshtë: Në preventiv, në pjesën “Instalime hidro sanitare” zëri I punimeve me analizë 10, me emërtim “FV grup presioni I ujit të pijshëm ...” një copë me vlerë 314,000 lekë, e cila duhet të ishte vendosur/shtuar në fund të preventivit (pa u vlerësuar me TVSH). Në preventivin fitues të “Rikonstruksionit të godinës...” dhe në situacionin e punimeve të paraqitur nga BOE “Mela” sh.p.k. & “Curri sh.p.k. zbatuese e punimeve të tenderit, vlera e kësaj pajisje në preventivin fitues është 267,044 lekë, e cila është rritur me fondin rezervë prej 13,352 leke (I parashikuar në masën 5 për qind) dhe vlerën e TVSH prej 53,408 lekë, që përfaqëson pagesë/përfitim të padrejtë nga OE “Mela” sh.p.k., dhe nën këtë arsyetim është dëm ekonomik. I njëjti arsyetim për:- zërin e punimeve me numër rendor E2-4 “Analizë” “FV Detektor optik tymi me vetadresim të kompletuar me baza” të kapitullit E “Instalimi, sistemi I sinjalizimit kundra zjarrit” 46 copë me vlerë 257,600 lekë. Vlera e shtuar padrejtësisht është 66,896 lekë (nga e cila fondi rezervë 12,800 lekë dhe TVSH 54,096 lekë), e cila përbën dëm ekonomik.- zërin e punimeve me numër rendor Z-2.1 “Analizë” “FV Panel komandimi I impiantit të MKZ për një zonë detektimi dhe shuarje të zjarrit” të kapitullit Z-2 “Impianti I mbrojtjes nga zjarri – Arkiva” 1 copë me vlerë 85,000 lekë. Vlera e shtuar padrejtësisht është 22,100 lekë (nga e cila fondi rezervë 4,250 lekë dhe TVSH 17,850 lekë), e cila përbën dëm ekonomik. Gjithsej shuma dëm ekonomik (sipas pikës 2) është **366,504 lekë**.

Rekomandimi: BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. t’i kërkohet të zhdëmtojë **vlerën 366,504 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e TVSH, fondit rezervë etj, të pajisjeve të përfshira padrejtësisht në zërat e punimeve të preventivit gjatë llogaritjes së fondit limit në

tenderin me objekt "Hartimi i projekt-preventivit të zbatimit për rikonstruksionin e godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA".

Menjëherë

Rekomandimi: Autoriteti kontraktor të kontabilizojë dhe të ndjekë në rrugë ligjore arkëtimin e tij, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

Gjetje: Nga auditimi i fletë udhëtimeve që na u vunë në dispozicion dhe fletë daljeve të magazinës në disa muaj u konstatuan diferencë në karburant: Për vitin 2015 në sasi prej 935 litra karburant në vlerë 162,253 lekë, (dalje 6,458 dhe harxhuar sipas fletë udhëtimeve 5,523). Për vitin 2016 në sasi prej 460 litrash në vlerë 86,605 lekë (1,370 sipas fletë udhëtimeve dhe duke i krahasuar me daljet nga magazina për një sasi prej 1,830). Për dy vitet 2015,2016 diferencat në karburant prej 1,395 litra nga të cilat 945 lira benzinë dhe 450 litra naftë me vlerë prej 248,858 lekë.

Rekomandimi: Të mbahet vlera prej 248,858 lekë për 1,395 litra karburant, diferencë nga krahasimi i dokumentacionit të fletë udhëtimeve me daljet nga magazine, personave përgjegjës të cilët në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 të menaxhimit financiar dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, nuk kanë kryer akt rakordimet për monitorimin e harxhimit të karburantit duke çuar në mos përdorim korrekt të sasisë së karburantit nga drejtuesit automjeteve që dispononin.

Menjëherë

Gjetje: AMA në të gjitha rastet e shfuqizimit të sanksioneve me gjobë, të vendosura nga grupet e inspektimit, ka marrë në konsideratë pretendimet dhe argumentet e paraqitura nga ana e subjekteve ankimes dhe ka rrëzuar faktet e paraqitura nga grupet e inspektimit, të cilat kanë qenë të bazuara në kuadrin ligjor, rregullator të fushës, në fuqi. Pra, AMA ka favorizuar subjektet shkelës të ligjit të përfitojnë në mënyrë të padrejtë, duke i sjellë të ardhura të munguara buxhetit të shtetit në vlerën 99,552,000lekë (124,440,000 vlera totale e gjobave të shfuqizuara, 80% e vlerës së gjobës shkon në buxhetin e shteti dhe 20% e saj shkon në buxhetin e AMA).

Gjetje. Nga auditimi i procedurave të prokurimeve me blerje të vogla, në institucionin e AMA-s, rezultoi se: Referuar regjistrimit të parashikimit të viteve buxhetor 2015 dhe 2016, AMA ka kaluar fondin e parashikuar për tu realizuar në disa nga objektet e tenderimit në zërin (602), duke mos reflektuar ndryshimin në regjistrin e prokurimit në APP, pas hyrjes në fuqi të Udhëzimit numër 3, datë 27.01.2015. Nga auditimi i ushtruar mbi realizimin e prokurimeve me vlerë të vogël në Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA) u konstatua se, në procedurat e prokurimit "Blerje me vlerë të vogël" për vitet 2014, 2015 dhe 2016, ka mangësi dhe parregullsi gjatë realizimit të këtyre procedurave të cilat binin ndesh me ligjin e prokurimit publik. Në shumë raste nuk bëhet përllogaritje e fondit limit nga komisioni i caktuar me urdhrin e titullarit, por fondi limit përcaktohet apriori ose duke marrë parasysh parashikimin e bërë në projekt buxhet, në kundërshtim bazën ligjore të Prokurimit Publik dhe të ligjit nr. 10296 "për menaxhimin e financiar dhe kontrollit". Në 12 raste për prokurimet e blerjeve me vlera të vogla për vitin 2015 dhe 2016 nuk janë kryer procedurat online të prokurimit publik, por realizoheshin disa procedura në mënyrë shkresore, të pajustificuara, në kundërshtim me pikën 5 dhe 8 të Udhëzimit Nr. 3, datë, 27.01.2015 "Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël". "Për Procedurën e Prokurimit

me Vlerë të Vogël”, i ndryshuar, ku citohet “Kur vlera e përlogaritur për mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit kryesor, brenda vitit kalendarik nuk është më e madhe se 100.000 (njëqind mijë) lekë autoriteti kontraktor mund të kryejë prokurimin në rrugë shkresore sipas formularit Nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi.”, pasi vlera për blerjen e këtij grup mallrash kalon vlerën e 100,000 lekë, për gjithë vitin. Nga Autoriteti kontraktor procedurat e nisura në mënyrë shkresore, bëheshin me urdhra të dala nga titullari sipas formularit 5 në kundërshtim me pikën të Udhëzimit Nr. 3, datë, 27.01.2015 “Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël”, pasi këto lloj procedurash një pjesë është realizuar në mënyrë shkresore me formularin 2 dhe më vonë me atë të formularit nr. 5. Në këto kushte, AMA ka shmangur procedurat e përcaktuara në udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015, për rastet e nevojave për shërbimeve, mallrave dhe punë, me vlerë nën 800,000 lekë, duke shkaktuar copëtim të fondit të parashikuar për prokurim publik dhe duke shmangur dhe anashkaluar procedurat online të Prokurimit Publik. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike sipas Udhëzimit Nr. 3, datë, 27.01.2015 “Për procedurën e Prokurimit me vlerë të vogël” dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalin nr. 2, për të cilin nuk është paraqitur asnjë observacion nga subjekti, e paraqitur në Raportin përfundimtar të auditimit.

Rekomandimi: Mbështetur në nenet 13, 40 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore) për znj. Alba Qirjazi me detyrë Sekretare e Përgjithshme në AMA.

Menjëherë

Gjetje: Gjatë auditimit u konstatua mosrespektimi i kuadrit ligjor që rregullon përfshirjen e pronësive të ndërthurura (cross ownership) gjatë procedurës dhe vendimmarrjes së dhënies së një licence kombëtare të transmetimit audioviziv numerik.

Rekomandim: Duke marrë në konsideratë ndjeshmërinë e tregut të transmetimeve audiovizive për pluralizmin e mendimit dhe efektet negative të rritjes së përqendrimit në treg të shkaktuar nga vendimmarrja e AMA-së, Kontrolli i Lartë i Shtetit i rekomandon Autoritetit të Konkurrencës të vlerësojë dhe të shprehet në lidhje me ndryshimet e strukturës së tregut të shkaktuar nga vendimmarrja e AMA, Vendimit Nr. 5, datë 27.01.2017, sipas të cilit është lëshuar licenca kombëtare private e transmetimit audioviziv.

Menjëherë

Gjetje: Gjatë auditimit u konstatua se nuk ekziston dosja me dokumentacionin përkatës të Kryetarit të AMA si dhe nuk ka dokument të deklaratimit të konfliktit të interesave në momentin e marrjes së detyrës nga ana e tij. Grupi i auditimit u vu në pamundësi të vlerësimit të përputhshmërisë me ligjin të zgjedhjes së Kryetarit të AMA.

Rekomandimi: Kontrolli i Lartë i Shtetit i rekomandon ILDKPKI verifikimin e konfliktit të interesit për z. Gentian Sala, Kryetar AMA në momentin e zgjedhjes së tij, pasi për shkak të mungesës së dokumentacionit në dosjen personale në si grup auditimi e kishim të pamundur të gjykonim lidhur me rregullshmërinë e këtij procesi.

Menjëherë

Gjetje: Bordi i AMA-së të analizojë Raportin e Auditimit dhe të marrë masat bazuar në legjislacionin në fuqi. Për sa më poshtë:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në akt konstatimet dhe procesverbalet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit. Mbështetur në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe neni 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.5.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor për shërbimin civil” Bordi i Autoriteti të Mediave Audiovizive, të vlërësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e **masave disiplinore nga “vërejtje” deri në “largim nga detyra”**, në varësi të shkallës së përgjegjësisë për personat si më poshtë:

1. **Zj. Evgjëni Bashari** me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Licencave, në cilësinë e kryetarit,
2. **Zj. Arjola Kadare** me detyrë Përgjegjëse Zyrës së Financës,
3. **Z. Erjon Ngjela** me profesion inxhinier ndërtimi ekspert i jashtëm, në cilësinë e anëtarëve të KVO,

pasi në procedurën e zhvillimit të tenderit me objekt “*Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA*” ka kualifikuar e në vijim është shpallur fitues, Bashkimin e Operatorëve Ekonomikë “Mela” sh.p.k. “Curri” sh.p.k. me parregullsitë si më poshtë:

a. OE “Mela” sh.p.k. në licencën e shoqërisë nuk ka kategoritë e punimeve:

- NP-12 “Punime të inxhinierisë së mjedisit”,
- NS-18 “Punime topogjeodezike”,
- NS- 19 “Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë”, në kundërshtim me pikën 2.a.I dhe 2.a.II të KVK të miratuara me DST.

OE “Mela” sh.p.k. në licencën e shoqërisë nuk ka Drejtues teknik të punësuar me kontratë pune të vlefshme të profesionit:

- Inxhinier topograf
- Inxhinier mjedisi,
- inxhinier telekomunikacioni.

Në staf, nuk ka të punësuar të punësuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listë pagesa, një inxhinier mekanik dhe një ekspert zjarrfikës, në kundërshtim me pikën 2.C.2 dhe 2.C.4 të KVK të miratuara.

b. OE “Curri” sh.p.k. në licencën e shoqërisë nuk ka Drejtues teknik të punësuar me kontratë pune të vlefshme të profesionit:

- Inxhinier topograf
- inxhinier telekomunikacioni.

Në staf, nuk ka të punësuar të punësuar me kontratë pune të vlefshme dhe të figurojnë në listë pagesa, një inxhinier hidroteknik, një arkitekt dhe një mjek, në kundërshtim me pikën 2.C.2 dhe 2.C.4 të KVK të miratuara.

Nuk ka një mjet “autobot uji”. Mjeti i tipit benz me targë SH 4082 E i paraqitur në shtojcën 9 “Mbi disponimin e makinerive” si autobot uji, me kod “GA” në lejen qarkullimin e mjetit, nuk është “autobot uji”, por një kamion me përdorim tjetër.

Me parregullsitë e konstatuara KVO, duhet të skualifikonte BOE “Mela” sh.p.k. & “Curri” sh.p.k.

4. **Zj. Eriona Rusmali** me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore,

5. **Zj. Erjona Fishta** me detyrë jurist,

pasi në tenderin me objekt “*Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA*” ka kualifikuar/shpallur padrejtësisht fitues BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k.

KVO me parregullsitë që kishte në dokumentacionin ligjor kualifikues duhet të kishte skualifikuar BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners” sh.p.k. de të kishte kualifikuar dhe shpallur fitues OE “AA & E Engineering” sh.p.k. me ofertë ekonomike 2,161,000 lekë, ose 389,000 lekë më pak ndaj ofertës ekonomike të BOE “AVE Consulting” sh.p.k. & “D & C partners”, e cila nën këtë arsyetim përbën dëm ekonomik

Për z. Rais Petrela me detyrë arkitekt (i jashtëm) në cilësinë e anëtarit të KVO dhe z. Florian Demçe në cilësinë e ekspertit të jashtëm në njësinë e prokurimit në tenderin me objekt “*Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA*”, për parregullsitë e konstatuara, nuk është rekomanduar masë disiplinore, pasi nuk janë punonjës i AMA.

6. **Zj. Alba Qirjazi** me detyrë Sekretare e Përgjithshme në AMA,

pasi në tenderin me objekt “*Rikonstruksioni i godinës së Dekorit të Radio Televizionit Shqiptar, për Zyrat e AMA*”, ka rekrutuar si specialist të jashtëm në njësinë e prokurimit z. Florian Demçe me profesion inxhinier ndërtimi, për hartimin e “specifikimeve teknike”, i cili ka paraqitur “*eksperienca të mëparshme në formulimin e detyrave të ngjashme*”, por të pa konfirmuara nga subjekti/institucioni në të cilat i ka kryer. Në të nuk jepet gjithashtu nëse aktualisht është i licencuar, ose i punësuar.

Në tërësi praktika e ndjekur nga Florian Demçe në hartimin/vendosjen e KVK është në kundërshtim me:

- Nenin 1 “*Objekti dhe qëllimi*” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” I ndryshuar në të cilin është përcaktuar se:

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
 - b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
 - c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
 - d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
 - e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.*
- Nenin 46 “Kualifikimi i ofertuesve” të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar i cili ndër të tjera përcakton se ... *kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata.*
 - Nenin 26 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” në të cilin është përcaktuar se ...*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të*

përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve .

V. KONKLUSIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI4100¹ dhe 4200²) e shpenzimeve:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë³, sa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti, Autoriteti i Mediave Audiovizive, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të cilat kryesisht, konsistojnë si më poshtë:

Përdorimi i dy standardeve gjatë procedurës së vlerësimit të aplikimeve dhe procedurës së votimit për garën e dhënies së licencave kombëtare transmetimi audioviziv numerik, duke cenuar trajtimin e barabartë të operatorëve konkurrues në treg.

Rritje potenciale e përqendrimit në treg.

Konkluzion:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 400, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në Autoritetin e Mediave Audiovizive u konstatuan devijime/shkelje nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të rëndësisë materiale për të cilën japim **opinion të kualifikuar**⁴.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT

¹ ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

² ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.

³ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".

⁴ Deviacioni nga kuadri rregullator i evidentuar gjatë misionit auditues për të cilin në gjykimin profesional nuk mund të jepte siguri e arsyeshme.

